Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 8 (136). GUSHT 2017. *(Në qarkullim gjatë gjithë shtatorit)* ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

RRUGA E ARBRIT: QEVERIA SHPALL TENDERIN

Brenda vitit shpallet fituesi. Kompania "Gjoka Konstruksion" 10 pikë bonus

EKSKLUZIVE / *Qeveria vendos të shpallë tenderin për dhënien me Koncension/PPP të Rrugës së Arbrit. Përfshihet gjithë segmenti i rrugës nga Tirana në Bllatë, gjithsej rreth 69 km si dhe lidhja e me Maqellarën dhe Klosin. Përshkrimi i 8 segmenteve të rrugës, gjatësia, specifikimet teknike dhe standardi i kërkuar. Kriteret e vlerësimit për shpalljen e fituesit dhe përmbledhja e kushteve kryesore të koncesionit. Afati i mbylljes së tenderit: 2 tetor 2017. Afati i shfrytëzimit: 13 vite. Shuma në dispozicion: 33.6 miliardë lekë (pa TVSH).*

Nga **BUJAR KAROSHI**

Qeveria shqiptare më në fund e ka hapur tenderin për ndërtimin e Rrugë së Arbrit. Më datë 10 gusht, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës njoftoj përmes Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e procedurave "për dhënien me koncension/PPP të përmirësimit, ndërtimit, operimit dhe mirëmbajtjes së Rrugës së Arbrit".

Përtej ekzaltimit publik dhe qeveritar, gazeta disponon të gjitha dokumentet që kompanitë e interesuara për të marrë pjesë në tender kanë në dispozicion, të cilat përfshijnë dokumentet e procedurës konkurruese, njoftimin e kontratës, shtojcat e kontratës, planimetritë e të gjitha segmenteve, profilet tërthore dhe gjatësore të gjithë gjatësisë së rrugës, planimetritë e përgjithshme si dhe raportet mjedisore, sizmike, gjeologjike, klimatike, hidrologjike si dhe ndikimin në mjedis.

Dokumentet e njoftimit publik të tenderit janë në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, por dokumentet që do të paraqiten për konkurrim duhet të jenë vetëm në gjuhën shqipe. Shuma në dispozicion është 33.6 miliardë lekë ose përafërsisht 259 milionë euro. Afati i fundit për dorëzimin e dokumenteve do të jetë data 2 tetor, ora 12:00 dhe pas kësaj do të jetë një periudhë 60 ditore ku gjithë procedura e firmosjes së kontratës duhet të jetë e përfunduar. Më pas i mbetet kompanisë fituese të nisë punimet.


Në kriteret e tenderit është përcaktuar se nuk do të jetë e ndarë me lote, por kompanisë fituese do ti lejohet të ketë nënkotraktorë për punimet. Gjithashtu, nuk do të lejohet edhe ofrimi i alternativave, pra ofertat do të jenë të bazuara vetëm në projektet e paraqitura nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.

TË DHËNAT DHE INFORMACIONI MBI PROJEKTIN

Kompania që do të fitojë tenderin do të marrë për përmirësim, ndërtim, operim dhe mirëmbajte të gjithë Rrugën e Arbërit nga Tirana deri në pikën kufitare të Bllatës. Po ashtu, edhe segmentin që do të përmirësohet nga Bllata në Maqellarë.

Sipas Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, Rruga e Arbrit është e përfunduar plotësisht në 20.12 km, ndërsa 15.175 km janë përfunduar pjesërisht. Po ashtu, ka një projekt ekzistues edhe për 26.372 km. Në total janë 61.667 km të projektuar për gjurmën kryesore me standardin C3, nga të cilët 26.372 km

(Vijon në faqen 3)



Në foto: Hortofoto e segmentit nga Zall Bastari deri në dalje të Tunelit të Murrizit

KRYEMINISTRI: Rruga e Arbrit çel programin "1 Miliardë për Rindërtim". Drejt finalizimit një proces i stërzgjatur.

Disa komentues shfaqin mosbesim, dyshojnë për afatin dhe standardet. Të tjerë janë optimist: Jemi të gatshëm ta mbajmë Ramën mbi supe nga Tirana në Dibër. Një komentues vendos bast "10 mijë paund" se rruga nuk fillon këtë vit, ndërsa një tjetër shkon deri atje sa shkruan se "po e realizove ti, do t'ia ndryshojmë emrin, nga Rruga e Arbrit ta quajmë "Rruga e Ramës"".

Lexo faqe 2,4

NË BRENDËSI: ■ **Pse pa ujë** *Peshkopia?* ■ **Banorët në gjykatë:** *Të ndalohen punimet!* ■ **Seta dhe Spree**, *dy qëndrime të kundërta me natyrën* ■ **A ka avokatë** *dibranë t'i dalin zot Setës?* ■ **Qyteti zhurmon** *nga dasmat, pyjet shkrumbohen nga zjarri* ■ **Potenciali turistik** *i luginës së Drinit të Zi* ■ **Kalaja e Dodës** *në ndarjet administrative* ■ **"Zerja"**, *suksesi që vjen përmes traditës* ■ **Lediana Kapxhiu**, *zëri i Shqipërisë në Londër* ■ **Lavdrim Krashi** *- dibrani që menaxhon politikat e strehimit në bashkinë e Londrës* ■ **Stine:** *Të mbajmë njëri-tjetrin, sepse kjo na bën të paarritshëm në të gjitha fushat* ■ **Ismail Keta**: *Jeta dhe karriera ime janë frymëzuar nga Herkuli* ■ **Prof.dr. Hasan Çipuri** – *terminologu i shquar ushtarak* ■ **Halil Rama,** *përtej kronikës së disa jetëve* ■ *Tri dimensionet e veprës krijuese të* **Hajri Mandrit** ■ **Melita Shehu**, *e papërsëritshmja artiste e madhe* ■ **Udhëve** *të shpërlara të fshatit tim* ■ **Profilet e inxhinierëve** *që ndërtuan Shqipërinë* ■ **Musa Osmani**, *mendimtari dhe filozofi popullor* ■ **Hajri Hoxha** *në kujtimet për Brigadën e XVIII Sulmuese* ■ **Rasim Teodori**, *një emër në përmendoren e kujtesës së atdhedashurisë*

Rruga e Arbërit rrugaearberit Bej "Like" dhe "Share". Pajtohu dhe qëndro me gazetën #rrugaearberit më pranë #Dibrës!

Për më shumë informacion: Tel: 00455 68 65 08 441. Email: rrugaearberit@gmail.com | www.rrugaearberit.com +355 68 65 08 441 +355 69 20 68 603

cyan magenta yelloë black 1

Gazeta "Rruga e Arbërit" është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 8 (136). Gusht 2017
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit Shtator

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Korrespondentë të përhershëm:
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Alban TUFA
Hysen LIKDISHA
Samet ZAGRADI
Defrim METHASANI

Kontribuan për këtë numër:
Hajri SHEHU
Halil TEODORI
Selman MEZIU
Orhan AKIL SAKIQI
Fatbardh CENA
Metush SKEJA
Drita RINA
Namik SELMANI
Halil RAMA
Prenç PRENÇI

Fotoreporter: Fehmi LLESHI

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Kryeministri njofton hapjen e tenderit për Rrugën e Arbrit, komentuesit mosbesues, dyshojnë për afatin dhe standardet

"Rruga e Arbrit çel programin "1 Miliardë për Rindërtim", ishte postimi i tretë i ditës më 11 gusht 2017 në profilin zyrtar të kryeministrit Edi Rama në Facebok, ku njoftonte hapjen e procedurave finale për tenderin e ndërtimit dhe mirëmbajtjes së Rrugës së Arbrit.

"Drejt finalizimit një proces i stërzgjatur në vite që do të kurorëzohet, siç është premtuar brenda vjeshtës me nisjen e punimeve", shkruan Kryeministri.

Në të njëjtin postim, ai bën të ditur lajmin se "është çelur procedura finale për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit, me një vlerë prej 33,6 mld lekë të reja. Ofertat do të priten deri në datë 2 tetor 2017 dhe komisioni do të shpallë fituesin brenda 60 ditëve nga data e mbylljes së ofertës".

Postimin e tij Kryeministri Rama e përcjell më një foto të realizuar në rrugën e Arbrit në vendin e quajtur "Gurët e Skënderbeut". Fotoja është një realizim i gazetarëve të gazetës "Rruga e Arbërit" edhe është një foto e zakonshme që media e shkruar dhe ajo online ilustrojnë zakonisht lajmet mbi rrugën.

Lajmi mori rreth 8 mijë pëlqime dhe rreth 450 komente, ndërsa është shpërndare nga më shumë se 200 persona. Ashtu siç është bërë rutinë, në postimet e Kryeministrit komentet janë të të gjitha llojeve. Ka prej atyre që shprehin urime për lajmin, ashtu siç shumë të tjerë janë pesimistë dhe kritikë.

Disa hedhin dyshime për afatin, duke kujtuar se në dimër, nisur nga koha e keqe nuk mund të fillojnë punimet dhe kështu që pranvera do të ishte koha me e afërt. Po ashtu, ka qytetarë që i kujtojnë kryeministrit se standardet e rrugës janë më të rëndësishme se afati.

"Si mund të fillojnë punimet brenda vjeshtës, kur komisioni do të shpallë fituesin 60 ditë pas tetorit?", shkruan njëri prej tyre. "Aman, dhe një vit më vonë, vetëm të bëhet brenda standardeve".

Komentues të tjerë janë mosbesues në lidhje me sasinë parave të nevojshme për ndërtimin e saj, duke sjellë krahasime nga përvoja në vepra të ngjashme, ku shumat kanë rezultuar disa herë më të mëdha.

Disa komentues i kërkojnë Kryeministrit të jetë më i përmbajtur me postime të tilla, pasi i kujtojnë atij se lajme të ngjashme të publikuara në të kaluarën kanë rezultuar të rreme.

Por, ashtu siç është zakonshme edhe në postime të tjera, ka shumë komentues që e falënderojnë kryeministrin, madje e teprojnë me falënderimet dhe vlerësimet. Njëri prej tyre është i gatshëm "ta mbajë mbi supe nga Tirana në Dibër".

"...kur të përfundojë Rruga e Arbrit, dibranët do të të mbajnë mbi supe nga Tirana në Dibër dhe unë dëshiroj të jem njëri prej tyre", shkruan një komentues në murin e kryeministrit.

Një komentues vendos bast "10 mijë paund" se rruga nuk fillon këtë vit, ndërsa një tjetër shkon deri atje sa shkruan se "po e realizove ti, t'ia ndryshojmë emrin, nga Rruga e Arbrit ta quajmë "Rruga e Ramës"".

Më poshtë po paraqesim një përzgjedhje përmbledhje të komenteve që kanë të bëjnë vetëm me rrugën, të cilat janë lënë qëllimisht të pa redaktuara.



PËRZGJEDHJE E KOMENTEVE NË POSTIMIN E KRYEMINISTRIT

Robi Kon: Kjo po qe eshte rruge me 60 km ne ore.Po makina do kalojn apo gomeret me 60 km ne ore

Elton Shani: Doja tju ofroja nje kafe ne shtepine time!

Tito Velaj: Reald kur te piqen fiqt e shendreut do behet ruga

Lutfi Memaci: Do zoti nuk asht mashtrimi I rradhes...!

Liri Rama: Tunde me kete Rruge, eshte domozdoshmeri.

Artur Keshi: Hajde per hajer na qofte i treti i verteti

Altin Zeneli: Une vendos bast 10 Mije pound se rruga Arberit nuk vazhdon kete vit mashtrimi rradhes

Majlinda Hoxha: Nuk jam dakord "rindertim". Urojme dhe presim ndertimin.

Olgert Duka: Tarifat vendosen vetem kur eshte autostrade dhe jo rruge si kjo qe europa i ka per rruge urale.

Ylber Noka: Zoti Kryeminister edhe sa kohe do prrallesh me dibranet? Te pakten mos na premtoni ju lutemi...

Sajmo Totraku: Le te behet kur te behet o zoti Kryeminister. Ma shume na bezdisen postimet e lajmet se sa me u gezu se po behet.

Alban F Tufa: Paskeni vene per ilustrim foton e segmentit qe nderoi Saliu.

Albert Lleshi: Do tiu urojme kur kjo rruge te perfundoje.

Armand Elezi: Vec ksaj qe si them rrug una pa drita, pa vende ndalesash ne rast nevoje, pa bordura, sinjalistika shum dobet

Jony Cena: Ruga e shumpritur nga dibranet qe jane popullsi Jo e vogel duke ditur se 3 a 4 here popullsi sa ka ketu jane dhe ne tr e durres Dibranet. Lidh me Dibren tjeter te shqiptareve te maqedonise dhe esht nje investim I vonuar per rendesine strategjike te shqiptareve. Ishalla mbaron sa me pare. Suksese

Fiqiri Bruci: Mustafa ti ka errun syte urrejtja, per Edi Ramen ndaj nuk e sheh se kush po e nderton Rrugen e Arberit. Nese vazhdon ta perjetosh keshtu humbjen do behesh keq nga shendeti, pasi Edi Ramen do e kesh edhe shume vite te tjera Kryeminister. Mundohu te mesohesh me te qe te mos behesh keq.

Goni Katalanasi: Shume mire po kur do inagurohet???

Fatbardha Topollari: Ky deri me sot ska bere asnje km ruge po na mburet tani per rugen e Arberit. Ta mbaroje njehere se me sa di une eshte ende atje ku e ka lene Sala qe heret shume. Mbas asaj ruge jane bere me qindra ruge te tjera nga jugu ne veri, apo do thoni qe edhe ato ruge ku shkelni sot ne gjithe Shqipërin i ka bere ky kryeminister.

Arian Oboku: Falëmnderit kryeminister, i humbem shpresat, por na i ktheve sërisht kjo eshte nje lajm shumë i madh për të gjithë Shqipëtarët RRESPEKTE!

Defrim Tironsi: 1- Per kete rruge sa fonde jane hedhur edhe sa fonde jane mbaruar asnjehere nuk jane investiguar? 2- Tenderat dihet ku shkojne, i merr Geci me shoke ose Salillari.. 3- Rruga krejt pa Standarte nese e ke pare Autostraden Selanik - Shkup atehere do thonit kjo e jona eshte loje kalamajsh...

Ilir Vata: Axhend e duhur per t'i celur nje port te re shqiptareve te Veri-Lindjes, brenda dhe jashte teritorit te vendit, nje shteg te sigurt bashkepunimi rajonit te Ballkanit, nje udhe qe do te shenojoje dimension te ri drejt modernizimit te Shqiperise. Urime..!

Pavllo Bezhani: Rruga e Arberit u fillua si shume te tjera sa u pre shiriti dhe u prish Kanioni i Brarit qe mendij ka pasur mundesi te shmangesh ai fillim. Tani Shqiperia dhe Dibra do te kene padyshim nje rruge te standardeve.

Hazbi Pershaku: Më në fund ëndërra e dibranëve po bëhet realitet. Një BRAVO për kryeministrin që e premtoi dhe po e realizon, sepse shumë të tjerë na premtuan dhe na gënjyen.

Elsa Masha: Pune e mbare... dhe para ne suksese te tjera per mireqenien e popullit.. Te qajne qaramanet... Te shajne llafazanet... Te mohojne nihilistet... Te fershellej gjuha e neperkes po ska per Te bere pune me se populli po sheh, degjon, sheh dhe jeton nje ndjesi per se mbari... ate te punes e jo te shkaterimit.. bravooo

Ardjan Vocri: O Edo Rama po' bere kete rruge do fitosh 6–0 heren tjeter jo vetem ne Diber por edhe ne Zerqan qe ka fituar gjithmone PD ciao pres pergjigje po' te jesh bravo

Besnik Bajrami: Shumë bukur po ndërtohet Shqipëria, por 1 problem e keni nëper Rrugë Tabela komunikacioni, shumë pak ka dhe thuj se askund nuk shkruan sa km prej filan vendi deri filan vendi. Nëse të bjer Rruga neper Europ me udhtu ndoshta e sheh se sa tabela komunikacioni ka dhe sa km ki. Do ishte mirë me mendu edhe për të haujt që nuk e njohin mir Shqipërin...

(Vijon në faqen 4)

Lartësia maksimale mbi nivelin e detit ku do të kalojë rruga është 872 m, rrezja minimale e kthesave do të jetë 80 m, si dhe pjerrësia maksimale gjatësore është 6.99%. Parashikohet ndërtimi i katër urave me një gjatësi totale 1214 metra si dhe ndërtimi i Tunelit të Murrizit me gjatësi 3246 metra. Krahas tubit kryesor për trafikun normal me dy korsi nga 3.5 metra, do të ketë edhe një tub emergjence paralel me atë të trafikur, në një distancë aksiale 25 m.

RRUGA E ARBRIT: QEVERIA SHPALL TENDERIN

Brenda vitit shpallet fituesi. Kompania "Gjoka Konstruksion" 10 pikë bonus

(Vijon nga faqja 1)

nuk janë prekur me punime ndërtimi. Sipas studimit të fizibilitetit të hartuar rreth vitit 2005, thuhet në dokumentet e tenderimit, e gjithë gjurma Tiranë-Bllatë sipas këtij varianti pritet të jetë afërsisht rreth 73.5 km e gjatë, ç'ka do të thotë që afërsisht në total 11.8 km rrugë janë ende të paprojektuar. Ky segment përfshin skajin e lidhjen me Tiranën dhe gjatësi në skajin e lidhjes me Bllatën - pika kufitare.

Në këto kushte, Projekt Ideja për "Përmirësim, Ndërtim, Operim, dhe Mirëmbajte e Rrugës së Arbrit" për kompletimin e të gjithë gjurmës së Rrugës së Arbrit që përfshin: projektet e segmenteve të pa projektuar (skajet lidhëse), përmirësimin e projekteve të segmenteve ku punimet janë ende të papërfunduar me synimin e përmirësimit të tyre nga standardit C3 të standardit të vitit 2001 në atë C2 sipas standardit të vitit 2015, përmirësimin e projekteve të zbatimit për segmentet ku ka projekt zbatim por që nuk është ndërtuar duke përmirësuar standardin C3 të rrugës sipas standardit të vitit 2001 në atë C2 sipas standardit të vitit 2015 dhe mirëmbajtjen e segmenteve të ndërtuara.

Në projekt ide, të nxitur nga rëndësia që ka segmenti Zall Bastar-Dalja e Urës së Vashës, që është sa 1/3 e të tërë Rrugës së Arbrit është studiuar dhe projektuar sipas standardit C2 të vitit 2015, ku është projektuar edhe lidhja e Rrugës së Arbrit me Klosin.

Në projekt ide është marrë në konsideratë distanca kohore më e shkurtër, siguria e kërkuar në tunele, pasi parashikon edhe një tub emergjence, krahas atij kryesor dhe aksesi me i shpejtë i rrugës nga banorët e Matit përmes lidhjes me Klosin. Kështu, në Projekt-Ide, Rruga e Arbrit nga Tirana deri në Bllatë skematikisht në mënyrë të njëpasnjëshme është e ndarë në 8 segmente.


PËRSHKRIM I 8 SEGMENTEVE TË RRUGËS SË ARBRIT

SEGMENTI 1. Fillon në dalje të Tiranës, aty ku mbaron rruga ekzistuese, dhe përfundon tek Ura e Brarit, aty ku kanë filluar punimet për ndërtimin e rrugës. Gjatësia e tij është 1.153 km.

Rruga ndjek një gjurmë të re, të ndryshme nga rruga ekzistuese që të çon tek Ura e Brarit. Kjo bëhet për të shmangur rrugën që përdor komuniteti, si dhe për të patur një gjurme të drejtë, duke e lehtësuar që në fillim trafikun në Rrugën e Arbrit. Ky segment përfundon para hyrjes tek Ura e Brarit, pikërisht ku ka filluar punimet për ndërtimin e rrugës në këtë gjurmë. Këtu nuk ka projekt ekzistues. Gjerësia e rrugës do të jetë: 2 x 3.5m vijë kalimi + 2x1.25 bankinë e asfaltuar + 2 x 0.75 kunete ose bankine e pa asfaltuar. Pra, kemi një rrugë 11m gjerësi, ku asfalti do të jetë 9.5m.

SEGMENTI 2: Ura e Brarit - Zall Bastar, me gjatësi 5.46 km.

Në këtë segment janë realizuar pjesërisht punimet me fonde të buxhetit të shtetit dhe aktualisht këto punime janë në shtresë çakulli, si dhe janë përfunduar veprat e artit, mbrojtja e skarpatave dhe konstruksioni i një tuneli të shkurtër. Gjerësia e rrugës sipas projektit ekzistues është 2 x 3.75 m vijë kalimi + 2 x 1.25m bankine e asfaltuar ose kunete + 2 x 1.0m bankine e pa asfaltuar. Rruga do të jetë 12 m e gjerë dhe gjerësia e asfaltit do të jetë 10 m.



SEGMENTI 3: Zall Bastar – Dalja e Urës së Vashës, sipas Projekt-Idesë është me gjatësi 23.188 km.

Ky është segmenti kryesor i Rrugës së Arbërit, sepse është më i gjati, rreth 1/3 e rrugës, përshkon terrenin më të vështirë nga pikëpamja topografike, hidrologjike, dhe gjeologjike si dhe është tërësisht i paprekur nga ana ndërtimore.

Në projekt ide gjatësia e këtij segmenti është 23.188 km. Projekt ideja është hartuar dhe zhvilluar nisur nga: investigimin topografik, inxhinierik dhe gjeologjik të kujdesshëm të terrenit në të gjithë gjurmën e projekteve ekzistuese të Rrugës së Arbrit. Synimi i këtij investigimi ka qenë përmirësimi i mundshëm i gjurmës së Projektit te Zbatimit të arkivuar në ARRSH.

Lartësia maksimale mbi nivelin e detit ku do të kalojë rruga është 872 m, rrezja minimale e kthesave do të jetë 80 m, si dhe pjerrësia maksimale gjatësore është 6.99%. Parashikohet ndërtimi i katër urave me një gjatësi totale 1214 metra si dhe ndërtimi i Tunelit të Murrizit me gjatësi 3246 metra.

Në dokumentet e tenderit shkruhet se tuneli do të hapet sipas metodës së re austriake (NAMT) për hapjen e tuneleve, dhe krahas tubit kryesor për trafikun normal me dy korsi nga 3.5 metra, do të ketë edhe një tub emergjence paralel me atë të trafikur, në një distancë aksiale 25 m.

SEGMENTI 4: Dalja e Urës së Vashës – Bulqizë, me gjatësi 9.715 km.

Në këtë segment janë realizuar pjesërisht punimet me fonde të buxhetit të shtetit. Në një gjatësi prej 2.7745 km është hapur vetëm trasesja e rrugës (pa nënshtresat) dhe janë ndërtuar veprat e artit, si tombino e mure mbajtës. Rruga ka një gjerësi 11m me gjerësi asfalti 9m. Ndërsa për 6.94km, punimet janë në shtresë çakulli, gjerësia e rrugës është me 3 vija kalimi, 2 në ngjitje dhe 1 në zbritje, pra me 14 metra gjerësi dhe asfalt 12 m.

Në këtë segment është dhe tuneli i Qafë Buallit me një gjatësi rreth 470m, i cili duhet të plotësohet me punimet e ndriçimit, sinjalistikës si dhe të shtreses së stabilizantit dhe ato asfaltike.

Projekt Ideja ka qëllim përmirësimin e projekti të rrugës për punimet e mbetura, duke iu përgjigjur kërkesave që dalin nga volumi i pritshëm i trafikut.

SEGMENTI 5: Bulqizë-Ura e Çerenecit, me gjatësi 20.12 km.

Në këtë segment rrugor punimet kanë përfunduar në vitin 2009 dhe 2011. Gjerësia e rrugës është 11 m dhe asfalti 9 m. Duke qenë se ky segment rrugor është realizuar vitet e fundit nga D.P.Rr, sot A.RR.Sh, punimet ndërtimore për këtë segment kanë përfunduar dhe konsiderohet se është i hapur për trafikun. Ky segment është prezantuar por nuk është pjese e Projekt Idesë.

SEGMENI 6: Ura e Çerenecit - Bllatë, me gjatësi 9.111 km.

Për këtë segment rrugor nuk ka projekt ekzistues. Ky segment rrugor fillon në afërsi të Urës së Çerenecit dhe përfundon në Bllatë, në afërsi të pikës doganore me Maqedoninë. Gjerësia e rruges do të jetë si në shumicën e segmenteve të tjera, 11 m gjerësi dhe asfalti 9.5m. Në këtë segment do të ndërtohen 2 ura, një në afërsi të Urës së Çerenecit mbi Lumin Zall i Bulqizës me një gjatësi prej 212m dhe ura tjetër mbi Lumin Drin i Zi me një gjatësi prej 292 m.

SEGMENTI D (7): Bllatë - Maqellarë

Për të plotësuar nevojat e trafikut të ardhshëm, rruga ekzistuese Maqellarë-Pika kufitare Bllatë duhet të rikonstruktohet në standardin e një rruge urbane për shpërndarjen e të tërë trafikut të Rrugës së Arbrit në drejtim të Peshkopisë (Maqellarë) dhe Maqedonisë (Pika kufitare Bllatë). Ky segment lidh fshatin Bllatë me pikën doganore me gjë gjatësi prej 0.557 km, si dhe me Maqellarën me një gjatësi rreth 2.438 km. Ky segment do të jetë rikonstruksion i rrugës ekzistuese.

SEGMENTI K (8) është degëzimi Dalje Ura e Vashës - Klos.

Ky segment rrugor ka një gjatësi rreth 3.092 km dhe lidh Rrugën e Arbrit me rrugën Burrel – Klos, në dalje të Urës së Vashës. Ndërtimi i këtij degëzimi është i rëndësishëm pasi do të lidhë Burrelin me Tiranën në distancë më të shkurtër nga aksi ekzistues që është sot Burrel – Milot-Tiranë. Kjo rrugë do të ketë seksionin tërthor tip C3, gjerësi totale 10.5 m dhe gjerësi asfalti 9m.

KRITERET E VLERËSIMIT

Janë përcaktuar pesë kritere bazë për zgjedhjen e fituesi. Pika e parë është propozimi teknik për ndërtimin e rrugës dhe mirëmbajtjes, e cila vlerësohet me 45 pikë. Kjo pikë përbëhet nga katër elementë kryesore: projekt ide konceptuale, ku përfshihen studimi topografik, ai gjeoteknik, hidrologjik, studimi për projektimin e shtresave rrugore, metodologjinë e ndërtimin, raportin e shpronësimeve, kërkesat mbi lejet dhe licensat, etj. Ofertuesi me projekt-idenë më të favorshme do të vlerësohet me 15 pikë.

Operatori ekonomik pas hartimi të projektidesë konceptuale duhet të përgatisë grafikun e punimeve dhe metodologjinë e punëve, sipas të cilave do të punojë për të plotësuar kërkesat e zbatimit të projektit në kohën, sasinë dhe cilësinë e duhur. Ofertuesi me metodologjinë e punimeve më të favorshme do të vlerësohet sërish me 15 pikë. Me 7 pikë do të vlerësohet koha më e shkurtër në planin operacional, ndërsa sinjalistika e përkohshme dhe siguria në kantier gjatë ekzekutimit të punimeve të ndërtimit do të vlerësohet me 8 pikë.

Me nga 10 pikë do të vlerësohen ofertuesit që do të paraqitet me projektin më të mirë si dhe impaktin mjedisor më të ulët. Po ashtu me 10 pikë do do të vlerësohet edhe projektin me vlerat më të larta sociale, si dhe koha më e shkurtër e arsyeshme e ndërtimit dhe vënies në shfrytëzim të kësaj vepre.

Ndërsa oferta financiare e paraqitur për mbarimin e Rrugë së Arbërit do të vlerësohet me 25 pikë.

Kujtojmë se qeveria shqiptare, me vendimin nr. 321 datë 12 prill 2017, i ka dhënë shoqërisë "Gjoka Konstruksion" sh.a. një bonus prej 10 % të pikëve të garës, pasi kjo kompani i ofroi qeverisë shqiptare një ofertë të pakërkuar në lidhje me ndërtimin e Rrugës së Arbrit.

PËRMBLEDHJA E KUSHTEVE KRYESORE TË KONCESIONIT

Objektivi kryesor i Koncesionit/PPP është Përmirësimi, Ndërtimi, Operimi dhe Mirëmbajtja e Rrugës së Arbrit, sipas parimit të "Projektit me Çelësa në dorë". Kohëzgjatja e kontratës së koncesionit është 13 vjet, në varësi të ndërprerjes më të hershme të Kontratës së Koncesionit në përputhje me kushtet e saj. Aktivitetet për t'u kryer nga koncesionari janë përmirësimi, ndërtimi, operimi dhe mirëmbajtja e Rrugës së Arbrit sipas standardeve të miratuara nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës. Burimet e të ardhurave të Koncesionarit janë pagesat e disponueshmërie vjetore e pagueshme nga Ministria e Transportit, niveli i së cilës do të përcaktohet në ofertën e paraqitur nga konkurrentët. Kontrata rregullohet nga legjislacioni në fuqi si dhe kriteri kryesor për shpalljes e fituesit do të jetë oferta teknike më të mirë dhe pagesa e disponueshmërisë më e ulët e kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Kryeministri njofton hapjen e tenderit për Rrugën e Arbrit, komentuesit mosbesues, dyshojnë për afatin dhe standardet

(Vijon nga faqja 2)

Ismet Spahiu: Si me nje fjal zoti kryeminister kur te piqen thanat

Gaz Lila: Po u perfundu brenda mandatit te ps. 1500 vota i ke pro ps nga un.

Alfred Gjini: Urime per kte nisem. Kjo eshte nje mundesi e vertete per te lidhur shqiptaret me njeri tjetrin dhe pershpejtuar zhvillimin e tyre. Bravo dhe suksese te metejshme qeverise.

Fati Elezi: Rruga Arberit zoti kryeminister duhet te kishte perfunduar me koh edhe sot qe keni ber statusin mashtroni ! Si mund te fillojn punimet brenda vjeshtes kur komisioni do shpall fitusin 60 dit pas tetorit? Dibra osht mesu me genjeshtra vashdo kshu flak fare ashu sic duket dhe fotoja nje pjes e djegme.

Fatmir Lisha: Urime per te gjithe Shqiptaret ,, nje pune-veper qe do te nise,, duhet te jete gezim per te gjithe..

Herni Grecian: Me fjal RRUGA E ARBRIT esht perfunduar qe para mandatit tend Z. Rama, po me vepra nuk do mbarohet asnjiher. Boju qejfin qytetareve duke ju mbajtur mendjen, se rrin tu shpresuar te ju dhe asgje spo boni. Per me mbajt fjalim dhe genjeshtra permendesh jeni boll mir. Por ishalla kte here ke fol tamam do Zoti ! ....

Lulzim Hupi: Me fal qe u zgjova pak me vones,po te promtoj pulikisht qe po e mbarove para mandatit 4 vjecar do dal dhe do te pres dhe do te punoj nate edit me Miqesi shok e dashamir, qe sa te kem frymen do te votoj ty qe po na kthen shpresat.Ti qe po na i ben ederrat rralitet,pac shendet do zoti te fillojn punimet sa me shpejt

Gazmir Alia: Pershendetje z kryeminister i kombit Shqiptar EdiRama ti meriton fitore te perhershme rruga e Arbërit sa me shpejte duhet te mbaroj Dibra me miniera dhe natyra smund te rri te flej mbi Flori.

Luftim Ahmetaj: Urroj qe deri ne 2 Tetor te jete ndryshuar Drejtoria e Pergjitheshme e Rrugeve qe nga themeli. Shkaketare kryesore e deshtimit te cdo rruge vecanerisht te By Passit te Fierit dhe Vlores. Ndryshe ma mori te keqen dhe rruga e arbrit, mund te perfundoje ne kalendat e xhepave te nenkontraktorve Lsi-ste dhe dibraneve trima i ngel 'nocoroku'.

Setki Jashari: Per dibranet do te ishte nje mrekulli ....dhe do ta meritoje adhurimin tone ne shekuj.....

Rexhep Pula: Te gjith dibra ne kembe per ty!

Erest Joga: Ajo tabela aty do marre meqafe shume patenta...shikoini njehere tabelat se po bllokohen marmitat...

Qifi Hoti: Ishalla po bohet o Zoteria Edi Rama se vetem mashtrime ke.

Er Vis Fejza: Ishalla po e nisni para 2020 o shoku Edi Rama se te besh 4 ore rruge nga Bulqiza me ardhe ne Tirane nderko qe nuk esht ne vij ajrore as 50km kjo esht jasht llogjike kur nderko bota po ben tunele ne uj ju sbeni dot 50km rruge po e zvarrisni 30 vite

Ledi Burnazi: Nese Rruga E Arberit do perfundoj per kto 3 vite ,dibranet do te ken shum respekt per ty zoti Ram

Gligor Sheshi: Aman dhe nje vit me vone vetem te behet brenda standarteve.Qe shoferet te udhetojne te qete po friken se mund ti dale lopa dhia a gomari..Boll me me palo ruge.

Pajtim Pachuku: plani ishte rruga te del ne kufi tek konjars ne diber e jo ne bllate pasi ne konjare shkurtohen 1okm e jo te shkon deri ne bllate ashtu i.bije reth e rotull

Elton Alimeta: Ndiqeni me kujdes ket rruge,-mos e lini si ate Tirane Elbasan qe çdo vit i shtohen shtojca nga 35milion euro se u bene kontraktuesit si hudini.

Flauers Shoshi: Ta gëzojnë të gjithë shqiptarët këtë rrugë. Programi 1 miliard po fillon të funksionojë ;)

Lita T-lita: Lene se e keni bo pis me kete rrugen e Arberit, futi popullit ndonje genjeshter tjeter,jo si te Berishes

Ersilda Lutfi Rama: Uojm qe te behet dicka e hajrit dhe per zonen e Dibres. Se miljardat dalin nga ajo zone por gje per te nuk esht ber deri tani. Uroj te behet me ne fund se shum premtime deri tani dhe asgje.

Klemi Shehu: Vetem te medhenjte bejne gjera qe shkruhen ne histori, qe tregohen nga gjysherit dhe 100 vite me vone. "E famshmja Rruga e Arbrit" .

Petrit Shtrungeza: Bravo edhe kjo merit e jotja po puna asht se ka 20 vite qe esht nis po nejse

Besnik Sula: Z kreminister kjo rruk po e mbaruat do jet ndim per gjith dibranet por edhe per moqodoni te lumt z krmniseter shpesom te perfundoj me sukses

Halil Gjeqi: Respekte Kryeministri Jone, Vetem Ke ty kemi shpres per Rrugen e Arberit, Edi Rama, great Priminister!

Vali Kerli Morava: Do jet nje mrekulli e vertet per rrugen e re shpresojm te mbaroj se shpejti dhe me sukses

Lefter Kurti: Po e bere Rrugen e Arbrit i nderuar Kryeminister kam bindjen se do mbetesh miku me i mire ne te gjithe historine e miqesive te Dibres! Une personalisht besoj se kur te perfundoje Rruga e Arbrit, Dibranet do te te mbajne (duhet te te mbajne) mbi supe nga Tirana ne Diber dhe une deshiroj te jem njeri prej tyre. Aq shume eshte e deshiruar per ne kjo rruge...!

Hamit Koxha: Nese realizohet kjo rruge per 2-3 vjet Parti Sicialiste fiton 3 deputet ne Qarkun Diber.

Ledi Lazimi: Nese do beni rrugen do merni dhe votat e djathta qe skane ndryshuar asnjehere! Ngelet per tu pare...

Florjan Neziri: Duhet ti inspektosh vetë punimet,sepse kam parë që ka shumë kthesa në vende që mund të shmangeshin totalisht,mos të përfundojë si truga e kombit por të bëhet njëherë e mirë

Dorald Xhani: Ejj po kto tabelat me 60 se lat nam, mes maleve pa lidhje

Maksim Xhani: Uroj qe kjo rruge te behet sa me shpejt qe te jete e mundur sepse eshte ne interes te te gjithe atyre qe jetojne ne Diber apo ne Tirane sepse e meritojne.

Sonila Musaj: Vetem bejeni se na plaset, ngelem duke prit

Esmi Esmi: Shpesojme zoti Rama. Qe ti mbash premtimet. Rrugen e alberi. Po e ralizove ti. Them Tia ndryshojme emerin. Rruga arberit. Ta quajme Rruga e Rames

Valter Koxhaj: Kjo rrugë është investimi më I mirë për këto zona. Urojm të mbaroj sa më shpejt! Bravo Edi Rama!

Skender Shllaku: Po shyqyr që do bëhet kjo rrugë Z. Kryeministër... se jua " fike llambat " akuzuesve... se këtë të rrugëve e kanë perdor shumë kundër jush.

Arjan Elezi: Te qofte per hajer mo i modhi m'ven Edi Rama.

Cim Krashi: Faleminderit nese e beni gjithesesi per ne dibranet ngelet enderr

Musa Maraj: Bravo plako je i papar kryeminister

Altin Totraku: E 20 e verteta te shpresojm mos ket me probleme e shtyrje

Ardiel Koci: Mbas nje legjende historia vazhdon....

Astrit Armando Cacaj: me 60 në orë pak është

Iliana Ganaj: Bravo Edi Rama per fjalen qe mbajte urime respekt

Eduart Gjoni: Me pak llafe pranver 2018

Bledi Myftari: Sa me shpejt o Edo se andej vazhdon bora dhe ngel me prit tenderin e vitit tjeter

Buli Domazeti: Ec aty gjigand se vet te ty i kena shpresat

Cerbero Anonim: Je i madh por po e bene rrugen e arbrit do jesh dhe me i madh

Adriatik Shehi: Po ho or burr mo. Mu e zgjet shum proceduren, gjeri shkurt.

Lorenc Behaj: Po he te shkreten se u be legjende

Pasho Nezha: Megjiteate e thena me te beren jane shume large.

Emri Sela: Ec atej o njësh-i nderum qëfsh përher.

Rikardo Martineli: Rama me i madhi i kombit

Aleksander Huna: Shpresojm mos ngelet premtim bosh

Cuni Embel: Vazhdo tani o edo se ne vjesht e dimrit ka shi e bore o mret e do harrohet prap rruga

Irfan Smaci: Pak me vonese por me mire vone se kurre

Kimet Madana: Ehaaa.

VËZHGIM



Banorët e Peshkopisë duke mbushur ujë nga autobotet e zjarrfikseve. *Foto: dibraexpress.com*

Pse **pa ujë** Peshkopia?

Pyetje për kryebashkiakun e Peshkopisë dhe të zgjedhurit e Dibrës

Në emisionin "Koha për tu zgjuar" sot (29 gusht 2017) dëgjova një qytetar të Peshkopisë të deklarojë se uji i pijshëm nuk shkon as në katet e para(!?)

Peshkopia me 15.000 banorë, qytet-fshat, nuk ka ujë. Për të, që të ketë ujë 24 orë, janë bërë disa investime.

Në vitin 1960 u ndërtua ujësjellësi i Lishanit të Epërm që e furnizonte asokohe qytetin me ujë cilësor 24 orë në ditë.

Në vitet 80-të u ndërtua ujësjellësi i Korabit duke marrë ujërat e dy burimeve të mëdha të malit.

Në vitet 2000 u ndërtua ujësjellësi i Cetushit. U harxhuan miliona euro dhe uji doli i pa përdorueshëm.

Një qytet i rrethuar nga ujësjellës dhe nga burime uji të pastër që nuk i ka asnjë qytet i Shqipërisë. Një qytet sa një fshat i vogël në Evropë pa ujë.

Çfarë bëjnë përfaqësuesit e popullit, ata që morën votën dhe u betuan se do ti shërbejnë votuesve?

Çfarë bën kryetari-kirurg i bashkisë?

Çfarë bëjnë deputetët (ende deputet) dhe deputetët e sapo votuar por ende pa u betuar?

Çfarë planesh ka qeveria Rama-2 për furnizimin me ujë të Peshkopisë dhe fshatrave poshtë saj?

Qyteti i Peshkopisë nuk e ka urgjencë shtrimin e bulevardit me pllaka guri por "shtrimin" me ujë të pijshëm nga burimet e shumta të krahinës.

Furnizimi i qyteteve dhe fshatrave me ujë të pijshëm të bollshëm, me vetërrjedhje duhet të jetë prioritet i qeverisë Rama-2, përndryshe është shkref pa u ngref.

Çfarë bëhet?

Pse heshtet?

ABDURAHIM ASHIKU



Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit ose ndiq linkun: https://tinyurl.com/lcc3e2f

Bëj një abonim online ose në print...

Kushton vetëm 600 lekë në vit...

email: rrugaearberit@gmail.com

NJOFTIM PËR BASHKËPUNËTORËT!

Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët dhe korrespondentët tanë se shkrimet duhet t'i sjellin në redaksi para datës 20 të muajit.
Për çdo rast, komunikoni me redaksinë!

aktualitet

HEC në Setë: Historiku i konfliktit. Shoqëria e ndërtimit bën kallëzim penal për 25 kryefamiljarë. Banorët shprehen se protestuan duke kërkuar, ndalimin e punimeve derisa shkallët e gjyqësorit të dalin në një vendim të formës së prerë

Banorët në gjykatë: **Të ndalohen punimet!**

Më 24 gusht, për faqësuesit ligjorë të kompanisë "HYDRO SETA" sh.p.k, bënë kallëzim në policinë e Dibrës për 25 banorë të fshatit Cidhën, kryesisht kryefamiliarë, me arsyetimin se kanë bllokuar punimet për ndërtimin e hec-it "Seta 4". Nga ana tjetër banorët, shprehen se protestuan duke kërkuar, ndalimin e punimeve derisa shkallët e gjyqësorit të dalin në përfundim. Aktualisht banorët e kallëzuar në polici po ndiqen penalisht në gjendje të lirë.

Kjo çështje e ka rrjedhën e saj, që dy vite më parë, atëkohë që u dha edhe leja për ndërtimin e këtij hec-i. Por rezistenca dhe konfiktet në terren mes banorëve nisi që më 6 maj, ku shoqata "Çidhna dhe Kastriotët" protestoi për më shumë se një orë para Prefekturës së Dibrës, kundra futjes në tuba të ujit të Setës, në kuadër të ndërtimit të HEC-eve Seta 1+2, Seta 3 dhe Seta 4. Protesta u mbështet nga antarë të shoqatës dhe banorë të zonën.

Pas protestës në Peshkopi, ata patën qenë në Çidhën, pikërisht në vendin, ku po ndërohet Seta 4. Disa nga protestuesit ishin çidhnak te ardhur dhe nga Tirana me nxitjen e shoqates ''Çidhna dhe Kastriotët '', të cilët ishin mbi 40 protestues.

Protestat vazhduan herë pas here derisa një përfaqësi e banorëve të fshatit me datë 28 korrik 2017 depozitoi në gjykatën Administrative në Tiranë Kërkes Padinë kundrejt Vendimit të KKRT dt 09.09.2015 për dhënien e lejes kompnisë Hidro SETA sh.p.k, e cila ka filluar punimet në territorin e Setës.

Një ditë para kallëzimit të banorëve nga ana e kompanisë së ndërtimit të HEC-it, pati edhe një protëstë ku ishin mbledhur rreth 70 persona, të cilët bllokuan punimet për ndërtimin e HEC-it "Seta 4".

Fill pas ngjarjeve në fund të gushtit, banorët kanë dërguar për këtë problem një peticion institucioneve të larta të shtetit, dhe një Kërkesë-Ankesë KKRT për anullimin e pjesshëm të vendimit dt.09.09.2015 vetëm për HEC-in "SETA 4", që dëmton rrjedhën e Sopanikës.



Në ligjin nr.9048 dt.07.04.2003 për Trashëgiminë Kulturore, i azhurnuar më pas në vitet 2006, 2008 dhe 2009, në Nenin 38, thuhet: "Çdo vendim i marrë nga Këshillat e Rregullimit të Territoreve për ndërhyrje ose ndërtim në zonat e shpallura Monument Natyre ose në zonën e mbrojtur pranë një Monumenti Natyre, pavarësisht nga pronësia, është i pavlefshëm".

Ujëvara dhe shpella e Sopanikës, të cilat janë në rrjedhën ujore të Setës, me vendim të Këshillit të Ministrave Nr 676, datë 20.12.2002, u shpall Monument Natyre, firmosur nga ish-kryeministri Fatos Nano. Ndërsa në dokumentin e rregullores për miratimin e lejes së ndërtimit të HEC-eve Seta 1+2, Seta 3 dhe Seta 4, mbi përroin e Setës me shtrirje në territorin e Qarkut Dibër dhënë ka KKRT shkruhet: "Në zonën e zgjedhur për projektin në fjalë nuk ka habitate apo objekte me status të përcaktuar, por theksojmë se e gjithë zona ku këto nënobjekte do të dërtohen, është zonë e cila nuk ka ndonjë status të veçantë mbrojtjeje".

Kanali i Setës fillon, sapo mbaron Gurë Lura, aty gjendet një burim që quhet Sopanikë që është burim më i madh i Setës mbi kanal. Kjo është një e treta e burimeve të Setës, ndërsa pjesa tjetër buron nën kanal.

Zona e Çidhnës, dhe saktësht rrjedha e Setës, shquhet për pamjet e gjelbërta dhe atraksionet turistike. Gjithashtu edhe për ujrat e shumtë të pijshëm. Në përgjithësi tërësisht zona e Çidhnës shquhet për rezistencë kombëtare dhe për vlera etno-kulturore.

Korresp. Rr.A.

Një pyetje publike shoqëruar me një fotografi

Njerëz të mirë ju pyes:

Ai i vihen minat një bukurie të tillë për hir të një HEC-i korruptiv?

Bota e qytetëruar e shndërron si ka shndërruar Niagarën dhe bukuri të tjera duke e bërë fatlum atë vend dhe ata banorë që e kanë në sy një bukuri si kjo.

E dini ku ndodhet kjo mrekulli e natyrës?

Ndodhet në Çidhën të Dibrës, një prej buronjave të maleve të saj.

Këtë "Niagarë" të vogël duan ta shkatërrojnë edhe pse ajo është shpallur me vendim qeverie "Monument i natyrës".

Pse?

Për të ndërtuar një HEC.

Një HEC që ka EC falë korrupsionit që lulëzon në trevën më të varfër shqiptare, Dibrën ku Skënderbeu ka fituar 18 beteja nga 25 gjithsej.

Ngrini zërin në mbrojtje të saj!

ABDURAHIM ASHIKU

OPINION

Seta dhe Spree, dy qëndrime të kundërta me natyrën

Nga **BUJAR KAROSHI**

Kjo foto është e lumit Spree (Shpree) në Beeskov, një qytezë e vogël me rreth 8 mijë banorë në Gjermaninë Lindore. Ky lum është i gjatë mbi 400 km dhe në pjesën më të madhe të tij është ruajtur në gjendjen natyrale, ashtu siç është në këtë foto. Ky lumtërheq shumë turistë gjatë gjithë vitit. Vetëm qytezën e Beeskovite vizitojnë çdo vit mbi 1.5 milionë turistë nga gjithë Europa. Kur unë isha në fillim të gushtit, më kafshoi një mushkonjë e madhe, sa kur e vrava, gjithë dora m'u bë me gjak...

Në vendlindjen time është një lum i vogël që quhet Seta. Nga fëmijëria ime e mbaj mend për ujin e ftohtë brisk dhe troftën e mrekullueshme. E mbaj mend edhe nga një hidrocentral i vogël, për të cilin ruaj kujtime jo shumë të mira, pasi ishte aq i vogël, sa nuk ishte në gjendje të na furnizonte me drita kur ato ndërpriteshin!. "Kur nuk prodhon dritë për fshatin tonë, pse duhet të krehohemi me atë hec", kam menduar gjithmonë.

Sot, në Shqipëri, është shndërruar në epidemi fakti që ku rrjedh një ujë prej maleve të ndërtohet një a më shumë hidrocentrale, dhe prej kësaj sëmundje nuk ka shpëtuar as Seta. Janë ndërtuar tre dhe një i katërt ka filluar të ndërtohet. Për këtë shkak, 25 kryefamiljarë të fshatit Çidhën janë në ndjekje penale



sepse kanë kërkuar ndalimin e punimeve për ndërtimin e HEC të katërt. Arsyet janë të shumta, por mjafton vetëmm tre pyetjet më poshtë fakt që këto punime të ndalojnë:

1-A janë pyetur këta banorë për ndërtimin e këtij HEC?

2- A rrezikon ky HEC të zhduke një nga pasuritë më të mëdha ujore të ujit të pijshëm, burimet e famshme të Sopanikës, të cilat janë të rregjistruara edhe si pasuri natyrore?

3- A kanë firmosur banorët e ketij fshati dhe fshatrave të tjerë në një dokument që lejon dhënien e lejes për ndërtimin e këtij HEC?

Banorët që po ndiqen penalisht thonë se nuk kanë firmosur, madje edhe akuzojnë se dikush ka firmosur në emrin e tyre. Kur këlthasim e bërtasim për reforma e për drejtësi, a nuk do ishte e udhës, që përpara se të hetohen 20 kryefamiljarë, të verifikohen nëse firmat e vëna në dokumentacionin për marrjen e lejes janë ose jo të fallsifikuara? N.q.s. ato rezultojnë të tilla, a nuk duhet që drejtësia të merret me ata që kanë fallsifikuar firmat dhe dokumentacionin?

Të kërcënosh kryefamiljarët e një fshati me ndjekje penale nuk është drejtësia e duhur. Ky është vetëm një mekanizëm presioni e frike, që edhe diktatura që përcollëm në vitet '90 ishte e kujdesshme kur e përdorte.

Ndaj është kohë që institucionet të veprojnë. Së pari, deputetët e Dibrës duhet të shkojnë dhe ti takojnë këta 20 kryefamiljarë. T'i dëgjojnë ata, sepse ndonjëri prej tyre e ka marrë votën e tyre. Është koha që kryetari i bashkisë, institucionet e shoqatat në mbrojtje të mjedisit e zyrtarë qëmbajnë përgjegjesi për mjedisin në Shqipëri, të shkojnë në terren, të dëgjojnë dhe të mbajnë qëndrim. Duhet të ikë sot koha kur thoshim se "me dokumentet janë në rregull". Sepse në rregull janë kur të jenë në rregull me njerëzit dhe me natyrën...

Mund ta zgjasja më shumë këtë koment, por po e mbyll sërish me lumin Spree.

Fan Noli, kur e ka shkruar vjershën "Anës Lumenjve", me siguri ka qenë ulur buzë këtij lumi:

Arratisur, syrgjynosur,/ Rraskapitur dhe katosur,/Po vajtoj pa fund, pa shpresë,/Anës Elbës, Anës Spree-së...

A ka avokatë dibranë t'i dalin zot Setës?

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Njëzet banorë të Arrasit pse kërkuan që të mos shkatërrohet pasuria më e madhe e brezave, pasuri e mbrojtur me gjak jo vetëm nga pushtuesit serbë por në veçanti nga synimet e Zogollit të Matit që kufijtë e pyjeve dhe kullotave ti shtrinte deri në Setë. (historianët le ta zbardhin) janë proceduar penalisht sepse penguan një firmë që për interesat e korrupsionit të hapur po shkatërron gjithçka për të bërë një HEC fitimprurës.

Nuk ka ndodhë në asnjë rast jo vetëm në Shqipëri por edhe në Evropë që një fshat i tërë të penalizohet dhe të burgoset.

pse mbron tokat e tij, kullotat e tij, burimet ujore të tij, shtetëzuar nga regjimi monist dhe rishtetëzuar nga regjimi demokratik.

Në Shqipëri ndodhi e pabesueshmja. Toka u shpërnda me "litarë" për frymë të popullsisë. Kënetat e kthyera në tokë buke, pronë e askujt u ndanë për banorët e zonave rreth e qark.

Pyjet dhe kullotat, pronë me dokumente historike, baza e jetës shekullore të banorëve të maleve, mbeten "pronë shtetrore", "mall belik" mbi të cilët ra sopata si në Qerbela por edhe iu vu (dhe vazhdon tu vihet) zjarri. Banorët e këtyre zonave nuk kanë asnjë të drejtë që të ndërtojnë bazën e jetës mbi pasuritë e të parëve të tyre.

Në Shqipëri gazetat ditë për ditë, në faqe të parë, nxjerrin lajme për kompensimin dhe dëmshpërblimin e pronarëve.

Për kompensimin dhe dëmshpërblimin e pronarëve të kullotave, pronarë në shumicën e rasteve kolektivë mbi bazë fshati apo lagjeje, nuk flitet fare. Mbi këto prona kujtëdo që ka një qese të fryrë me para i lëshohen leje ndërtimi.

Rasti "Arrasi", rasti "Seta" duhet të zërë faqet e para të medias së shkruar dhe asaj vizive,

Lush i thotë vetes "gazetar" të flasë e shkruaj

Për mbrojtjen e banorëve proceduar penalisht, avokatët dibranë, kolektivisht, duhet të zbresin në Arras, Sinë e Çidhën. Ata duhet ta mbrojnë Setën për të hap rrugën për mbrojtjen e Luginës së Drinit të Zi nga mbytja pa kthim nga ndërtimi i HEC-it të Skavicës.

O SOT O KURRË ATA DUHET TË JENË NË DIBËR, NË ARRAS, SINË, ÇIDHËN...DIBRA KA NEVOJË PËR MBROJTJEN E TYRE.

Historia nuk do tua falë po qe se qëndrojnë indiferent !

SHËNIM I REDAKSISË:
Në lidhje me "Çështjen Seta" dhe çështje të tjera të ngjashme, redaksia nuk mban anë. Ashtu si edhe në të kaluarën, ne mbetemi të hapur për t'i dhënë hapsirë zërit të qytetarëve! Mbetet detyrë e institucioneve përgjegjëse për t'i dhënë zgjidhje çështjes në dobi të publikut!

Qyteti zhurmon nga dasmat, pyjet shkrumbohen nga zjarri

Nga **SAMET ZAGRADI**



Malet përreth fshatit Vajkal, pranë Liqenit të Zi në Bulqizë, edhe këtë vit u përfshinë nga zjarret që dyshohet se janë të qëllimshme. Zjarret këtë vit rrezikuan shtëpitë e fshatit dhe u desh ndërhyrja e banorëve që ato të fikeshin. Foto personale: Facebook/donika.hysenaj.



Dajallarët. Foto: S. Nelhani/ Bulqizaime.com

KTHIMI I EMIGRANTËVE...

Erdhi vera dhe mbi të gjitha erdhën njerëzit. Qyteti që dikur mbytej në monotoninë e tij, sot mbushet përplot si asnjëherë me njerëz që kishin vite pa e ndier erën fantastike të blirëve. Pa shijuar drekat, darkat aromën dhe mallin e të afërmve që prej vitesh nuk shohin. Mëngjeset tashmë janë ndryshe dhe pse e dimë se për pak kohë, sa të mbarojnë pushimet pastaj çdo gjë do jetë si më parë. Disa prej tyre nuk dinë shqip pasi kushtet erdhën kështu. Disa ikën dhe erdhën duke mos gjetur të gjallë personat që i rritën e që në zemër malli i djeg për to. Disa u martuan matanë, krijuan familje dhe po punojnë dukë lënë këtu të shkuarën, fëmijërinë e një pjesë të zemrës dhe ndjenjave të tyre, që prej kohësh janë larg Dibrës tonë të dashur. Por vera i mblodhi prapë ato duke bërë që ajo të shijohet më shumë se çdo stinë. Atmosfera ndihet kudo. Që herët në orët e para të agimit automjete me targa të huaja qarkullojnë duke krijuar si rrallë herë trafik në qytetin tonë. Lëvizjet shtohen ndjeshëm duke bërë që ditët të jenë më ndryshe. Vapa përvëluese e korrikut nuk pengon aspak xhirot në bulevard, duke shijuar kafetë nën shoqërinë e miqve, familjarëve dhe pse jo duke vizituar të afërmit e tyre duke qenë se koha e emigrantit nuk pret shumë. Teksa përpiqesh të çash me vështirësi përmes bulevardit tashmë të rikonstruktuar, shpesh të ndodh të shohësh fytyra "se ku i ke parë", të takosh njerëz që prej vitesh nuk i ke takuar apo në raste të veçanta të kërkosh dikë që duhet të takosh patjetër. Bulevardi "maskilist" nuk ekziston më, të paktën për pak ditë duke bërë atë të ndryshëm nga monotonia e tij e zakonshme. Kafetë, restorantet, qendrat estetike, klinikat dentare apo edhe trafiku në rrugë funksionojnë në kapacitet të plotë duke bërë të ndryshme atmosferat.

DASMAT...

Dasmat janë një ndër aktivitetet kryesore jo vetëm në rrethin e Dibrës por në të gjithë Shqipërinë. Ardhja e emigrantëve ndikon ndjeshëm në numrin e madh të ahengjeve. Kudo dhe gati çdo natë dëgjohen miksime të ndryshme, DJ që pothuajse luajnë të njëjtën muzikë në të gjithë dasmat. Valle, lodhje, pagjumësi, argëtim pa fund e ca para të harxhuara duke ruajtur akoma traditat dhe duke shijuar në maksimum atë. Traditat akoma ruhen me fanatizëm dhe pse jo aq të theksuara sa disa vite më parë. Ardhja e dajave akoma shoqërohet me muzikën tradicionale të daulleve, marrja e nuses me makina të shumta që me thënë të drejtën krijon një atmosferë me të vërtetë të jashtëzakonshme. Netët e banketeve që kulmon dasmën janë më interesante. Është pikërisht vendi që dasma bëhet më e modernizuar e caqet e tradicionales ndryshojnë disi. Gjatë stinës së verës emigrantët sjellin një frymë pozitive në qytet. Dasmat janë më të shumta në këtë stinë dhe përveç atmosferës pozitive ato sjellin edhe përfitime ekonomike. Lokalet, banketet, marketet, qendrat estetike e shumë biznese të tjera këto muaj kanë lulëzimin ekonomik të tyre. Pra dasmat përveç faktorit social japin ndihmën e tyre dhe në faktorin ekonomik ne disa biznese.

PROBLEMET ME VAPËN DHE ZJARRIN...

Vapës marramendëse dhe jo të zakonshme nuk i kanë shpëtuar as emigrantët dhe as qytetarët e Dibrës. Gjatë muajit korrik dhe në fillimet e gushtit temperaturat e mëdha mbërthyen të gjithë Europën. Shërbimet meteorologjike thonë ky vit ka qenë një ndër vitet më të thata dhe më të nxehtë krahasuar me disa vite që kemi kaluar. Si rezultat i kësaj temperature zjarre të mëdha shkrumbuan hektarë të tërë me pyje në fshatin Bllacë të Maqellarës, në fshatrat dhe pyjet e Bulqizës, në Muhurr dhe në pyjet e parkut kombëtar të Lurës. Prefekti i qarkut Dibër zoti Ardit Kaja është shprehur për mediat që zjarret janë të qëllimshme. I vendosin barinjtë që të ripërtërijnë kullotat ose firmat që kanë licencë për shfrytëzimin e pyjeve. Punonjësit e pyjeve, shtabi i emergjencave civile, policia dhe forca zjarrfikëse kanë dhënë ndihmën për shuarjen e zjarreve duke qenë që ato po rrezikojnë banesat. Helikopterët po japin ndihmën e tyre në zonat me terren të thyer pasi shërbimet zjarrfikëse nuk kanë mundësi të kryejnë këtë mision. Ky problem shqetëson të gjithë qeverinë shqiptare pasi dihet që i gjithë territori është përfshirë nga zjarri. Autoritetet tona kanë kërkuar ndihmën e fqinjëve për të dalë nga kjo situatë.

MUNGESA E UJIT TË PIJSHËM...

Problemi që temperaturat e larta ka sjellë në vendin tonë nuk kanë qenë vetëm zjarret. Peshkopia prej disa javësh po vuan problemin e furnizimit të qytetarëve të saj me ujë të pijshëm. Qytetarët ankohen të revoltuar se pavarësisht pagesës korrekte të faturave të ujit, në çezmat e tyre nuk po pikon as dhe një pikë e ujit që ato po e paguajnë. Kjo është situata që mbizotëron në qytet ku dhe pse temperaturat rreth 40 gradë, qytetarët nuk kanë ujë. Vetëm dy orë në ditë dhe rreth 80% të banorëve nuk kanë akses pasi në katet e larta as që është e mundur që uji të ngjitet. Ndërmarrja e ujësjellësit Peshkopi po kryen kontrolle rutinë në tubacione ku krahas temperaturave të larta, ndërhyrjet në tubacione nga persona për interes vetjak çon qytetin në këtë situatë. Punëtorët e ndërmarrjes së ujësjellësit kryejnë çdo ditë kontrolle dhe në lavazhet e gjithë qytetit duke kontrolluar nëse ka persona që keqpërdorin ujin e pijshëm. Nuk dihet akoma se kur situata të jetë normalizuar dhe kur qytetarët të mos dalin me mjete primitive për të siguruar lëngun më të rëndësishëm të jetës. Deri atëherë na mbetet të presim…

KUJTOHET DITA E ÇLIRIMIT TË DIBRËS

Përkujtohet 23 gushti, dita e çlirimit të Dibrës. Bashkia Peshkopi nuk mund të linte pa kujtuar dhe festuar një nga festat më të rëndësishme që ka qyteti i Peshkopisë. Në ceremoni mori pjesëe dhe perfekti i qarkut Dibër zoti Ardit Kaja i cili ka mbajtur fjalën e rastit në nder të sakrificave sublime të të gjithë atyre dëshmorëve dhe veteranëve që kontribuan me luftë dhe gjak për çlirimin nga pushtimi i tmerrshëm Nazifashist. Aktivitete përkujtimore, parada, fjalime dhe vizita në varrezat e dëshmorëve kanë qenë pjesë e kësaj dite kaq të veçantë për Dibrën dhe Dibranët. Bashkia u kujdes edhe për pamjen vizuale duke vendosur përgjatë bulevardit kryesor pankarta ku shkruanin falënderime për dëshmorët dhe brigadat që bënë të mundur që Dibra të çlirohej nga zaptuesit që prej vite me radhë kanë pushtuar jo vetëm Dibrën por të gjithë Shqipërinë.

TURIZMI NË LUMIN DRIN & NË MALIN E KORABIT

Sezoni turistik pothuajse është në kulmin e tij. Qytetarët dibranë dhe jo vetëm, janë drejtuar drejt brigjeve të deteve për të kaluar disa ditë larg zhurmave dhe streseve të jetës së përditshme. Por a kanë mundësi financiare të gjithë qytetarët të kalojnë pushimet verore në det? Kësaj pyetje i jep mjaftë mirë përgjigje natyra kaq bujare me Dibrën dhe qytetarët e saj. Brigjet e lumit Drin pothuajse gjatë gjithë shtrirjes gjeografike në territorin tonë ka shërbyer si alternativë mjaft optimale për zhvillimin e disa ditë pushime. Uji mjaft i pastër dhe mundësia ekonomike ka qenë një arsye përse këto brigje kanë qenë të populluara gjatë pothuajse gjithë verës. Muhurri, Luznia, Selania apo Potgorca kanë qenë destinacionet më të frekuentuara, pavarësisht sistemit rrugor mjaft të amortizuar që këto fshatra kanë. Banorët e këtyre fshatrave dhe jo vetëm janë munduar të krijojnë disa kushte minimale për banorët që kanë zgjedhur t'i kalojnë pushimet pranë biznese provizore të tyre. Turistë të shumtë të huaj dhe shqiptarë preferojnë edhe turizmin malor. Guida turistike janë përgatitur për t'u ardhur në ndihmë turistëve duke vizituar atraksionet më të bukura që natyra e pakursyer i ka dhënë Dibrës. Mali Korabit, Bjeshkët e Radomirës, Parku Kombëtar i Lurës e shumë vende të tjera janë pika kyçe të turizmit malor që turistët kanë mundësi të kalojnë në Dibër.

Vlera turistike e ujërave qëndron në mundësitë që ato ofrojnë për banja dielli, banja uji për turistët si dhe për zhvillimin e një sërë sportesh (notit, peshkimit e sporteve të tjera)

Potenciali turistik i luginës së Drinit të Zi



Pushues buzë Drinit të Zi, Katund i Ri 2017. **Foto: *F. Cena.***

Nga **Dr. FATBARDH CENA**

Vlera turistike e ujërave qëndron në mundësitë që ato ofrojnë për banja dielli, banja uji për turistët si dhe për zhvillimin e një sërë sportesh (notit, peshkimit e sporteve të tjera). Larja në lumenj e kombinuar me banjat e diellit, ndikon mbi disa funksione të veçanta të organizmit të njeriut. Kështu për shembull simulon oreksin, vepron mbi sistemin nervor etj., pra ndikon në mënyrë pozitive mbi gjendjen fizike dhe psikike të njeriut. Sportet e ujit, si formë e pushimit aktiv, kanë efekte të mëdha argëtuese. Joshja e lumenjve qëndron, si në mundësinë e banjave diellore, ashtu edhe me sportet e ndryshme ujore apo bukuritë që jepen shpesh nëpërmjet ujëvarave dhe kaskadave që ato formojnë.

Lugina e Drinit të Zi shtrihet midis vargut malor të Korabit në lindje e vargmaleve të Lurës dhe malësive Martanesh-Gollobordë në perëndim. Radhitet ndër luginat më të mëdha e më të rëndësishme të vendit tonë si nga tiparet fiziko-gjeografike, ashtu edhe nga vlerat ekonomike. Në territorin e Shqipërisë fillon nga fshati Gjoricë e Poshtme dhe përfundon në pellgun e Kukësit në veri ku bashkohet me luginën e Drinit të Bardhë, me një gjatësi rreth 75 kilometër. Në rrethin e Dibrës kjo luginë fillon nga territori i njësisë administrative Maqellarë dhe përfundon në afërsi të fshatit Skavicë në Kukës.


Në hyrje të Urës së Topojanit e deri tek gryka e Hoteshit, fundi i luginës ngushtohet shumë duke marrë shpeshherë pamjen e grykave, ky spikat në veçanti gryka e Gradecit. I vetmi zgjerim i luginës në këtë prag është ai në fshatin Kovashicë, ku është formuar një fushë e vogël aluvionale nga konet e depozitimit të dy përrenjve që derdhen këtu. Nga gryka e Hoteshit e deri në Fushë Çidhën, lugina kalon nëpër pellgun e Peshkopisë, struktura grabenore e të cilit ka përcaktuar mjaft tipare të relievit të saj, veçanërisht zgjerimet e njëpasnjëshme që ajo pëson. Zgjerimi i fundit i luginës në këtë pellg bëhet në Fushë Çidhën. Ai ka një gjerësi maksimale 2.7 kilometër dhe një gjatësi 4 kilometër. Në formimin e tij rol të rëndësishëm kanë luajtur gjithashtu materialet proluvionale të përroit të Gramës dhe të Setës.

Duke nisur nga Fushë Çidhna, fillon pjesa veriore e luginës e cila ka ndryshime të theksuara morfologjike nga pjesa jugore e saj. Në të gjithë shtrirjen, nga Fushë Çidhna deri tek Ura e Dodës, lugina pëson vetëm dy zgjerime, zgjerimin e Zall Dardhës dhe atë të Draj Reçit. Pasi kalon Zall Dardhën, lugina ngushtohet menjëherë, ku shtrati i saj është vetëm 10-15 metër i gjerë, me shumë gjarpërime dhe shpate tepër të pjerrëta. Duke filluar nga Ura e Dodës dhe grykëderdhja e përroit Malla e Lurës, lugina ndryshon përsëri tiparet morfologjike dhe drejtimin nga veriu për në verilindje. Në mjaft sektorë ajo merr tiparet e një kanioni, ku dallohet ai i Skavicës me thellësi mbi 200 metër e gjerësi 6-8 metër. Përgjatë luginës së Drinit të Zi, përveçse është përqendruar zhvillimi i ekonomisë bujqësore të Dibrës, ofrohen mundësi reale për zhvillimin e turizmit lumor.

Në rrethin e Dibrës lumi kryesor është Drini i Zi dhe degët e tij. Drini i Zi me një gjatësi 149 kilometër dhe pellg ujëmbledhës 5885 km^2, buron nga liqeni i Ohrit. Pasi përshkon një rrugë prej rreth 40 kilometër, hyn në Shqipëri duke u hapur në vazhdim në një shtrat shumë të gjerë. Në këtë sektor të rrjedhjes së tij merr shumë degë të vogla dhe me rrjedhje të paqëndrueshme. Rënia e Drinit të Zi deri në derdhjen e tij në liqenin e Fierzës është afër 3m/km. Ka pellg ujëmbledhës shumë të thyer dhe me kontraste të mëdha të relievit që përbëhet nga një larmi formacionesh. Pellgu ka një veshje bimore të dendur në përgjithësi. Degët e tij si përroi i Murrës, Veleshicës, Banjave, Malla e Lurës etj., kanë pellg malor tepër të thyer dhe karakter torrencial. Këto degë zbresin vrullshëm drejt shtratit të Drinit duke krijuar forma të tilla si gryka, kanione etj., të cilat janë shumë të vështira për lëvizje, por në aspektin turistik paraqiten mjaft tërheqëse. Duke qenë se burojnë nga bjeshkët dhe ushqehen nga shkrirja e akujve dhe borës, dallohen për ujë të ftohtë e të pastër.

Buzë lumit të Drinit të Zi janë kryer disa investime për zhvillimin e turizmit lumor në këto zona. Kështu janë ndërtuar bare, restorante, ambiente sportive etj., në disa zona rurale si: Potgorcë, Topojan, Gradec, Selane, Katund i Ri, Muhurr, Fushë Alie, Reç etj. Duke qenë se këto zona ndodhen afër zonave të banuara dhe qytetit të Peshkopisë, gjatë verës ka pushues të apasionuar pas turizmit lumor si dhe ato që nuk kanë mundësi të shkojnë në bregdet, e kanë si formë alternative të pushimeve. Rafting i zhvilluar në lumin e Drinit të Zi, ka qenë një risi e viteve të fundit dhe mjaft tërheqëse për turistët e huaj dhe vendas. Ka raste që nisja fillon që nga Ura e Topojanit dhe përshkohen kilometra të tëra duke shijuar pamjet që ofron lugina e Drinit. Në Drinin e Zi dhe degët e tij, rriten një numër i madh peshqish, të cilët njihen për ushqimin e shijshëm të tyre, por shërbejnë edhe për të apasionuarit e peshkimit. Peshkimi është aktivitet i cili kryhet përgjithësisht në gjithë rrjedhën e lumit dhe në shumicën e rasteve në mënyra të paligjshme.

Ka më shumë se 10 vite që është bërë traditë çdo vit aktiviteti i quajtur "Festa e Drinit". Ky aktivitet festiv shënon hapjen e sezonit turistik në lumin e Drinit të Zi dhe zhvillohet në Muhurr. Vihet re pjesëmarrje pothuajse nga të gjithë anët e Dibrës. Qëllimi i aktivitetit është jo vetëm hapja e sezonit turistik në lumin e Drinit të Zi, por edhe promovimi turistik i kësaj zone. Sezoni turistik përgjithësisht hapet me datën 1 korrik, por kjo varet edhe në varësi të kushteve klimatike. Festimet në këtë ditë janë të shumta si: muzikë, këngë, valle, aktivitete të ndryshme sportive etj. Vizitorët kanë mundësi të shijojnë dhe gatimet tradicionale të zonës.



Itinerari turistik Peshkopi-Drini i Zi (Muhurr). **Punoi: *F. Cena.***



Rafting në lumin e Drinit të Zi, Ushtelenxë 2016. Foto: F. Cena.

Burimet e shfrytëzuara:

1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Gjeografia fizike e Shqipërisë*, Vëll. I, Tiranë 1990.
2. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Gjeografia fizike e Shqipërisë*, Vëll. II, Tiranë 1991.
3. ALCDF, *Plani i zhvillimit të turizmit për trevën e Malësisë së Dibrës.*
4. Bashkia Peshkopi, *Guidë turistike*, Tiranë 2010.
5. Cena, Fatbardh., *Turizmi në rrethin e Dibrës. Studim gjeografiko-turistik.* Disertacion, Tiranë 2017.
6. Cena, Fatbardh., *Protected areas in the district of Dibra and assessment of their tourist,* International Journal of Academic Research and Reflection, Vol. 4, No. 4, United Kingdom, London 2016.
7. Cena, Fatbardh., *Natural and cultural heritage of Dibra district.* The 4-th International Multidisciplinary Conference in Integrating Science in New Global Challenges. Dubrovnik, Croatia. Vol.3/2015.
8. Cena, Fatbardh., *Turizmi dhe zhvillimi i qëndrueshëm në rrethin Dibër,* Studime gjeografike 19, Tiranë 2015.
9. Doka, Dhimitër., dhe Draçi, Bilal., *Gjeografia e turizmit,* Tiranë 2002.
10. Koja, V., dhe Gorica, K., *Bazat e turizmit,* Tiranë 2010.
11. Qiriazi, Perikli., *Gjeografia fizike e Shqipërisë,* Tiranë 2001.
12. Shoqata Lidhja e Intelektualëve Dibranë, *Rruga e Arbërit*, Tiranë 2007.

vendlindja

Kalaja e Dodës
në ndarjet administrative

Nga **METUSH SKEJA**

Dokumenti i parë i shkruar për Kalanë e Dodës është i vitit 1571. Ai është regjistrim osman. Në regjistrimet e vitit 1468 Kalaja nuk është përfshirë në defterin osman. Mendimi i studiuesve të historisë është se Kalaja më 1468 nuk ka qenë e pushtuar akoma nga osmanët. Në vitin 1571 banorët e Cerenit kanë pasur katër mbiemra të gjithë shqip, asnjë sllav. Në vitin 1591 Cereni ka pasur akoma edhe 23 shtëpi të krishtera. *"Renta feudale në akça është për Bloshtanin 1500, Ceren 1000, Shullan 1500, Shin Andrea 1000, Radomir3000, Taksa e dhenve në mallet e Sharrit ku përfshihet edhe Kalaja 120.000. Feudet hass i padishahut. (Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, Studime historike 4, Tiranë 1973).*


Në Kala të Dodës nuk janë bërë gërmime arkeologjike shkencore nga profesionistë. Në Ploshtan më 1968 u hap traseja e rrugës automobilistike. Në vendin e quajtur Ara e Vakefit u zbulua e doli në sipërfaqe një tumë, varret e të cilës i përkisnin periudhës para Krishtit. Mësuesi Shehat Palushi ka matur një rrasë varri të këtij vendi dhe i ka dalë 2m e gjatë. Më 1968 poshtë fshatit Dode, që vendasit e quajnë Llagaçe, rrëshqiti toka. Mësuesit pasionant Sulejman Istrefi e Ismet Sinani gërmuan e kanë gjetur dy enë qeramike të periudhës ilire, që nxënin afro 1.5 l secila. Njëra enë ka qene e ilustruar nga jashtë. Në vjeshtë 1968 ne Rrafshe të Dode, te vendi i quajtur Dardha, toka u punua me traktor afro një metër thellë. Në këtë vend doli një enë e madhe qeramike sa një njeri në këmbë. Afër sipërfaqes bazës kishte derë, po kështu edhe nga sipër kishte kapak. Kjo shërbente për mbajtjen e grurit. Te Dardha u gjetën tulla të holla dhe tjegulla më të holla me disa vija sipër secila. Këto gjetje u shkatërruan më 1991.

Pas viteve 1990 persona anonim kanë kërkuar për ar (florinjë) nëpër varre të vjetra si në Ceren te Kisha, në Kishën e Tallamazit, në kishën e Dërbaçit etj. A kanë gjetur ar nuk e di, por e di se zbuluan "teknologjine" e ndërtimit të varreve, që i përkasin periudhës para e pas Krishtit.

Një pyetje bëhet natyrshëm. Nga cili fis ilir ka qenë e banuar Kalaja e Dodës? Përgjigja mbart shumë diskutime. Parim Kosova, drejtor i muzeut të Prizrenit, në studimin e tij për Sharrin thotë se "dardanët shtriheshin deri në rrëzë të Korabit". Të njëjtin mendim ndajnë edhe studiues të tjerë. Ndërsa akademik Kristo Frashëri në librin e tij "Historia e Dibrës" thotë se "Penestët shtriheshin deri në Morinë të Lumës, ku përfshihet edhe Kalaja e Dodës". Ideja se penestët shtriheshin deri në Morinë është hedhur poshtë me kohë nga zbulimet arkeologjike në rrethin e Kukësit. Arkeologët shqiptarë kanë vërtetuar se Luma ka qenë e populluar nga dardanët. Kush ka dyshime për këtë le të vizitojë muzeun arkeologjik të Kukësit. Interesante është shpella e Imer Agës në Stogje.

Në Kala të Dodës ka shumë kisha katolike. Po kështu ka shumë emra vendeshe të periudhës katolike. Do të ishte me vlerë përcaktimi i moshës së kishës Tallamazit me metoda fizike, duke përcaktuar moshën e sakët të gëlqerës, që është përdorur në ndërtim të kësaj kishe. Te kjo kishë janë gjetur mozaik qelqi. Më 1055 kur u nda kisha katolike në të perëndimit dhe të lindjes Kalaja bënte pjesë në kishën e bizantit me qendë në Kostandinopojë. Në lagjen Kullas gjendet topononi Llaze, që i përgjigjet kësaj kohe. Në shekullin e 13-të Kalaja përfshihej në Shtetin e Arbërit.

Si njësi etokulturore e etnopsikologjike Kalaja e Dodës ka ngjashmëri më shumë me Lumën. Marin Barleti thotë se Kalaja shtrihet deri te Veleshica, (që prindërit e gjyshërit tanë e quanin Valashacë), ndërsa Gjon Nikollë Kazazi thotë se Kalaja shtrihej deri në Çidhën. Të dy këto autorë përdorin togfjalëshin "*si na*". Kalaja ka qenë qendër e krahinës së Lumës. Kur perandoria osmane filloi të dobësohet, pas vitit 1878, qendra kaloi në Bicaj. Në të gjitha dokumentet osmane përmendet fjala Kala. Është e shkruar në osmanisht kështu si më poshtë po jap edhe përkthimin në shqip:



Fjalën Lumë studiusit e lidhin me praninë e shumë lumenjeve në territorin e saj. Sipas tyre, Luma shtrihej edhe në zonën e Rekës. Banorët e pjesës perëndimore, duke qenë më të varfër, kanë vjedhur në pjesën lindore të pasur. Këto të fundit ndryshuan emrin në Rekë për t'u veçuar, që shqip përkthehet lum. Ka ngjashmëri të shumta në veshje dhe në gjuhë mes Shtiravicës, Rekës e Radomirës.

Në periudhën osmane Kalaja ka qenë Kaza dhe "*quhej kazaja e Radomirës*" (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Historia e Popullit Shqiptar*, Tiranë, 2002, vol.2, f.44). Fjala kaza do të thotë rreth. Më 1869 Kalaja bënte pjesë në vilajetin e Shkodrës më pas në vilajetin e Prizrenit, Prishtinës e Shkupit. *"Më 1873 kufijtë e vilajetit të Shkodrës u ngushtuan në favor të një vilajeti të ri, të vilajetit të Prizrenit, i cili përfshiu gjithë Kosovën së bashku më sanxhakun e Dibrës, të Shkupit e të Nishit"* (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Historia e Popullit Shqiptar, vol.2, Tiranë, 2002, f.41).

Në Kongresin e Lushnjës, 1920, Kalaja e Luma përfshihet në prefekturën e Dibrës. Në vitin 1922 u krijua prefektura e Kosovës që përfshinte Malësinë e Gjakovës, Hasin e Lumën. Kalaja kaloi me prefekturën e Kosovës. Deputet të prefekturës kanë qenë Hasan Prishtina, Rexhep Mitrovica, Bedri Pejani. Kalanë e mbulonte Hasan Prishtina. "*Nga viti 1922 deri 1944 Kalaja ka qenë komunë më vete. Përfshintë 16 fshatra me emrin Komuna e Ploshtanit, me qendër në Ploshtan, kategoria e dytë. Fshatrat janë: Bushtricë, Buz Madh, Ceren, Çajë, Dodaj, Fshat, Gjegjan, Kalis, Matranxh, Palushaj, Ploshtan(Q), Radomir, Shqinak, Shullan, Vasie, Vilë*" (Fletorja zyrtare, qershor 1938, f.22).

Disa nga kryetarët e komunës së Ploshtanit kanë qenë: Thanas Rexha, pjesmarrës në kryengritjen e Fierit, sekretar Qerim Cani (Skeja), Fiqiri Skenderi, Hafuz Fiqiriu nga Tetova. Fatkeqësisht, një kryetar komune në kohën e Mbretërisë u vra dhe një tjetër u rrah barbarisht. Më 1945 nga komunë u kthye në lokalitet me qendër në Ploshtan dhe përfshintë 16 fshatëra. Kryetari i parë i lokalitetit ka qenë Mehmet Kupa, sekretar Sabri Potja, më pas kryetar Sami Tola, sekretar Selim Daku. Në vitin 1953, tetë fshatra nga Kalaja kalon me rrethin e Dibrës, lokalitet Sllovë. Më 1970 u krijuan këshillat e bashkuar. Kalaja quhej këshilli i bashkuar Kala e Dodës me qendër në Ceren. Përbëhej nga këto fshatra: Ceren, Radomirë, Ploshtan, Shulla, Vasije. Kryetari i parë këshillit të bashkuar ka qenë Hivzi Selmani, sekretar Hasan Skeja. Në vitin 1992 u krijua komuna Kala e Dodës me qendër në Ceren. Kryetar Fadil Daku, sekretar Shukri Lita. Që nga zgjedhjet lokale të vitit 2015, Kalaja e Dodës i përket Bashkisë Peshkopi.



Nga **OSMAN XHILI**

Sapo hyn në qytetin e Peshkopisë, ngrihen dy ndërtesa, nje restorant dhe një punishte për përpunimin e frutave, prone e familjes se nderuar Zerja. Kalimtarë të shumtë, që shkojnë në të dy anët e rrugës, ndalojnë për një moment makinat për të shijuar kafen, picat dhe ushqimin e restorantit që servir Flamuri me familjen e tij. Më pas hedhin vështrimin në punishten e famshme, ku gjen fruta e perime të përpunuara e konservuara në mënyra të ndryshme dhe ti nuk mund të ikësh pa marrë e provuar diçka.

Feta Zerja, babai i dy djemve, Fatosit dhe Flamurit, punoi një jetë të tërë si shofer dhe nuk arriti të bëjë prokopi të madhe. Jo se punoi pak, jo se nuk kishte dëshirë, por aq lejonte koha, sistemi. Nga gjithë ajo punë, bashkë me të shoqen, Lumen, përfituan nga një pension të vogël, sa për pleqëri. Familja trashëgonte jo pak tokë në Ravna, mbi pesë hektarë. Aty kishin dhe pemtore, të cilës do ti shërbenin akoma më mirë, po qe se do ta kishin afër. Me kursime të mëdha, diku nga viti 1993, ndërtuan një shtëpi të thjeshtë. Më pas e përshtatën për një lokal pune. Në fillim pak i frekuentuar, pastaj gjithnë e më shumë, deri sa ditët e sotme është një ndër lokalet më të preferuara në Peshkopi. Një pishinë që kënaq fëmijët në stinën e verës dhe katër shtëpi druri përqark për mysafirët e rastit, janë një vlerë e shtuar për restorantin e tyre, tashmë të njohur. Flamuri, djali i vogël i Fetait, është dhe menaxheri i restorantit. Ndihet i qetë e i kënaqur me punën. Klientela e tyre, në shumicën e rasteve, janë familje që vijnë të qetësohen me një drekë apo darkë. Shpesh, gëzimet e tyre mendojnë ti kalojnë këtu në këtë vend, që Zoti e ka bërë të bukur dhe njerëzit ia kanë shtuar akoma më shumë vlerat dhe bukurinë.

JUFKAT ZERJA

E shoqja e Fetait, nënë Lumja, gatuante shpesh jufka në lokalin e tyre, për miq e klientë. Nusja e madhe e familjes, Dashja e ndihmonte shpesh. Kur panë se jufkat e bëra në mënyrë artizanale, pëlqeheshin shumë, menduan ta shtojnë dhe pak prodhimin. I ftollonin me shkopinj, i thanin në çarçafë dhe kënaqeshin me ato pak fitime. Nuk e dinin se do të arrinin të prodhonin 150 kilogramë në ditë, duke u vënë etiketën e famshme "Jufka Zerja". Nënë Lumja nuk ka më fuqi dhe biznesin e filluar e vazhdon nusja, Dashuria me familjen e saj.

– Edhe pse teknologjia është përmirësuar, shumica e proceseve janë natyrale - thotë Dashja, menaxherja e re, qoftë në prodhimin, por dhe tharjen e tyre. Ajo nuk trembet për shitjen e prodhimit. Problemi është a do të jetë në gjendje të punojë e të prodhojë. Klientela e saj është e larmishme, që nga dibranët e këtushëm, deri te ata matanë kufirit, që nga

profil

"Jufkat Zerja" po bëhen të njohura brenda jashtë vvendit, ndërsa po kërkojnë suksesin edhe në përpunimin e frutave dhe bimëve mjekësore. "Te Zerja" në hyrje të Peshkopisë po kthehet në një pikë referimi për produktet origjinale bio dhe traditës etnografike të Dibrës

"Zerja", suksesi që vjen përmes traditës











Struga e Shkupi, deri në Itali, Kanada dhe Amerikë. Gjithë familja i është përkushtuar biznesit, që sa vjen dhe zgjerohet. Fabiani, djali i madh i familjes, është në përfundim të masterit për inxhinieri, por ky fakt, jo vetëm që nuk i rrit mendjen, por e bën më të mendueshëm e të përgjegjshëm. E sheh aty tek makina e brumit, teksa pret petën e rradhës duke e dërguar më tej për ta prerë në rrypa e shirita. Po kështu punon motra që ka mbaruar për mjekësi dhe bën specializimin në Turqi, apo vëllai i vogël Albi, që merret me ambalazhimin dhe paketimin e prodhimit. Këto dhe punëtore te tjera të punësuara punojnë si një ansambël harmonik për vite me rradhë. Shpesh, mashtrues dhe falsifikatorë, përdorin emrin e mirë të "Jufkës Zerja" për të shitur prodhimet e tyre, jo dhe aq cilësore. Përveç anës negative për vetë prodhuesin e vërtetë, kjo tregon dhe njëherë atë vlerë dhe atë nivel, atë besueshmëri te konsumatori që ka krijuar kjo markë.

TË TJERA PRODUKTE

Dy vëllezërit Zerja, Fatosi dhe Flamuri kanë në pronësi rreth pesë hektarë tokë, nga e cila mbi gjysma është pemtore. Vetëm qershia zë mbi dy hektarë tokë. Dashurie Zerja, menaxherja e përpunimit të frutave e perimeve, jo vetëm që i njeh me varitete, por është në gjendje të flasë dhe për cilësitë dhe vlerat e secilit lloj. Ajo zakonisht përdor tre llojet që gjenden në fermën e saj, qershinë e zezë, Burlatin dhe Napolon. Këtë të fundit e vlerëson mbi të gjithë, për aromën, konsistencën, duke dhënë komposto dhe reçelna të mrekullueshme. Në pemtoren e tyre ndodhen dhe tetë dynymë kumbulla, duke pasur kaq shumë forma përpunimi. Reçeli, kompostoja, lëngu dhe glikoja janë prezente përherë në raftet e dyqanit të tyre. Dashuria i ka të memorizuara të gjitha në kokë, formulat dhe teknologjitë e çdo produkti që përpunon, sasinë e sheqerit që duhet futur, sasinë e ujit, sasinë e frutave, kohën që duhet për të vluar, apo për tu zier, deri dhe detaje, si ngjyra që duhet të marrë produkti përfundimtar. Në këtë mënyrë përpunohen dhe dardhat, mollat, por ftoin e vlerëson si mbretin e frutave për komposto dhe reçel. Ndoshta fortësia e frutit i jep një epërsi të lehtë mbi të tjerët, por në fakt është vështirë të bësh një klasifikim real e të pikëzuar, pasi çdo njëri prej tyre ka vlerat dhe avantazhet e veta. Nuk di pse mu kujtua dhe po bëj një paralelizëm me grindjen e ngjyrave të ylberit, ku secila pretendonte se ishte më e mira dhe më e dobishme. Në fund u bashkuan me mendimin se ylberi nuk mund të formohej dhe nuk kishte kuptim pa njërën prej tyre. Po të quhej ftoi mbreti, çfarë do të thoshte kumbulla, që aq shumë vlera ka për tretjen dhe lufton kolitin? Po molla, për të cilën thuhet se një kokërr prej saj të konsumosh në ditë, nuk është nevoja për doktor? Pa le pastaj kur të zemëroheshin perimet e frutat e pyllit. Ndaj, secila veç e veç dhe të gjitha sëbashku, janë ai grup ushqimor me vlera, kalori, vitamina, mikroelementë e gjithçka tjetër, që janë aq të domosdoshme për organizmin e njeriut. Ka vite që Dashuria dhe familja e saj përpunojnë kumbullat në hoshaf, sipas traditës së vjetër. Pasi i thajnë, i përvëlojnë me finjë dhe i shpëlajnë sërish, duke qenë të gatshme për konsum. Kaq shumë kërkesa ka për këtë kategori malli, saqë i shet vetëm nëpërmjet telefonit. Mos lemë pa përmendur lajthitë dhe thanat e shumta që gjenden në pemtoren e kësaj familje. Lajthitë shiten të thata, kurse thana bëhet komposto, reçel dhe

> Dashje pa dashje ky dyqan po shërben si pikë grumbullimi, si ekspozitë, si objekt turistik, si vend relaksi e kënaqësie, si vend ku pasqyrohet e kaluara dhe antikja. Por përmasat e dyqanit, sado i madh që është, janë tepër të vogla për të përfshirë projektet që gëlojnë në kokën e zonjës së nderuar.

sidomos lëngu që quhet narden, një aperitiv i mrekullueshëm.

Të paktën një dynym nga toka që disponon, familja e Fatosit i mbjell me perime. Të gjitha gjenden aty, speci, domatja, patëllxhani, qepa, hudhra, kungujt e deri te erëzat. Ata jo vetëm që i ka për konsum familjar, porse përpunohen në forma të ndryshme turshishë, marinatash, apo fërgesa të gatshme. Isha prezent në momentin Kur Makbulja, bashkë me Aishen dhe Mimozën, dibrane që jetojnë në Tiranë, ndalën makinën dhe pasi pasi pinë kafetë, bënë një furnizim në dyqanin e punishtes Zerja. Kaq tunduese ishin vazot e qelqit me reçelna dhe komposto, sa nuk dije kë të zgjidhje më parë. Lëngjet brenda tyre të kuq, më të errët, të verdhë të çelur apo të mbyllur, sikur të magjepsin. Zonjat blenë jufka, vazot e qelqit që përmendëm, trahana, gjizë me spece, apo turshi të stinës dhe u nisën për në Tiranë. Të lumshin duart zonja Dashe, bashkë me familjen. Nderon veten, por pse jo dhe Dibrën, si një ambasadore e traditës dhe vlerave të saj. Punishtja jote u bëftë një fabrikë e mirëfilltë, ku të punësohen sa më shumë njerëz!

FRUTA TE THATA, BIMË MJEKËSORE

Lajthitë dhe arrat janë vetëm disa prej frutave të thata që i gjen zakonshëm në vitrinën e dyqanit. Hoshafi i kumbullave, është një tjetër produkt, por siç e përmendëm është vështirë ta gjesh, për shkak të kërkesave të shumta. Ka kohë që Dashuria po studion me shumë interes bimët mjekësore, duke i futur natyrshëm në koleksionin e saj. Dëllinja dhe boronica, zakonisht të thara, blihen nga banorët e zonës, duke i ndihmuar dhe ata në njëfarë mënyre. Ajo jo vetëm i mbledh, por u njeh pak a shumë dhe vlerat e funksionet. Gjen aty qeska me bishta qershish, që përdoren në problemet e veshkave, sherebela shumë efikase në traktin e frymëmarrjes, hithra shumë efektive kundër artriteve e problemeve te tjera reumatizmale. E pyeta nëse ke njohje me lulen e shtogut, dhe mu përgjigj se akoma nuk e kishte në koleksionin e saj të preferuar. Unë kisha provuar një lëng të mrekullueshëm të përftuar nga lulet e tij dhe i thashë që mund ta eksperimentonte. Jo vetëm që i pëlqeu ideja, por kërkoi të mbjellë dhe një rrënjë shtogu në pemtoren e saj. Ndoshta, ca vite më vonë e gjithë pemtorja mund të gjendet e rrethuar me drunjtë e shtogut, si një kurorë e bukur me lule të bardha.

Disa njerëz vizionarë dhe gjumin e bëjnë të pakët e të trazuar. Ditën punojnë dhe në momente të caktuara të natës, meditojnë çfarë i mungon biznesit që posedojnë dhe si mund të përmirësojnë ndonjë difekt. Vërtet u habita kur brenda dyqanit, pashë një pavjon të vogël, ku ishin ekspozuar veshje popullore të traditës dibrane. Shumica ishin të zonës së Kalasë së Dodës, meqë zonja në fjalë ishte mbesë, nga ky vend me tradita. Këmisha e fustane të qëndisura e të zbukuruara, çentro të punuara me dorë dhe me grep, veshje burrash dhe veshje grash. I thashë se të tilla veshje shumë të bukura i gjen dhe në ekstremin tjetër të Dibrës, në Gollobordë. Bile atje ka dhe punë të bëra me tezgjah, qylyma me zbukurime antike, çorape të mahnitshme me figura e si me fije ari. Ju zgjua kureshtja për të shkuar deri atje, bashkë me të shoqin, Fatosin, një shofer i talentuar, që ka trashëguar profesionin e babait të tij. Këtij këndi të ri, Dashuria mendon ti shtojë dhe elemente të tjerë.

Një djalë i ri nga fisi Gjura i Ushtelenxës, është mjeshtër i punimeve në qeramikë. Vazo, pjata, vorba e plot enë të tjera, të zbukuruara e të punuara me shumë kujdes e dashuri. Një pjesë të këtyre punimeve, do të jenë në dyqanin e saj.

Dashje pa dashje ky dyqan po shërben si pikë grumbullimi, si ekspozitë, si objekt turistik, si vend relaksi e kënaqësie, si vend ku evokohet e kaluara dhe antikja. Por përmasat e dyqanit, sado i madh që është, janë tepër të vogla për të përfshirë projektet që gëlojnë në kokën e zonjës së nderuar. Atë e kanë ndihmuar, me ndonjë ndihmë modeste CNVP-ja, AGRITRA Vizion, SNV, AZHBR-ja si dhe shoqata e fondacione të ndryshme. Por ajo duhet mbështetur më shumë, pasi dhe ajo po ndihmon mjaft dhe të tjerët. Duke tërhequr prodhime e punime të zonës e më gjerë, Dashurie Zerja po bëhet de fakto një kryetare e zonja e grave fermere dhe të atyre të traditës.

Rruga e Arbërit nr. 136

19 vjeçarja nga Dibra, studente e gjuhës angleze, përfaqësoi denjësisht Shqipërinë në konkursin e Unionit Anglishtfolës, organizuar në Mbretërinë e Bashkuar, nën kujdesin e vetë Mbretëreshës Elisabet

të rinj të talentuar

Lediana Kapxhiu, zëri i Shqipërisë në Londër

Nga **Samet ZAGRADI**



Ajo është vetëm 19 vjeç. Lindur dhe rritur në qytetin e vogël por të bukur të Peshkopisë. Rritur nga dy prindër të thjeshtë dhe mjaft punëtorë. E ëma mësuese e gjuhës angleze në një shkollë të qytetit, ndërsa i ati elektriçist. Lediana Kapxhiu studion në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Tiranë, dega Anglisht. Është pjesëmarrëse dhe praktikante në përkthim, gjë që e kanë ndihmuar mjaft dhe trajnimet dhe seminaret që ajo ndjek në aktivitetet shkollore dhe jashtë saj. Është pjesëmarrëse në shumë konkurse kombëtare por ky i fundit ishte më fatsjellësi për të. Gjithçka nisi nga një lajmërim i rastësishëm nga një pedagoge e fakultetit ku Ledi studion. Ishte një konkurs nga "Unioni Anglishtfolës" në Tiranë ku duhet të paraqitej një ese me temë thënien e Oscar Ëild " To define is to limit" përkthyer në shqip "Të përcaktosh do të thotë të limitosh". E bukura e këtij konkursi ishte çmimi. Ai person që do të fitonte këtë konkurs fitonte të drejtën e përfaqësimit të vendit në Mbretërinë e Bashkuar organizuar nga vetë mbretëresha Elisabet.

Pas aplikimit Lediana u zgjodh automatikisht finalistja e këtij evenimenti ku në finale ishin 15 të rinj nga e gjithë Shqipëria. Ky konkurs kishte në bazë ligjërimin publik, ku ata duhet të ligjëronin temën e esesë që ishte dhënë për 5 minuta të sinkronizuara.

"Ankthi dhe stresi po më ndiqte gjatë gjithë kohës dhe mendoja faktin që kisha arritur deri aty"- shprehet për gazetën tonë fituesja e këtij konkursi. Finalistët ishin me të vërtetë të përgatitur, vazhdon të tregojë emocionet që ajo ka përjetuar.

"Pas 15 ligjërimeve shumë të goditura, erdhi dhe momenti i finalizimit ku konsistonte të ishte edhe lajmërimi i emrave fitues. Shpërblimi më i madh që mund të merrja ishte leximi i vendit tim si fituese e vendit të parë. Nuk kishte ndjesi më të bukur dhe më hutuese se ajo pasi ky çmim do ndikonte pozitivisht në shumë gjëra në të ardhmen. Mbaj mend mjaft mirë lotët dhe përqafimin e gjyshes që më ndoqi në prezantimin tim duke më dhënë forcë dhe kurajë. Atë s'do ta harroj kurrë, sepse e bëra krenare dhe atë".

Pas 3 javësh Lediana nga Dibra, tani zyrtarisht përfaqësuesja e Shqipërisë në një eveniment ku merrnin pjesë shumë vende nga e gjithë bota. Pas shumë peripecive në mbledhjen e dokumentacioneve më në fund u bë nisja për në Mbretërinë e Bashkuar. Për Ledin siç na tregon ajo, udhëtimi për në Londër ishte i lodhshëm por me të vërtetë i bukur. Lodhja nuk ndihej kur mendonte faktin se përse po shkonte. Në konkurs duhej të paraqiteshe me 3 prezantime. I pari konsistonte me prezantimin e vendit nga vinin duke zgjedhur diçka të veçantë si karakteristikë; i dyti ishte interpretimi i esesë fituese në Tiranë dhe prezantimi i fundit ishte tema "Peace is not an absence of ëar" e përkthyer në shqip si "Paqja nuk është mungesë e luftës".

Momentin e arritjes në Londër konkurrentët shkuan në qendrën e Unionit Anglishtfolës ku çdo konkurrenti ju dha një itinerar se çfarë do të bënin çdo ditë. Në darkë u akomoduan në "President Hotel" ku konkurrentëve ju dha rasti që të njihen me njëri-tjetrin, ndërsa të nesërmen konkurrentët duhet të shkonin në teatrin e vjetër të Shekspirit, ku do trajnoheshin nga aktorë profesionistë për një interpretim të mirë skenik. Prezantimi i vendeve do bëhej në Dartmouth House, ku përfaqësuesja e Shqipërisë zgjodhi të prezantonte atë duke përdorur një qeleshe, byzylyk dhe një shall me motive shqiptare, duke e bërë më të veçantë prezantimin e vendit dhe duke krahasuar disa tradita me ditët e sotme dhe me vendet e tjera. Të gjithë ishin kuriozë të dinin më shumë për vendin tonë dhe kjo dukej nga pyetjet e shumta që u bënë pothuajse nga të gjithë të pranishmit në atë prezantim. Misioni i asaj dite përfundoi me shumë sukses veçanërisht për Ledianën përfaqësuesen tonë e cila arriti të përcillte tek të huajt një pjesë të vendit dhe traditave shqiptare. Në ditën e tretë nis me provat dhe fjalimin që mund të përgatiten për 15 minuta. Provat bëheshin me disa tema të caktuara për të parë nëse konkurrentët mund të arrinin t'ia dilnin. Pas lodhjes shkuam në "Apollo Victoria Theatre" në një muzikal më të vërtetë fantastikë ku të gjithë vizitorët mbetën me gojë hapur për bukurinë dhe gjërat e veçanta që kishte aty.

Dita e katërt, siç tregon Lediana ishte një ndër ditët më të lodhshme. Të gjithë ishim ngritur me idenë që do ta mbaronim atë ditë dhe do të ishim të gjithë të kënaqur. Së pari ishin prezantimet që na kishin bërë këtu fitues ato që do të referonim. Me shumë ndryshime arrita t'ia dal dhe kjo u duk dhe tek anëtarët e jurisë që mbetën të kënaqur. Nuk më bënë shumë pyetje dhe për mua ky ishte një mesazh pozitiv. Më pas duhet të përgatiteshim për fjalimin 3 minutësh. Në orën që na ndante për tek konkursi menduam të vizitonim "Buchkingham Palace" Ishte një pallat mbretëror me plotë kuptimin e fjalës, me roje dhe arkitekturë mahnitëse. Pas një ore morëm temën përkatëse për prezantimin. Shqipëria ishte e dyta në radhë. Tema për Shqipërinë ishte "Asnjë flokë bore në një ortek nuk është i përgjegjshëm (No snoëflake in an avalanche ever feels responsible). Për pesë minuta nuk kisha idenë se çfarë do të bëja pasi ishte me të vërtetë filozofike dhe nuk të jepte shumë mundësi për të krijuar. Dhe koha nuk premtonte shumë. Më në fund vendosa që ta lidh me jetën e njeriut. Doli një prezantim që me të vërtetë u pëlqye shumë nga të gjithë dhe një pjesë prej tyre u entuziazmua. Pas konkursit shkuam në Queen"s Ice për të pushuar dhe për të diskutuar me të gjithë konkurrentët nga e gjithë bota. Të nesërmen ishte finalja e madhe ku finalistë ishin vendet si: Kanadaja, Kina etj. Pas finales takuam Lordët e Mbretërisë së Bashkuar. Mbretëresha e Anglisë për arsye shëndetësore nuk mundi të na takonte. U miqësova me shumë njerëz nga vendet e tjera që akoma ruaj miqësi dhe flas me ta. Kjo ka qenë eksperienca me e mirë dhe më fantastike që më ka ndodhur ne jetën time - përfundon me entuziazëm Lediana Kapxhiu, vajza 19 vjeçare që çoi lart zërin e Dibrës dhe të Shqipërisë në institucionet më të larta të Londrës.

Për punën që Ledi ka bërë të gjithë ishin entuziastë. Pedagogët dhe drejtuesit e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja i bënë një pritje jo të zakonshme. Mediat dhe portalet e mëdha të vendit shkruajtën për Ledin. Nëna e saj, e nderuara mësuese Yllka Kapxhiu, tregoi momentet kur mori vesh që vajza e saj do përfaqësonte Shqipërinë në Mbretërinë e Bashkuar: "Të tillë njerëz duhen të përgëzohen dhe të vlerësohen për punën që bëjnë. Të rinjtë kanë potenciale të jashtëzakonshme të cilat duhet të shfrytëzohen. Vendi jonë ka shumë nevojë për punën e të rinjve si Lediana".

Keni ndonje shqetesim per te ndare me komunitetin?

SHKRUANI NË GAZETË!
BASHKËPUNO EDHE TI!

< rrugaearberit@gmail.com >

Bëj pajtimin tënd me PayPal

përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA
është vetëm në versionin PDF.

Ne nuk jemi gazetë e pavarur, ne jemi gazetë e lirë dhe pavarësia jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...

në fokus

“Atdheu përfaqëson vlerat me të cilat jam rritur, trashëgiminë kulturore të paraardhësve, të njerëzve që do..., përfaqëson vendin ku ndihem gjithmonë ‘në shtëpi’ edhe pse kaloj vetëm një muaj në vit atje”. Kështu shprehet Lavdrim Krashi, dibrani që për më shumë se 20 vite menaxhon aspekte të ndryshme të politikave të strehimit në kryeqytetin e Britanisë së Madhe.

LAVDRIM KRASHI - *dibrani që menaxhon politikat e strehimit në bashkinë e Londrës*

Nga **DRITA RINA**

“Atdheu përfaqëson vlerat me të cilat jam rritur, trashëgiminë kulturore të paraardhësve, të njerëzve që do..., përfaqëson vendin ku ndihem gjithmonë ‘në shtëpi’ edhe pse kaloj vetëm një muaj në vit atje”. Kështu shprehet Lavdrim Krashi, dibrani që për më shumë se 20 vite menaxhon aspekte të ndryshme të politikave të strehimit në kryeqytetin e Britanisë së Madhe.

Patriotizmi ka rrënjë të thella në mendjen dhe shpirtin e tij. Kjo edhe për faktin se ka lindur në Arras, pranë Kepit historik të Qytetit në grykën e bukur turistike të Setës, mbi kalanë natyrale të Gjergj Kastriotit. Po këtu ka hedhur edhe hapat e para në rrugën e dijes, duke kryer arsimin e detyrueshëm 8-vjeçar. Ruan kujtime të bukura fëminore përgjatë këtyre viteve. Në memorien e tij është ngulitur mësuesja e klasës së parë Zana Bajraktari (një intelektuale e spikatur nga Shkodra, e cila ka edukuar shumë breza në këtë zonë) si edhe mbarimi i klasës së 8-të dhe dëshira për të përfaqësuar veten e tij, familjen dhe zonën sa me denjësisht.

Prindërit e tij kanë patur një etje të madhe për dije dhe arsimim. Të dy ishin të përkushtuar që të gjithë fëmijët të mbaronin universitetin.

I ati, Mersim Krashi, ka qenë një nga emrat shumë të njohur të krahinës, madje edhe më gjerë në gjithë Dibrën. Ai ka spikatur që në moshë të re për zgjuarsinë natyrale dhe të kultivuar, dhe si drejtues në disa vepra zhvillimore, si aeroporti i Rinasit, rruga kombëtare Tiranë-Mirditë-Kurbnesh si dhe në zhvillimet me përgjegjësi gjatë viteve ‘60, ‘70 dhe ‘80. Ata që e kanë njohur nëpërmjet punës e vlerësojnë si një njeri korrekt, të përkushtuar ndaj njerëzve dhe me një intelekt natyror të jashtëzakonshëm.

Nëna e tij, Dylbere Krashi është nga Xhediket, (kështu ai është nip tek Xhediket në Zall Dardhë), një familje e penës, punës e pushkës ku spikasin kompozitori i famshëm, themeluesi i tangos shqiptare, Muharrem Xhediku, Dr. Emin Xhediku, Ing. Elmaz Xhediku etj.

Në familjen e Mersim Krashit me 7 motra dhe vëllezër, kur u diplomua vëllai i vogël i tij në 1995, kënaqësia e prindërve ishte krejt e dukshme, së bashku me krenarinë. Në këtë familje të ngushtë ka mjekë, inxhinierë, mësues, agronomë, oficerë, dhe natyrisht, pasi të gjithë kanë krijuar familjet e tyre, janë shtuar edhe profesione të tjera.

Udhëtimi i tij me Anxhelën, shoqen e jetës, filloi para 20 vitesh dhe familja sot është e kompletuar me fëmijët, Mersimin 18 vjeç dhe Elmën 11 vjeçe (jo rastësisht djalin e kanë pagëzuar me emrin e babait, në shenjë mirënjohje dhe siç e ka tradita). Së bashku si familje e vizitojnë Shqipërinë shpesh e me mall. Asnjëri prej prindërve të tij nuk jetojnë më, pasi i ati ndërroi jetë në fund të vitit 1995 në moshë shumë të re dhe nëna e tij tashmë ka pesë vite që nuk jeton më. Sa herë që Lavdrimi vjen në Shqipëri, vizitën e parë e bën te prindërit, duke u përkulur pranë vendit të tyre të përjetësisë.

Arsimin e mesëm e ka kryer pranë shkollës së mesme ushtarake “Skënderbej” në Tiranë, pra si të thuash është një gjysmë ushtarak. Me gjithë vështirësitë e jetës si nxënës larg familjes nga mosha 14-18 vjeçare, ai vazhdon akoma të ruajë kujtime të bukura pranë këtij institucioni arsimor mbi të gjitha, ku u mësuan ta duan njëri-tjetrin, të ndanin ato pak gjëra që kishin së bashku, të vlerësonin besnikërinë dhe miqësinë e sinqertë. Atje u brumosën me dashurinë për atdheun dhe kombin.

Një çerek shekulli më parë, kur u gjend mes atyre mijëra studentëve që aspironin për një Shqipëri si gjithë Europa, Lavdrimit as që i kishte shkuar ndërmend se do të bënte karrierë në vendin me demokraci dhe institucione demokratike të konsoliduara. Sidoqoftë do të ishin rezultatet e shkëlqyera në studimet pasuniversitare, master në Kiminë e Mbrojtjes së Ambientit, që do t’i hapnin perspektivën e angazhimit të drejtpërdrejtë në administratën vendore britanike.



Largimi për të vazhduar arsimimin në kryeqytet shënon edhe “largimin” nga vendlindja. Për të, kjo ka qenë një nga “ndarjet” më të vështira dhe sfida ishte e jashtëzakonshme për një adoleshent që vinte nga një zonë e thellë për të vazhduar jetën në metropolin e vendit.

Pasi mori formimin bazë pranë shkollës “Skënderbej”, vazhdon studimet në Fakultetin e Shkencave të Natyrës. Kjo pasi në atë kohë (vitet 80-të), dhjetë nxënësit me rezultatet më të larta kualifikoheshin në Universitetin Shtetëror për nevojat e ushtrisë. Në atë kohë dega më e pëlqyeshme ishte Inxhinieria Elektronike dhe ndonëse ishte me të gjitha notat 10-ta, shoku i tij i ngushtë kishte një përparësi ndaj tij pasi ishte kandidat për anëtar partie, ndaj kjo degë iu rezervua atij. Pavarësisht kësaj, Lavdrimi tregon se ai mbetet një nga miqtë e tij më të ngushtë edhe sot e kësaj dite.

Vitet studentore pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, ku studioi për Inxhinier Kimist, kanë qenë të mbushura me plot ngjarje që kanë ndryshuar rrjedhën e zhvillimeve në vendin tonë dhe më gjerë. Ai bën pjesë në atë brez studentësh që i kanë jetuar të dy sistemet, gjysma e parë në fund të viteve ‘80 dhe pjesa tjetër në fillim të viteve ‘90. Përjetimet plot dhimbje për kohën kur Shqipëria ishte e lodhur nga komunizmi dhe varfëria, fillojnë të përballen me dëshirën për të ndryshuar gjërat, ku protagonistë ishin studentët. Kjo pjesë vitale e shoqërisë, ku bënte pjesë edhe ai, i dha shpresën lëvizjes për ndryshime dhe atëherë kur e tashmja dukej e zymtë; rinia tregoi se e ardhmja ia bënte me sy të shkonte drejt saj me shpresë dhe konfidencë.

Ndonëse ka marrë pjesë në shumë ngjarje të asaj kohe, politikisht e gjeti veten në anën e Partisë së transformuar në Socialiste. Ai ka qenë pjesë e një grupi prej gjashtë studentësh (Pandeli Majko, Ilir Zela, Flamur Metollari, Arjan Kokoshi, Haki Morina dhe Lavdrim Krashi) që ideuan së bashku formimin e FRESSH - si formacioni më i madh rinor i kohës. Ky forum do t’i jepte frymëmarrje PS dhe jetës politike të vendit. Në këtë angazhim u pritën mirë nga drejtuesit dhe nga forumet e kohës.

Një çerek shekulli më parë, kur u gjend mes atyre mijëra studentëve që aspironin për një Shqipëri si gjithë Europa, Lavdrimit as që i kishte shkuar ndërmend se do të bënte karrierë në vendin me demokraci dhe institucione demokratike të konsoliduara. Sidoqoftë do të ishin rezultatet e shkëlqyera në studimet pasuniversitare, master në Kiminë e Mbrojtjes së Ambientit, që do t’i hapnin perspektivën e angazhimit të drejtpërdrejtë në administratën vendore britanike. Pas përfundimit të studimeve, rrethanat e sollën që të qëndronte në Angli. Ka rreth 20 vite që punon në Bashkinë e Londrës, ku ka menaxhuar aspekte të ndryshme të politikave të strehimit. Në proces, ka kryer disa kualifikime profesionale në fushën e planifikimit dhe strehimit si “Prince 2 Project Management”, “Politikat e Strehimit dhe Planifikimit dhe Kuadri i tyre Ligjor”, ndërkohë që është anëtar i Chartered Institute of Housing, Royal Institute of Purchase and Supply dhe organizata të tjera profesionale.



Me kryetarin e bashkisë së Londrës, Sadiq Khan

Politika vazhdon të mbetet një pasion. Angazhimi i tij në këtë fushë merr forma të ndryshme si anëtar i partisë Laburiste, kontributi i vazhdueshëm për zgjedhjet bashkiake, referendumi historik për marrëdhënien e re të Anglisë me BE, zgjedhjet parlamentare etj.

Por për të, aspekti profesional nuk ka qenë fokusi i tij i vetëm.

Angazhimi me komunitetin zë një vend të veçantë në aktivitetin e tij në Londër, sidomos gjatë viteve të vështira për shqiptarët e Kosovës 1998-99, deri në çlirimin e saj.

“Nuk ka kënaqësi më të madhe kur ndihmon me këshilla dhe zgjidhje praktike për çështje të ndryshme që ka komuniteti – shprehet ai. Unë kontribuoj në mënyrë vullnetare me Programin Shpresa, Chrysalis Family Futures, Shoqata Ardhmëria, Mother Teresa Albanian Union etj”. Asistenca konsiston kryesisht në ndryshimet ligjore për sa i takon shërbimeve publike si strehimi, shëndeti publik, e drejta për blerjen e banesave, projektet dhe programet e zhvillimit.

Qëllimi i këtyre aktiviteteve është të ndihmojë komunitetin për ingranimin në shoqëri dhe ruajtjen e traditës e kulturës shqiptare edhe në Angli. Integrimi kryhet duke ndihmuar njëri-tjetrin në zhvillimin e karrierës së tyre nëpërmjet rrjeteve profesionale, zhvillimin e kurseve të ndryshme, duke ofruar ndihmë për studentet dhe të sapodiplomuarit etj. Nga ana tjetër komuniteti është shumë i ndjeshëm ndaj dëshirës për të qenë pranë njëri-tjetrit në festa kombëtare kur bashkohen shpesh për të festuar e kujtuar se gjërat që i bashkojnë janë më shumë se ato që i ndajnë dhe që jashtë shtetit janë madje edhe më pranë njëri-tjetrit.

Por politika për të vazhdon të mbetet një pasion. Ai i kushton një pjesë të kohës së tij zhvillimeve politike të vendit ku jeton dhe punon aktualisht. Angazhimi i tij në këtë fushë merr forma të ndryshme si anëtar i partisë Laburiste, kontributi i vazhdueshëm për zgjedhjet bashkiake, referendumi historik për marrëdhënien e re të Anglisë me BE, zgjedhjet parlamentare etj.

Intervistë me Stine (Nesti Duka)

Të mbajmë njëri-tjetrin, sepse kjo na bën të paarritshëm në të gjitha fushat

Për rininë Dibrane kam këtë mesazh: Kudo që ato të jenë. Duhet me patjetër të shfrytëzoni pafund inteligjencën sepse ne shquhemi si një vatër e madhe zgjuarsie. Ta mbajmë njëri-tjetrin sepse kjo na bën të paarritshëm në të gjitha fushat që ne veprojmë. Të besojnë në vetvete, të punojnë fort dhe të investojnë në talentin e tyre.



Nga **Samet Zagradi**

- Nesti (Stine) ju jeni një ndër të rinjtë dibranë më të suksesshëm prej vitesh? A mund të na thuash si nisi karriera juaj si këngëtar?

- Ju falënderoj për intervistën dhe për punën që bëni. Kontaktet e mia me muzikën kanë qenë që herët në fëmijërinë time. Mbaj mend që studioja në shkollën "Ifran Hajrullaj" në lagjen Dobrovë. Për herë të parë me muzikën u prezantova aty me violinë, studiova aty për 6 vite dhe më pas u transferova në "Lagjen e Re" ku kisha shtëpinë në të cilën jam rritur. Muzika dhe kërcimi kanë qenë pasion për mua ku që në fëmijëri kam fituar çmime. Debutimi im i parë ka qenë ne vitin e largët 1997 me grupin e quajtur ETB 57. Pastaj në Top Fest 1 ku dola fitues i këtij festivali. Kam fituar shumë çmime të tjera dhe kam dhe një studio timen.

- Përmende pak më parë Dobrovën, Lagjen e Re. Sa i lidhur është Stine me Dibrën?

- Me Dibrën jam jashtëzakonisht i lidhur. Edhe tani vij pothuajse 1 apo 2 herë në muaj rregullisht. Kam shumë kujtime të jashtëzakonshme nga ai vend. Një nga pjesët më të bukura të jetës time është atje, fëmijëria. Ne e mbajmë veten si brezi më i bukur rinor për qytetin e Peshkopisë. Ishim shumë aktiv dhe bënim shumë për njëri tjetrin. Siç funksionon një vëllazëri, më shumë komunikim dhe përkrahje. Sot kam shumë miq të mirë në Peshkopi, miq fëmijërie dhe jo vetëm.

- Rinia Dibrane të adhuron për muzikën që ti bën. Ti çfarë mesazhi ke për ta?

- Po. Për rininë Dibrane kam këtë mesazh: Kudo që ato të jenë. Duhet me patjetër të shfrytëzoni pafund inteligjencën sepse ne shquhemi si një vatër e madhe zgjuarsie. Ta mbajmë njëri-tjetrin sepse kjo na bën të paarritshëm në të gjitha fushat që ne veprojmë. Të besojnë në vetvete, të punojnë fort dhe të investojnë në talentin e tyre.

> - Dibra ka nxjerrë me të vërtetë shumë artistë dhe jo vetëm që po korrin sukses kudo që ato janë. Gjithsecili prej tyre ka qenë në një farë mënyre frymëzim për mua që nga brezi i kaluar e deri tani.

- Kush është Nesti në jetën e përditshme.?

- Po t'i referohem ditëve të mia aktuale me këtë pyetje them që jam në një fazë shumë kreative muzikor. Kështu që një pjesë mjaft të rëndësishme të kohës e kaloj në studio që e kam në shtëpi. Por pa anashkaluar dhe detyrimet sociale të jetës. Vizita, kohë për familjen, miq dhe takime pune kryesisht vetëm me njerëz me energji pozitive.

- Ku e gjen frymëzimin stine për këngët e tij kaq fantastike?

- Pa diskutim që në jetën e përditshme. Në jetën time plot ngjyra dhe aventura . Çdo ditë më ndodh diçka dhe normalisht unë kam mënyrën time të të shprehurit. Unë i shpreh emocionet me këngë apo me kompozim. Mendoj që kështu lind diçka e bukur.

- Kë artist Dibran do veçoje si krenari të Dibrës?

- Dibra ka nxjerrë me të vërtetë shumë artistë dhe jo vetëm që po korrin sukses kudo që ato janë. Gjithsecili prej tyre ka qenë në një farë mënyre frymëzim për mua që nga brezi i kaluar e deri tani. Duke filluar nga artistë të mëdhenj si Liri Rasha e Arif Vladi, më pas me radhë Behar Mera etj. Pastaj duke vazhduar me një brez tjetër si Noizy, GBMC, Tan Jashari, Komedia Dibrane (instagram), Fatma Methasani në televizioni InTv etj. Ndjesë për të gjithë emrat që nuk më kujtohen për momentin por të gjithë këto artistë dibranë kanë depërtuar në formimin tim si artist. I përshëndes.

- Në qoftë se do bëjë diçka për Dibrën cila do ishte ajo?

- Mendoj që Rruga e Arbërit është dhurata më e madhe për të gjithë Dibrën. Të vijmë më shpejt më Dibër. Mendoj që mund të bëj dhe një kompleks turistik për ski në "Malin e Korabit" pasi do e ndihmonte shumë turizmin atje.

- Për fund, na thuaj dy fjalë për lexuesit tanë.

- Për fund do t'u thosha: *Për tmëjra e ngzime u takofshim. Jeni ma të mëjrët. Me respekt voci i Dibrës Nest Duka. Kalofshi mëjr...*

printime dixhitale

DUKE FILLUAR NGA 1 KOPJE E VETME

shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme
libra | broshura | revista | fletëpalosje
katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.

për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603

sport

EKSKLUZIVE / Intervistë me kampionin e Botës në Kick&Tai Box, Ismail Keta: Unë jam thjeshtë një misionar i ëndrrave mia me profesionin, pasionin për të gjithë jetën "Sportist".

Jeta dhe karriera ime janë frymëzuar nga Herkuli



Në foto: Ismaili me dy djemtë e tij, Arianitin dhe Gjergjin (Fotot marrë nga FB personal)

Në qoftë se nuk do të isha marrë me sport, do të doja të bëhesha biznesmen ose politikan. Por jo politikan "Made in Albania". Politikan që për interesin e vendit është i palodhur, aspak tolerant ndaj padrejtësive dhe i durueshëm për të mirën e vendit tim. Në qoftë se do isha biznesmen i madh që punon për familjen, njerëzit e varfër që nuk kanë mundësi pune.

Bisedoi: **Samet Zagradi**

- Për një publik që di pak gjëra për ju, a mund të na flasësh pak më shumë rreth vetes tuaj?

- Në radhë të parë faleminderit që promovoni vlerat e paçmuara të Dibrës dhe dibranëve. Unë nuk di çfarë të them. Interneti tregon pothuajse gjithçka rreth meje dhe çdokujt tjetër. Unë jam thjeshtë një misionar i ëndrrave mia me profesionin, pasionin për të gjithë jetën "Sportist".

- Ju jeni kampion në kategorinë tuaj. Na trego si nisi karriera dhe cilët ishin ato vështirësi që keni hasur në fillimet tuaja?

- Është një histori me të vërtetë shumë e gjatë me vështirësi dhe me plot dhimbje. Unë jam i lumtur që kam kaluar atë të shkuar të vështirë sepse më ka bërë më të fortë dhe më rezistent ndaj çdo gjëje. Këto vështirësi më kanë mësuar 1000 mijë herë më mirë se t'i lexoja në roman apo të kështillonte një baba apo gjysh i mirë. Mund të them se karriera ime filloi bazuar në filmat e "Herkulit" më pas të "Rocky Balboa". Unë gjithmonë kam ëndërruar që të bëhem dikushi. Sot jam 40 vjeç dhe më duket vetja si 100... Pa harruar se vetëm zoti është perfekt.

- Në qoftë se nuk do të ishit boksier, çfarë profesioni do të doni të kishit?

- Biznesmen ose politikan. Por jo politikan "Made in Albania". Politikan që për interesin e vendit është i palodhur, aspak tolerant ndaj padrejtësive dhe i durueshëm për të mirën e vendit tim. Në qoftë se do isha biznesmen i madh që punon për familjen, njerëzit e varfër që nuk kanë mundësi pune. Por jo dembelët që për kisha dhe xhami nuk vlerësojnë historinë e Shqipërisë dhe të qenurit Shqiptar.

- Në karrierën tuaj keni marrë shumë trofe dhe jeni shpallur kampion. Na tregoni pak rreth këtyre ngjarjeve të rëndësishme të jetës tuaj?

- Trofetë janë një gjë që sot i marr ose i mora unë, sot ose dje e lash unë sportin dhe i merr tjetër kush. Rruga e vështirë që kam bërë nga fshati Kocaj-Bulqizë në vite ku sporti mendohej si "budallallëk" për shumë njerëz që nuk kishin të hanë dhe kur sporti nuk bëhej nga profesionistë. Sidomos sporti i boksit që për 50 vite ka qenë sport i ndaluar nga regjimi komunist në Shqipëri. Shumë njerëz me potencial ma kujtojnë dhe më shprehin shumë respekt për këtë dhe këtu në Gjermani. Nuk e kisha menduar që mund të arrija majën, por e dija të sigurt që do të ngjitesha në majë pasi nuk u lodha kurrë duke u stërvitur dhe duke qenë i disiplinuar. Gjithmonë kam qenë i gatshëm që edhe të vdisja para se të humb në ring.

Kudo që të isha kryetar bashkie, pik së pari do bëja atë që çdo prind dëshiron dhe ka vlerë për të ardhmen e kombit. "Do të edukoja të rinjtë me sport dhe disiplinë që sjell vetëm fryte të shëndosha për të ardhmen". Po të isha kryetar i bashkisë së Bulqizës çdo gram krom që del nga ajo Bulqizë e shfrytëzuar dhe e keqtrajtuar prej vitesh me radhë, nuk do të kalonte qafën e Buallit pa paguar taksën e qytetit, bashkisë dhe bulqizakëve që u takon dhe Zoti i madh ua ka dhuruar



Stërvitje në Bulqizë me Gjetanin.

- Kush është Ismail Keta larg jashtë profesionit të tij?

- Jashtë ringut kam qenë dhe jam shumë i zënë, pasi ne shqiptarët jemi të edukuar me kulturën e mikpritjes, të ndjejmë përgjegjësi për fjalën e dhënë, të ndihmojmë familjen, të afërmit dhe miqtë. Mendoj që jam munduar të respektoj dhe ndihmoj çdo njeri që ka pa pasur nevojë për ndihmë. Kultura e jetës në Gjermani ku unë provova që të jetoj përbëhet nga puna dhe disiplina. Tani jam baba i dy fëmijëve, bashkëshort, xhaxha dhe dajë. Si dhe jam mësues i sportit që kërkon të jesh përveç shembull dhe mik ose prind.

- Je promotor i të rinjve në Gjermani dhe jo vetëm. Për të rinjtë e Dibrës çfarë do të këshilloje?

- Do e them me pak fjalë. Të rinjtë dibranë kane potenciale të pakrahasueshme, por duhet të dinë që asgjë nuk vjen duke qëndruar në vend. Më mirë të derdhin djersë kot, se sa të rrinë kot. Djersa dhe mundi juaj të dashur të rinj asnjëherë nuk shkon dëm. Tentoni tek e pamundura.

- Zoti Keta, kë do falënderoni për suksesin tuaj?

- Zotin për shëndetin dhe mendjen e ndarë. Prindërit e mi që më rritën me vështirësi dhe më edukuan të jem mirënjohës dhe të vlerësoj punën time, të qenurit Dibran dhe Shqiptarë. Falënderoj Shqipërinë për historinë e saj të dhimbshme por gjithnjë krenare, si dhe Gjermaninë që dhe pse me shumë mundim më dha një shans për të arritur këtu ku jam sot.

The pak më parë që mund të ishe bërë edhe politikan. Në qoftë se do ishe kryetar i bashkisë Dibër apo Bulqizë. Çfarë dot të ndryshoje dhe ku do ishte vëmendja juaj?

- Kudo që të isha kryetar bashkie, pik së pari do bëja atë që çdo prind dëshiron dhe ka vlerë për të ardhmen e kombit. "Do të edukoja të rinjtë me sport dhe disiplinë që sjell vetëm fryte të shëndosha për të ardhmen". Dhe së dyti në Bulqizë çdo grami krom që del nga ajo Bulqizë e shfrytëzuar dhe e keqtrajtuar prej vitesh me radhë nuk do të kalonte qafën e Buallit pa paguar taksën e qytetit, bashkisë dhe bulqizakëve që u takon dhe Zoti i madh ua ka dhuruar.




Me Gjetanin pas fitores...

Rruga e Arbërit nr. 136
botime

Enver Kaloshi e ka përshkruar me shumë respekt e me shumë dashuri tërë jetën dhe veprën e profesor Hasan Çipurit. Po me kaq respekt e dashuri kanë shkruar edhe të tjerët – dr. Vangjel Kasapi, Xhafer Martini, Shaqir Skarra, Fluturak Gërmenji, Hamit Vata etj. Të bukura janë kujtimet e vetë Hasanit për shkollën "Skënderbej", për ishullin e Sazanit, për punën.

PROF. DR. HASAN ÇIPURI – TERMINOLOGU I SHQUAR USHTARAK

Nga **PROF. DR. HAJRI SHEHU**



Gjeniu është titulli i librit shkencor-popullarizues të Enver Kaloshit. Gjeniu është profesor doktor Hasan Çipuri. Titulli është i spikatur. Hasan Çipuri ka shkruar e ka botuar 32 560 faqe shtypi. Ka udhëhequr 24 vepra kolektive (fjalorë terminologjikë ushtarakë shqip-anglisht-rusisht etj.). 32 fjalorë shqip-gjuhë e huaj mbajnë emrin e Hasan Çipurit si autor, si bashkautor e si drejtues shkencor (kryeredaktor). Ka hartuar 160 zëra enciklopedikë. Ka shkruar 350 artikuj shkencorë e shkencorë-popullarizues. Ka përkthyer e ka botuar 14 libra historikë e ushtarakë. Ka drejtuar rreth 400 bashkëpunëtorë të jashtëm të Sektorit shkencor të Akademisë Ushtarake – tani, Akademia e Mbrojtjes. Ka hartuar e ka botuar 6 tekste mësimore universitare. Ka redaktuar 34 libra të fushave të ndryshme. Ka qenë pedagog në Universitet e titullar i serbokroatishtes. Flet e shkruan në pesë gjuhë të huaja. Ky është profesor Hasan Çipuri. Ky është shkencëtari me uniformë, - siç thotë kolegu i tij i nderuar, dr. Vangjel Kasapi, ish-shef i Sektorit shkencor të Akademisë Ushtarake. Ky është Hasani, anëtari i Institutit Biografik Amerikan (American Biographical Institute); "Personalitet ndërkombëtar i vitit", 2001 (Kembrixh, 2002), një ndër "2000 intelektualët e shquar të shekullit XXI" (Kembrixh, Angli, 2001); një ndër "Europianët e shquar të shek. XXI", (Kembrixh, 2003); "Drejtor i përgjithshëm nderi për Europën" i Qendrës Biografike Ndërkombëtare të Kembrixhit, Angli. Ky është gjeniu.

Enver Kaloshi e ka përshkruar me shumë respekt e me shumë dashuri tërë jetën dhe veprën e profesor Hasan Çipurit. Po me kaq respekt e dashuri kanë shkruar edhe të tjerët – dr. Vangjel Kasapi, Xhafer Martini, Shaqir Skarra, Fluturak Gërmenji, Hamit Vata etj. Të bukura janë kujtimet e vetë Hasanit për shkollën "Skënderbej", për ishullin e Sazanit, për punën.

54 vjet punë – një jetë njeriu. Në 54 vjet punë, profesor Hasan Çipuri ka pasur 12 detyra të rëndësishme funksionale. Këtu është shkencëtari drejtues. Është Hasani, i ditur dhe i dashur me të gjithë. I veshur bukur e i mbajtur bukur. Me zërin e tij karakteristik e me fjalën e tij aq prekatare. Tërë këtë punë të profesor Hasanit dhe të Akademisë e kam parë nga afër.

Nuk dua t'i dal përpara kureshtjes së lexuesit. Lexuesi ka librin – një botim mjaft i mirë nga Shtëpia Botuese M dhe B. Por dua të cilësoj punën e profesorit në fushën e fjalorëve. Nga 12 detyrat funksionale të profesor Hasanit, njëra ka qenë: Shef i Sektorit (më pas – Departament) të Terminologjisë dhe të Enciklopedisë Ushtarake në Akademinë Ushtarake, tani, Akademia e Mbrojtjes (1980-2002). Në vitet '80, me vendim nga Ministria e Mbrojtjes, më kalojnë në zbor nga reparti i Zall-Herrit në Akademinë Ushtarake në Sektorin e fjalorëve terminologjikë. Kërkesa dhe këmbëngulja qe e profesor Hasanit. Për mua ishte nder se doja të isha ndihmëtar i komandant Hasanit e bashkatar me profesor Hasanin në aq punë hartuese e redaktuese sa për 12 ditë të zborit. Nderi tjetër qe se më hoqi nga stërvitja e vështirë në terren e më pruri në zyrë, në tryezë, me libra e me fjalorë.

Kati ku punohej për fjalorët terminologjikë ushtarakë, zyrat, mjedisi ishin një Institut i dytë Gjuhësie. Bashkëpunëtorët e jashtëm – ish-komandantë e specialistë të shquar ushtarakë - punonin krejt të përqendruar mbi skeda e libra. Punonjësit e brendshëm – kolegë të Hasanit, po kështu. Më ka mbetur në mendje puna zelltare e të gjithëve. Dhe e bibliotekares. Vargëzimi (konvejeri) ishte i përkryer. Atje punohej, vërtet me ritëm e temp ushtarak. Kryeorganizatori ishte profesor Hasani. Profesorin e pyesnin. Profesori jepte përgjigje. Për gjithçka. Këtë "humbje kohe", profesor Hasani do ta kompensonte me punë pas orarit. Deri kur? Deri në orën 9-10 të natës. Jam një ndër dëshmitarët e asaj kohe e të atyre orëve. Për këtë punë vigane të Sektorit të Terminologjisë dhe të Enciklopedisë të Akademisë Ushtarake flasin Fjalorët e botuar dhe të gjithë librat e tjerë.


Profesor Hasani ka shkruar historinë e terminologjisë ushtarake të shqipes. Terminologjia është tërësia e termave të një fushe të shkencës, të teknikës etj. Termi është fjalë a tog fjalësh për një koncept shkencor, teknik, ushtarak etj. Historia fillon me Rilindjen, vijon me Pavarësinë, me Ushtrinë Mbretërore, periudhën 1939-1944, periudhën pas Çlirimit e deri në kohët e sotme. Kjo terminologji ka qenë dhe është pjesë e rëndësishme e ushtrisë shqiptare, sepse siç dihet, ajo ka të bëjë me komunikimin ushtarak – aq i rëndësishëm në të gjitha kohët e në të gjitha momentet. Ajo ka qenë dhe është pjesë e rëndësishme e gjuhës sonë të përbashkët, jo vetëm se është ndër terminologjitë më të mëdha të shqipes (ushtria ka shumë shkenca, teknika, teknologji, armë, aparatura, pajisje etj. – çdo repart ushtarak ka armën e vet e teknikën e vet – e rrjedhimisht, edhe terminologjinë e vet), por edhe sepse përdorimi i dendur e thuajse i përditshëm i mjaft termave ka bërë që ata ta kalojnë kufirin e tyre (si term) e të përdoren edhe si leksik i përgjithshëm (le të themi, *shënjestër, qitje, urë e varur* etj.) në mjediset tona ushtarake, në stërvitjet ushtarake - më herët, edhe në fshat, në shkolla e në universitete. Gjuha është dukuri shoqërore, që do të thotë se ajo ekziston, ruhet e zhvillohet veçse në shoqëri. Por është edhe dukuri historike, sepse zhvillohet e pasurohet sipas zhvillimit të kësaj a të asaj bashkësie që e flet atë. Këtë ruajtje dhe këtë zhvillim na e përshfaq brenda parametrave të saj edhe monografia e profesor Hasanit për historinë e terminologjisë ushtarake të shqipes. Vetëm një shembull: Në Shtabin Madhor të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare u ngrit për herë të parë në historinë e Forcave tona të Armatosura një komision i terminologjisë ushtarake dhe *togë, epror, këmbëz* (e shkrepjes), *siguresë, gatitu!, qetësohu!, eja në radhë!* etj. janë krijuar nga ai komision. Shumë terma të tjerë si këta janë qëmtuar, vjelë e pasqyruar në fjalorët terminologjikë ushtarakë e më së pari, në disertacionin e profesor Hasanit për doktoraturë.

Profesor Hasani është themelues i terminologjisë së sotme ushtarake të shqipes, mbështetur fort mbi baza kombëtare e mbi parime krejt shkencore. Vetë profesor Hasani thotë: Terminologjia jonë ushtarake, tashmë është formuar e funksionin si sistem. Janë diferencuar, qartësuar e saktësuar konceptet në përputhje me zhvillimin e mendimit dhe të praktikës ushtarake shqiptare. (Për konceptet në terminologji do të themi diçka më poshtë). Këtë thënie e vërtetësojnë një varg studimesh teorike në fushën e terminologjisë së shqipes e veçmas, të terminologjive ushtarake. Në terminologjinë ushtarake, ai që ka spikatur është profesor Hasani. Krahas studimeve teorike në fushën e terminologjisë në vitet '80 të shekullit të kaluar, në Akademinë Ushtarake (sot, Akademia e Mbrojtjes) filloi puna e organizuar shkencore për përpunimin sistemor, shqipërimin dhe kodifikimin tërësor të terminologjive tekniko-ushtarake. Ideatori dhe kryeorganizatori i kësaj pune kaq të gjerë ishte profesor Hasani. Për këtë qëllim u vol letërsia ushtarake (rregullore, tekste mësimore, udhëzues, revista e gazeta ushtarake e joushtarake etj.) nga Rilindja deri në ditët tona dhe u krijua një kartotekë terminologjike shkencore me rreth 200 000 skeda. Kartoteka është si puna e miellit të situr hollë, pa të cilin nuk mund të bësh gatesa të mira, ose si puna e arkivit, pa të cilin nuk mund të bësh histori. E gjithë kjo punë është bërë nën drejtimin dhe mbikëqyrjen shkencore të profesor Hasanit. U krijuan komisione specialistësh ushtarakë e gjuhëtarësh. Edhe komisionet kishin në krye profesor Hasanin. Aty diskutohej shkencërisht dhe vendosej për termin e caktuar. Unë kam pasur nderin dhe kënaqësinë të jem edhe bashkëpunëtor i jashtëm i Sektorit të fjalorëve të Akademisë Ushtarake në ato vite. Gëlonin zyrat nga diskutimet. Shkruhej, punohej, skedohej, kërkohej barasvlerësi në gjuhë të huaj (në parantezë: fjalorët ishin shumëgjuhësh, disagjuhësh ose dygjuhësh dhe gjuhë e parë ishte shqipja, sepse fjalori ishte për shqipen e për terminologjinë ushtarake shqipe). Ajo punë më ka lënë mbresa e dua ta përsëris thënien time: Sektori ishte si një Institut i dytë Gjuhësie. Falë lëndës së vjelë e organizimit të përsosur, u hartuan 25 fjalorë, me rreth 67 000 njësi terminologjike. Besojmë që pjesa më e madhe e tyre janë në dorë të përdoruesve. Shifrat nuk kanë nevojë për koment. Gjithë kësaj pune shkencore, kaq vëllimore, i ka paraprirë kryeredaktori i fjalorëve, profesor Hasani dhe studimi monografik, gjithashtu i

Terminologjia ushtarake pasqyron zhvillimet që kanë ndodhur a që ndodhin në fushën e mbrojtjes në kushte të caktuara ekonomiko-shoqërore e politike. Ajo pasqyron shkallën e modernizimit të Forcave të Armatosura. Prandaj sot, puna me terminologjinë ushtarake, - vëren profesor Hasani, - nuk duhet konsideruar e përfunduar. Edhe pse ajo po merr karakter të qëndrueshëm, ka raste luhatjeje e mosnjësimi. Por, siç dihet, luhatjet në fushën ushtarake janë me pasoja. Prandaj, me të drejtë profesor Hasani sugjeron të ndiqet terminologjia ushtarake e NATO-s, pjesë e së cilës jemi edhe ne, për ta përfshirë atë në fjalorët terminologjikë ushtarakë përkatës. Sepse standardizimi i koncepteve (brenda NATO-s) sjell edhe standardizimin e termave ushtarakë e të terminologjive ushtarake

profesor Hasanit: "Terminologjia ushtarake e shqipes" (botuar më pas / 1993 si libër më vete). Ja disa nga ata fjalorë: Fjalor i termave gjitharmësh, (1989) (hartuar nga një grup i gjerë ushtarakësh, specialistësh e gjuhëtarësh, nën drejtimin e profesor Hasanit. Aty bëhet përpunimi tërësor e sistemor i terminologjisë tekniko-ushtarake. Ai përfshin 11 000 terma); Fjalor i termave të topografisë ushtarake (shqip-anglisht-rusisht), 1985; Fjalor i termave të artilerisë (shqip-anglisht-rusisht), 1987; Fjalor i termave të zbulimit (shqip-anglisht-rusisht), 1989; Fjalor i termave të shërbimeve të prapavijës (shqip-anglisht-rusisht), 1987; Fjalor i termave të armatimit dhe të municioneve (shqip-anglisht-rusisht), 1989; Fjalor i termave të mbrojtjes kundërajrore (shqip-anglisht-rusisht), 1990; Fjalor i termave të armës së xhenios (shqip-anglisht-rusisht), 1990; Fjalor i termave të armës së tankeve (shqip-anglisht-rusisht), 1990; Fjalor i termave ushtarakë të NATO-s, 1997; Fjalor i shkurtesave dhe i akronimeve të NATO-s (anglisht-frëngjisht- italisht-gjermanisht-shqip), 1999; Fjalor i termave të ndërlidhjes (shqip-anglisht-rusisht), 2000; Fjalor i detarisë (anglisht-shqip), 2000. Një punë, vërtet vigane. Kryeredaktor - profesor Hasan Çipuri. Profesor Hasan Çipuri ka hartuar vetmorisht edhe dy fjalorë të mëdhenj terminologjikë ushtarakë (me 20 000 terma), botuar më 1990 dhe 1993 – "Fjalor ushtarak serbokroatisht-shqip" dhe "Fjalor ushtarak italisht-shqip" dhe një Fjalor të përgjithshëm shqip-serbisht (me rreth 45 000 fjalë dhe me mbi 25 000 shprehje e frazeologjizma", 2008.

E tërë kjo punë gjigante mjaftonte që profesor Hasani të siguronte një emër shumë të nderuar në shkencën shqiptare: si gjuhëtar, si terminolog, si terminograf, si leksikolog e si leksikograf i pazëvendësueshëm. Por profesori nuk mund të mjaftohej vetëm me kaq. Edhe tani ai është në punë e mbi libra. Recensionet për fjalorë të të tjerëve e oponencat për mbrojtje doktoratash, përkthimet e puna mësimore universitare si titullar i lëndës "Gjuha serbokroate" në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Tiranë i kanë kërkuar kohë, por, gjithsesi, kanë qenë veprimtari shumë e dashur për profesor Hasanin dhe shumë e vlerësuar nga të tjerët. Por as me kaq nuk është mjaftuar profesor Hasani. Ai ka shkruar dhe botuar disa artikuj për terminologë ushtarakë, por edhe artikuj për strategë ushtarakë - Skënderbeun, Aleksandrin e Madh, Napoleon Bonapartin, Xhingis Khanin, Zhukovin etj. Këta janë qershia mbi tortë. Ushtria ka shumë armë, shërbime e specialitete; rrjedhimisht, ka edhe shumë terminologji e shumë terma. Ka terma të teknikës e të strategjisë, të organizimit e të drejtimit të trupave, të teknikës së armatimit, të shërbimeve e të strukturës së forcave të armatosura. Ushtria ka edhe terma politiko-ushtarakë e historiko-ushtarakë. E, edhe terma të tjerë. Dhe nuk është e lehtë të veçosh e të pranosh aksh term kur ai shënon realie të disa armëve, shërbimeve e specialiteteve. Pra, nuk është e lehtë të përcaktosh vëllimin e konceptit dhe vëllimin e termit sipas tiparit të ngushtë tematik. Nuk është e lehtë të dallosh e të veçosh as leksikun e përgjithshëm ushtarak nga leksiku ushtarak special. Ka edhe shumë koncepte që lidhen tërthorazi me ushtrinë. Kjo do të thotë, më në fund që nuk ka qenë e lehtë të bëhej inventari i termave teknikë, shkencorë etj. dhe brenda kësaj kornize të ruhej simetria e fjalorëve. Por në gjithë atë punë është bërë një sintezë e përgjithshme e terminologjive ushtarake të shqipes dhe janë harmonizuar fusha e nënfusha të saj të veçanta dhe me kënaqësi kemi vërejtur se zgjedhja dhe përzgjedhja e termave është bërë siç duhet dhe është ruajtur simetria në fjalorë. Siç do ta sqarojmë pak më tej, terminologët, në vend që të nisen nga fjalët për të hetuar kuptimet, nisen nga përkufizimet e koncepteve për të gjetur fjalët (= termat), që i emërtojnë ato. Por shkenca e teknika ecin e zhvillohen shpejt. Atëherë, një fjalor terminologjik i kësaj a i asaj dege të shkencës a të teknikës duhet të jetë bashkëkohor edhe në koncepte, edhe në fjalë (= terma); ndryshe, konsiderohet i vjetruar e i pavlefshëm. Fjalorët terminologjikë, me kryeredaktor profesor Hasan Çipurin kanë qenë gjithnjë të kohës. Edhe konceptet, edhe termat kanë qenë të besueshëm, sepse kanë ardhur nga burime të shkruara bashkëkohore - rregullore, tekste mësimore, broshura, artikuj etj. (shih, p.sh., *ndërlidhje videotelefonike, tank urahedhës, bombë neutronike* etj.). Kësisoj, fjalorët kanë qenë për çdo dije ushtarake, tekniko-ushtarake e tekniko-shkencore, madje, edhe për njëfarë profesionalizimi të punës së ushtarakut. Në parantezë: Nëse do të dish, p.sh., për aerodromet dhe llojet e aeroplanëve, shko te Fjalori i termave të mbrojtjes kundërajrore.



Fjalorët ishin kryesisht shqip-gjuhë të huaja. Kësisoj, ata ishin fjalorë ndërkombëtarë. Gjuha shqipe përballej me gjuhë të mëdha të lëvruara. Dhe në këtë përballje ajo ka qenë e suksesshme. Por ne duam të dalim diku tjetër. Lexuesit mund t'i shkojë në mendje që në këtë lloj pune kemi të bëjmë me përkthim. Si veprim gjuhësor, përkthimi është shumë i ndërlikuar, sepse transformimet gjuhësore nuk janë paralele të përkryera si ato të matematikës a të alfabetit Mors. Por, në terminologji barasvlerësi (ekuivalenti) në gjuhë të huaj (ose anasjelltas, në gjuhën shqipe, kur fjalori është gjuhë e huaj – shqip) nuk përkthehet. Edhe përkthimi – nëse dikush do ta quante përkthim – nuk është transferim fjale, por transferim koncepti. Atëherë, *barasvlerësi në gjuhë të huaj nuk përkthehet, por kërkohet e gjendet*. Është si puna e njësive frazeologjike ose e fjalëve të urta a proverbave - ato nuk mund të përkthehen. Barasvlerësi terminologjik është "përkthim" koncepti e pastaj gjetje e termit (fjalës) – një punë fort e vështirë. Atëherë, dija për degën e shkencës a të teknikës, dija për temën, dija për gjuhën amtare e dija për gjuhën e huaj na japin një fjalor terminologjik të kënaqshëm. Falë formimit të tij ushtarak, shkencor e intelektual dhe njohjes së shkëlqyer të shumë gjuhëve të huaja (anglisht, rusisht, italisht, serbisht, kroatisht etj.), profesor Hasani e zgjidhte nyjën gordiane, kur aksh komision terminologjik ngecte diku.

Në gjuhën shqipe, siç dihet, ka gjithnjë proces krijues dhe risimtar në punë të fjalëkrijimit e të fjalëformimit, sidomos në gjuhën e shkencës dhe të teknikës. Pra, në terminologji mund të krijohen fjalë të reja. Por me kusht që: a) ta japin të saktë konceptin a nocionin; b) të jenë krijuar sipas rregullave e gjedheve fjalëformuese të shqipes. Autoritetin për të krijuar e pranuar një term të ri e kanë më së pari terminologu e specialisti. Por nuk mjafton krijimi i termit të ri. Duhet një strategji që të sigurojë vlerësimin dhe pranimin e aksh risie dhe në përgjithësi, zhvillimin e gjuhës speciale të aksh dege të shkencës, teknikës etj. Kjo strategji është ndërtuar edhe me fjalorë të tillë terminologjikë ushtarakë. Me kënaqësi kemi vërejtur që në këtë strategji, përpjekja e profesor Hasanit dhe e komisioneve terminologjike, të drejtuara prej tij, për ta pasuruar gjuhën shqipe me fjalë të reja e për ta ruajtur të pastër gjuhën shqipe, duke shmangur fjalë të huaja të panevojshme, ka qenë e vijueshme dhe e suksesshme. Shih, p.sh., *rrugështruese, urdhërveprim, gjurmëtí, ujëveçues, pikëlidhje, dritëmatës, vetërregullues* etj. Në to mund të shihet fare qartë modeli i shqipes, çka i bën më të pranueshme (siç ka, p.sh., *shenjëtari,* ka edhe *helmueshmëri*, siç ka *i kapshëm,* ka edhe *i mbartshëm* etj.). *Çndotje* dhe *çndotës* janë formime shqipe të profesor Hasanit. Janë gjurmuar dhe gjetur terma edhe me formim popullor (tipi *kushtrim, shpatinë dyjare, aeroplan* **bukël** etj.), duke synuar kështu demokratizimin e mëtejshëm të terminologjive shqipe ushtarake e të vetë ligjërimit ushtarak.

Është synuar me të drejtë fjala shqipe e formimi shqip në terminologjitë shqipe të ushtrisë, por pa rënë në nacionalizëm gjuhësor. Nacionalizmi gjuhësor – pastrim i gjuhës nga çdo huazim është, natyrisht i papranueshëm. Gjuhët marrin e japin. Gjuhët marrin për të plotësuar ndonjë qelizë të zbrazët në strukturën e tyre. Gjuhët marrin fjalë ndërkombëtare (ndërkombëtarizma). Gjuhët nuk marrin fjalë të huaja të panevojshme, ose fjalë a formime me prejardhje të huaj, gjithashtu, të panevojshme, që bëhen si rriqra në trupin e saj të shëndoshë. Prandaj profesor Hasan Çipuri nuk i do fjalët *bocman, difensivë, dislokim, eksploziv, paramilitar, oksidim, plasdarm* etj. Prandaj ai kërkon *shenjëtar* e jo *snajper, pamor* e jo *vizual, dyluftim* e jo *duel, denduri* e jo *frekuencë, nxënësí* e jo *kapacitet, njehsim* e jo *kalkulim, qëndresë* e jo *rezistencë, nismë* e jo *iniciativë*. Prandaj profesor Hasani ka shkruar rreth 20 artikuj për shqipërimin e shumë termave ushtarakë.

Të gjithë fjalorët terminologjikë synojnë të jenë *normativë,* sepse e kanë për detyrë të japin termin që duhet përdorur. Kjo do të thotë që ata e ndihmojnë përdoruesin të zgjedhë atë term a togfjalësh terminologjik që e ka pranuar (ose që mund ta pranojë) gjuha shqipe standarde. Fjalorët e autorit, bashkautorit dhe kryeredaktorit Hasan Çipuri janë normativë në të gjitha elementet e në të gjithë treguesit. Të tillë janë edhe barasvlerësit e gjetur në gjuhë të huaj. Në këtë mënyrë, përdoruesit i jepet mundësia edhe të lexojë, edhe të përkthejë literaturë të huaj.

Terminologjia ushtarake pasqyron zhvillimet që kanë ndodhur a që ndodhin në fushën e mbrojtjes në kushte të caktuara ekonomiko-shoqërore e politike. Ajo pasqyron shkallën e modernizimit të Forcave të Armatosura. Prandaj sot, puna me terminologjinë ushtarake, - vëren profesor Hasani, - nuk duhet konsideruar e përfunduar. Edhe pse ajo po merr karakter të qëndrueshëm, ka raste luhatjeje e mosnjësimi. Por, siç dihet, luhatjet në fushën ushtarake janë me pasoja. Prandaj, me të drejtë profesor Hasani sugjeron të ndiqet terminologjia ushtarake e NATO-s, pjesë e së cilës jemi edhe ne, për ta përfshirë atë në fjalorët terminologjikë ushtarakë përkatës. Sepse standardizimi i koncepteve (brenda NATO-s) sjell edhe standardizimin e termave ushtarakë e të terminologjive ushtarake.

Rruga e Arbërit nr. 136

botime

Bashkë me urimin për librin e radhës do të thonim se libri ka vlera të shumëfishta. Është vlera njohëse për këta njerëz ose figura të historisë, artit të Dibrës e më tej, që nuk i gjen në librat shkollorë.

Përtej kronikës së disa jetëve

Duke lexuar librin "Në panteonin e vlerave" të autorit Halil Rama

Nga **NAMIK SELMANI**

Pa asnjë mëdyshje, libri i Halil Ramës "Në panteonin e vlerave" është befasi në botimet e viteve të fundit. Media vizive dhe ajo e shkruar na ka "bombarduar" me kronikat e krimeve dhe me ato rozë. Dhe të vënë në rolin e një edukatori të brezave, të paktën në familje, pa folur në mjedisin social, e kemi të vështirë që t'u themi më të rinjve se ka edhe vlera të mira ky vend, kjo krahinë, që duhen njohur, që duhen ndjekur, pa folur edhe për Panteonin e vlerave që ka dhe duhet të ketë një komb, pavarësisht se sa popull ka ai në sipërfaqen që mbulon flamuri i tij.

Nuk ka zgjedhur poezinë Halil Rama në një Oqeanopoezi, ku të gjithë vargëzojnë ditën e natën, para telenovelave e para tribunave, e pak, shumë pak poezi të mbeten në kujtesë, në mish, nën lëkurë; pale t'i vësh nën jastëk apo t'ua tregosh fëmijëve, miqve, nxënësve, në një kohë të caktuar, edhe pse bëhen sa e sa konkurse, shtrohen dreka për të, hidhen sa e sa lekë, euro, dollarë në tavolinat e botuesve të shtëpive botuese kudo e kurdo. Dhe barra ose dhe nderi për të parë një libër të ri të Halil Ramës ishte fort e madhe.

Një libër racional, emocional, dokumentar, arkivor që të bën ta marrësh diku një laps nga ato që shumë herë i kemi harruar përballë dehjes që na kanë bërë tastierat e kompjuterave dhe të celularëve dhe të shkruash diçka, mbase edhe shumë. Të shkruash për t'u bërë më tej një Urë modeste e dobishme dhe e bukur mes kësaj vepre dhe publikut që e ndjek me shumë respekt, padurim dhe kureshtje çdo vepër që ai bën. Të bën që para se t'ia japësh mesazhin atyre që e lexojnë çdo ditë Halil Ramën të marrësh shumë për vete, bash si ata çirakët që kanë një kod të përbotshëm të marrjes së zanatit nga ustallarët.

E kjo ndodh jo vetëm në të gjithë botën se zanati (qoftë edhe ai i shkronjëshkrimit shqip) nuk merret me leksione në një auditor të ftohtë ku mungon shpesh edhe vemendja e atyre që dëgjojnë, qoftë dhe pasioni i atyre që flasin (më falni, që marrin rrogën!!!!)

Në qendër të librit është PANTEONI.

2.

Studiuesi Ermir Gjinishi ka shruar para pak ditësh një shkrim që sadopak na vjen në ndihmë të kësaj parashtrese për librin e Halil Ramës: "Po të kthehemi në parahistori, para se rapsodë e homerikë t'u këndonin hyjnive dhe heronjve mitologjikë, përpara se të shkruhej gjuha greke, rronte një popull i njohur me emrin Pellazg. Atyre u atribuon Herodoti historinë, e cila parapriu qytetërimin grek. Ndërtimet me gurë të pagdhendur përballë Panteonit në Athinë akoma edhe sot mbahen për pellazgjike."

Përtej gjurmëve të gjuhës na vijnë vlerat që krijojmë në shumë ditë të jetës sonë. Patrioti Halil Rama nuk shkon në kombe të tjerë, po është diku pranë nesh për këtë mesazh. Para atyre njerëzve që vijnë dhe ikin nga gjiri ynë, jo thjesht anonimë, por pa ua kuptuar thelbin e Panteonizmit brenda vetes, që do të na "shëronte" nga sëmundjet e qaramanërisë dhe të mburravecërisë kolektive që na ka kapluar jetën dhe të nesërmen.

Përherë bashkëpunimin me krijues dibranë e kam parë me një droje, me gëzim, me krenarinë e fshehur që e kam mbajtur thellë - thellë vetes të mos më skuqë nga droja e një fjale, më shumë jo në vendin e duhur si duhet para tyre.

Përherë bashkëpunimin me miq të letrave, e kam parë si një provim të vështirë dhe shumë të bukur, së pari para vetes. Vjen një çast kur ti numëron shkrime, aktivitete, njerëz që ke takuar, libra që ke bërë, antologji ku ke marrë pjesë në vendin tënd e në vende të tjera në botë e sërisht bashkëpunimin me dibranët, qoftë ata të Nëntë Maleve, qoftë ata të Grykës së Radikës, të Bulqizës të Lurës, të Maqellarës dhe të Çidhnës, qoftë të Grykës, qoftë dhe ata të Shehrit si i thonë qytetit, e kam parë me atë shprehje që dikush e tha në diskutimin e librave të një dibrani punëtor dhe të dashuruar pas fjalës së bukur, Demir Rusi. E çka tha ai do thoni ju? Para se t'ua them më duhet që të hap një bllok të vogël, një fletë ku e kam shkruar se ishte fort e mençur për ta dëgjuar e po kaq e mençur dhe e dobishme për ta bërë një realitet në shkronjëzimin tënd, ku kam të shkrirë të gjitha krahinat e Shqipërisë, të Kosovës, të Çamërisë: "Kur hyra në shkollën dibrane, isha nxënës dhe dola prapë nxënës."

A nuk po e bën këtë gjë fort mirë dhe me dashuri edhe Halil Rama në këtë libër, kur ai na rreshton vlera të shumta të qytetarisë dibrane, të përkushtimit të brezave të saj. Të fushave të ndryshme të jetës.


3.

Libri është bazuar në një treshe magjike. Mistike. Janë disa kapituj që të ngrejnë pak nga pak në një Panteon, që ti e sheh jo me një zili egërshane, por me një respekt të madh për ata që ai të vë përpara me të gjithë sfidat e suprizat e tyre. Dhe të mendosh se ai në një kohë të caktuar ka bërë të skicimin e veprave të plota qindrafaqëshe për secilin prej tyre. Në libër ka shumë reçensa. E kush nuk do ta dëshironte një reçensë të tij që është kaq e saktë. Kështu ai shkruan për "BERISHËT E MUHURRIT, SI RAST UNIKAL NË HISTORINË SKËNDERBEGIANE". Shkruan për sagën e Jakovajve, për ish-presidentin Omer Nishani, për Toponiminë e Çidhnës, për veprën e Hajri Mandrit, etj.

Shkruan për antishqiptarizmin dhe aspiratat sllave ndaj trojeve shqiptare. Kufiri kohor që ai ka marrë është të paktën 600 vjet më parë. Të dërgon te fjala poetike e urtakut Teodor Laço. Faleminderit se e kishim harruar pak Mjeshtrin Laço, Halil Rama! Na dërgon në sinorët poetikë të Naim Plakut që janë më të bukura se rudinat e Korabit. Na flet për Musa Riçkun, Ahmet Prençin, Naim Berishën, Sakip Camin, Nikollë Lokën, Shaqir Skarrën, Hysen Dervishin, Isuf Imerajn...

Na sjell një shpirt të madh, gati parajsor të Demir Rusit me dy librat e tij, të cilët pata fatin që t'i shoh, t'i redaktoj dhe të jem pjesë e festës së përurimit të tyre bashkë me Halilin.

Pjesa e portretizimit të një gazetari natyrisht është testi i saktë i profesionalizmit të tij. Këtë ai e jep në mjaft personazhe të spikatur, të njohur e të panjohur shumë për publikun e gjërë dibran jodibran. Është gjë e bukur se



optika e tyre përfshin personalitete të moshave e profesioneve të ndryashme, si: Sulejman Dibra, Bujar Pata, Edmond Isaku, Osman Miha, Jonuz Muça, Lahim Kola, që të mbeten në mendje me detajet që ai ka dhënë për jetën dhe veprën e tyre.

Pjesa më profesionale e kohës që jetojmë për një gazetar është ajo që ndodh edhe në historinë botërore. Bëhet fjalë për dossierët. Bie në sy një figure-legjendë, me të cilën mund të mburret sot çdo vend në Ballkan e në Evropë si gjeneral Rrahman Parllaku për të cilin, sjell pasionin për librin, si risi në jetën e tij. "*Librat do të ktheheshin në të vetmin ngushëllim për të gjatë 16 viteve e 3 muajve burg. Gjeneral Rrahman Parllaku do të kalonte 11 muaj në hetuesi bashkë me të tjerë "puçistë të ushtrisë", si Beqir Balluku, Petrit Dume e Hito Çako. Më tej qelia. Pikërisht aty gjenerali do të mbahej në këmbë përmes leximeve. Gjatë viteve të dënimit, Parllaku ka mbajtur një fletore shënimesh për të 96 librat që ka lexuar në burg. Letërsi botërore dhe shqiptare, mbi të cilët mbante shënime të shkurtra". Edhe pse sot vlerësimet e tij mund të duken pak skematike e të ndikuara edhe nga metoda e kritikës së kohës, ato janë një lëndë interesante për një studim mbi letërsinë e lexuar në burgjet e diktaturës. Përmes këtij DOSSIER-i Halil Rama sjell jo vetëm përmbajtjen e ditarit të librave, mbajtur në qeli, por edhe copëra kujtimesh nga ajo periudhë tmerri, cilët ishin hetuesit e oficerët, ata "të vijës së partisë" dhe ata njerëzorët, që thyenin rregullat me një gjest sado të vogël humanizmi. Si iu vu leximit dhe ku i siguronte librat?!!!*

Nën këtë optikë, janë pëfshirë në "Pantronin e vlerave" edhe bushtalinjtë e Shkodrës (Familja e Shefqet bej Bushatit që shkriu gjithë pasurinë për LANÇl), dëshmori Ahmet Fetah Cami, familja e njohur pogradecare Guxholli, Adem Islam Hoxha i Çidhnës, hero i rezistencës ndaj monarkofashistëve grekë si dhe Sulë Lushaj, një emër I ri në Muzeun e ish të Përndjekurve Politikë, që janë portrete mjaft të spikatur.

Për të dhënë sa më mirë këto, ai ka shfrytëzuar edhe intervistën me disa prej tyre.

Bashkë me urimin për librin e radhës do të thonim se libri ka vlera të shumëfishta. Është vlera njohëse për këta njerëz ose figura të historisë, artit të Dibrës e më tej, që nuk i gjen në librat shkollorë.

Është një libër që duhet të jetë në duart e gazetarëve më të rinj për të parë një përvojë mjaft të vyer profesionale të këtij gazetari mjaft profesionist.

Është një vlerë për historinë e Dibrës e atë kombëtare në tërësi, që mund të ushqente mjaft muze të saj, atë të luftës, të arsimit, të teatrit, të ushtrisë, të shkencës, etj.

Është një model i bukur gjuhësor, para të cilit mësuesët e gjuhës të shihnin modelin e mirë të shkrimit të gjuhës amtare.


Dhe këto nuk janë pak që edhe vetë libri, ashtu si personazhet e tij, të vihet në Panteonin e kulturës së shkruar shqiptare të viteve të fundit.


Tiranë, gusht 2017.


recensë


Tri dimensionet e veprës krijuese të Hajri Mandrit

- Poeti, dramaturgu dhe studjuesi i shembëlltyrës në folklor dhe letërsi, në proces të mbrojtjes së Titullit Profesor i associuar.
- Dr.Hajri Mandri është pedagog në "ALBANIAN UNIVERSITY", Tiranë, ku kryesisht jep lëndët: pedagogji dhe shkrim akademik.
- Në botimet e fundit ka kontribute të çmuara në pedagogjinë speciale, ku më evident ky kontribut shfaqet te libri i tij shkencor "Tiflopedagogjia".









Nga **HALIL RAMA**

Para tre dekadash, në konkursin kombëtar të teatrove të Njësive të Ushtrisë, si metodist i punës kulturore në ish – Shtëpinë e Ushtarakëve të Divizionit të Bulqizës, për t'iu përshtatur tematikës, zgjodha për të konkuruar me dramën "Bregdrinasit". Autori, Hajri Mandri, ishte i njohur për kohën, pasi kishte botuar edhe drama të tjera. Madje, drama e tij "E fejuara", e inskenuar nga trupa amatore e Pallatit Kulturës Bulqizë, pati një numër rekord shikuesish.

Për interpetimin e arrirë artistik dhe veçanërisht për faktin se drama "Bregdrinasit" kishte si subjekt historinë e "gjeneralit me shajak", Elez Isuf Ndreu, trupa e Shtëpisë së Kulturës të Divizionit të Bulqizës zuri vendin e parë në rang kombëtar.

E solla në vëmendje të lexuesit këtë fakt për të evidentuar një talent të "fshehur" të Dr.Hajri Mandrit, atë të dramaturgut. E dëshmon këtë talent qoftë edhe vetëm drama "Bregdrinasit", me paraqitjen impozante dhe burrërore të Elez Isufit, që rrezatonte ngjashmëri me heronjtë antikë. Ngritja në art e aktivitetit të tij atdhetar, është një vlerë e shtuar për dramaturgun Mandri. Nëpërmjet dialogimit të personazheve, heroit kryesor Elez Isufi dhe bashkëkohësve të tij, Sufë Xhelili, Osman Paci etj, vjen jehona e asaj kohe të largët kur kryengritësit dibranë mbrojtën me stoicizëm trojet e tyre kundër pushtuesit serb. Fjala artistike në dramën e Hajri Mandrit e sjell "gjeneralin e veshur me shajak" në të njëjtin nivel të atdhetarisë së gdhendur me gërma të arta në historinë tonë kombëtare. Mandri ka meritën e ngritjes në art të këtij biri besnik të atdheut, luftëtar i shquar për çlirimin dhe bashkimin e trojeve shqiptare. Kësisoj, dramaturgu H.Mandri, që para tri dekadash, e shihte këtë përzgjedhje si një mundësi e mirë që drama e tij të mund të ndikonte në edukimin atdhetar të shoqërisë shqiptare, ndërkohë që krijoi dhe botoi në Revistën "Teatër" edhe dramat "Mjeku i ri", "Në rrjedhën e jetës" dhe "Joana".

MODEL I RI VJERSHËRIMI DHE...

Hajri Mandri, fillimet e veta letrare i ka në poezi. Që kur ishte gjimanzist në Peshkopi dhe më vonë pas mbarimit të studimeve të larta, si mësues i letërsisë në shkollat e Bulqizës (dhe si Drejtor i Pallatit të Kulturës të qytetit minator), ai do të ishte fitues i disa konkurseve letrare të Degës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Dibrës. Por gjithsesi, poezia e tij do të bëhej e njohur për lexuesin pas viteve '90 kur ai do të mund të botonte vëllimet poetike "Prag mijëvjeçari" e "Zjarret e ditëveres". Në të dyja vëllimet dallohet poezia liriko-filozofike. Këto veçori të poezisë së tij i ndeshim qoftë dhe vetëm tek vjershërimi i porosisë së babait: "M'u zgjuan ca fjalë të kyçura në zemër/ M'i tha babai që nuk është më sot/ M'i tha e iku pa m'i ngopur sytë/ Duke më lënë një detë me mall të ngrohtë...."

Në këto dy vëllime H.Mandri krijon një model të ri vjershërimi në problematikë dhe në mjeshtërinë letrare, gërsheton natyrshëm vlerat tradicionale të poezisë me mënyra të reja të shprehjes poetike.

Në përgjithësi në poezinë e tij mbizotëron natyra lirike, si te "Kroi i Verës" : "Mos ma prishni Kroin e Verës/ Kroi i Verës pikon mjaltë/ Tek ai krua, ajo hije/ Mrizon ëndërra prej fëmije/ Vijnë kujtimet më mbajnë gjallë,/ Kroi – leitmotiv i rrallë/ Mos ma prishni Kroin e Verës/ Musht e mjaltë në buzë e kam.....".

Lirika është mbizotëruese edhe në disa poezi të tjera të Mandrit, por më evidente ajo është tek ajo me titullin "Lirike": "I rashë hënës me një grusht/ Hëna shkau dhe ra n'humnerë/ Atë natë ishte gusht/ Binte shi dhe frynte erë.../Desha, që veç unë e ti/ Ta sundojmë tërë errësirën/ Qënia jote qe magji,/ Luminishonte natyrën".

Ndërkohë konstatojmë se lirika në poezinë e këtij poeti shfaqet si vazhduese e vlerave më të mira të poezisë lirike shqipe, si psh tek poezia e titulluar: "Ti më pret..." : "Mos më ndal sonte në rrugë/ Eshtë e shtunë, ajo më pret/ Vijëzon në ballë një rrudhë/ Dhe nga sytë, loti i shket.../Nuk ka forcë që më ndal sonte/ Ti ditëlindjen ke në fshat/ Po t'mos vijë ai merak nëne,/ Të shqetëson, s'të lë rehat!".

Dhe duke e vështruar në tërësi krijimtarinë poetike të H.Mandrit mund të konkludojmë se ajo është mbartëse e tipareve moderne që shfaqen në sistemin letrar shqiptar, ndërkohë që thjeshtësia e komunikimit, mesazhet universale dhe shprehja e hapur e ndjeshmërisë janë shtyllat e forta ku mbështetet poezia e tij.

... SHEMBËLLTYRA NË FOLKLOR DHE NË LETËRSI

Në krijimtarinë e tij, Hajri Mandri është mbështeur thuajse tërësisht në traditën folklorike shqiptare. Librin "Shembëlltyra në folklor dhe letërsi" e ka shkruar fillimisht si tezë për shkallën "Master", me titull pune "Shembëlltyra në tregimet alegorike dibrane". Por kësaj teze iu përkushtua për vite të tëra deri sa arriti të marrë titullin Doktor i Shkencave në Studime Letrare.

Siç është shprehur udhëheqësi i kësaj teme, Prof.Dr.Shaban Sinani: "Studimi i Hajri Mandrit, për qëllimin që u hartua, mund të mjaftohej edhe vetëm me një paraqitje panoramike-anatomike të formave të ligjërimit me shembëlltyra në tregimet alegorike dibrane, në të folurit me rrotulla të Kosovës, në kallëzimet popullore të viseve të tjera veriore të Shqipërisë, që përbëjnë dukuri folklorike me përhapje tejet të gjerë deri në ditët e sotme". Por, duke e rilexuar tashmë si një monografi që u drejtohet studiuesve, lexuesve me interesa në fushë të letërsisë, folklorit, etnografisë, ligjërimeve gjuhësore, jo thjesht për ta paraqitur me dinjitet para një komisioni specialistësh, vlerat e këtij libri mund të çmohen në një kontekst më të gjerë.

Analiza gjuhësore e Studimit "Shembëlltyra në folklor dhe letërsi" hedh dritë jo vetën në pasqyrimin dhe dokumentimin e vlerave foklorike të Dibrës dhe krejt Verilindjes, por edhe për çështjet që lidhen me fushat e onomastikës, krijimtarinë popullore folklorike, dialektologjike etj.

Ky studim paraqet frymëzim shpirtëror jo vetëm për studentët e sotëm të Folkorit shqiptar, por edhe për gjuhën shqipe dhe popullin shqiptar në përgjithësi, sepse aty pasqyrohet historia, mendësia popullore, doket, ritet, besimet etj.

Përveç synimit për të qenë një ndihmesë në studimin e tipologjisë dhe karakteristikave të veçanta të mjeteve kohezive në gjuhën shqipe, punimi është motivuar dhe mbështetur edhe nga një qëllim tejgjuhësor, për të vënë në qendër veprën e mbledhësve të folklorit, si përfaqësues të prirjes realiste kombëtare në letërsinë shqiptare, që bosht të krijimtarisë së vet pati vlerat dhe vyrtytet njerëzore të njëmendëta dhe të përhershme, që shqiptarin e djeshëm dhe të sotëm, pa se i lidh vazhdimësia e traditës, e urtësisë, e virtytit moral por edhe tragjiciteti, ky shoqërues i përhershëm i ekzistencës së tij, i cili ka përcaktuar edhe kalitjen e shpirtit të tij të qëndresës.

Qoftë edhe më këtë botim shkencor mund të arrijmë në përfundimin se Dr.Hajri Mandri është tashmë nga ata personalitete me kontribut të rëndësishëm që u ofron studentëve njohuri parësore për një dukuri të pastudiuar, vetë bartësve të fundmë të ligjërimit me shembëlltyra një mënyrë të interpretuari të stilit të tyre të të folurit, specialistëve të letërsisë e të folklorit një varg problemesh të nevojshme për të gjykuar drejt për gjuhën, folklorin, letërsinë dhe marrëdhëniet midis tyre dhe mbi teoritë e evolucionit të zhanreve dhe të figuracionit; studiuesve të një niveli më të lartë formimi tema të hapura që presin njerëz të zellshëm dhe të formuar për t'u shpënë më tej.

Dr.Hajri Mandri është pedagog në "ALBANIAN UNIVERSITY", Tiranë, ku kryesisht jep lëndët: pedagogji dhe shkrim akademik.

Në botimet e fundit ka kontribute të çmuara në pedagogjinë speciale, ku më evident ky kontribut shfaqet te libri i tij shkencor "Tiflopedagogjia".

Është në proces të mbrojtjes së Titullit Profesor i associuar.

Dëshironi të **BOTONI PAK KOPJE LIBRI**, por nuk mundeni sepse shtypshkronjat ju kërkojnë të paguani për një tirazh të madh...
Tani nuk është nevoja të prisni...
JU OFROJMË BOTIME NGA 1 KOPJE E VETME!
Njëlloj si në shtypshkronjë... Çmime të favorshme dhe shpejtësi!
Telefono: **068 65 08 441** ose shkruaj email: **mbbotime@gmail.com**

kulturë

Melita Shehu, e papërsëritshmja artiste e madhe



Nga **ARSIM KOLARI**

Të krijosh art nga vetvetja, nuk është e lehtë, e sidomos dekada më parë, kur kjo ka qenë histori në vete, veçanërisht për zonën e Dibrës. I tillë qe fati ynë, dikur na e përcaktonin të tjerët!...Por, nga fatkeqësitë, artistët popullorë krijuan mrekullitë. Ndër artistet e para dibrane, kemi këngëtaren legjendare, Melita Shehu talentin e së cilës e krijoi vetë natyra, për ta hetuar këtë mësuesit e saj: Kiço Kalemi (mësuesi i matematikës dhe fizarmonist i dalluar), dhe Mynyr Shehu (mësuesi i muzikës), që tëdy udhëheqës të grupit të shkollës, ku Melita kreu filloren. Melita, veç që ishte këngëtare me zë të pastër, në shkollën ku mësonte "Demir Gashi" të qytetit të Peshkopisë, aktivizohej edhe si aktore, recituese dhe prezantuese. Ishin disa shkathtësi që e bënin atë të vlerësuar në skenë. Bashkë me dy shoqet e saj Sadete Miftarin dhe Afërdita Gracenin, u përzgjodhën si aktiviste nëpër shfaqje artistike e teatrale në shkollë, gjë me të cilën ranë në sy të drejtuesve të qendrës kulturore të Peshkopisë, të cilët i bënë pjesë të Estradës tashmë profesioniste të qytetit.

Melita Shehu u lind në vitin 1943 në qytetin e Peshkopisë. Familja e saj përbëhej nga babai Vehap, nëna Mevlude, motrat Muzejen, Lule dhe Liljana, e dy vëllezërit Reufi dhe Gëzimi. Gjendja ekonomike e kësaj familjeje të nderuar, u vështirësua edhe më shumë kur motrat u martuan e i ati e kishte të pamundur të punojë, veç që merrte një pension fare të vogël.Melita, tashmë si fëmija më i madh në shtëpi, u detyrua të "përveshë krahët" vetëqysh si adoleshente. Në këtë periudhë kohore rallë e tek ishte dëgjuar vajzë tëdel në skenë, por kjo gjë nuk e pengoi familjen e Melitës, e cila jo që nuk e ndaloi, por e përkrahu dhe e inkurajoi që ajo të jetë shembëlltyrë për shoqërinë. Karrierën artistike e nisi qysh në shkollën fillore, për t'iu bashkuar grupit të Estradës së Peshkopisë në moshën 15 vjeçare për të kënduar nëpë zonat më të thella të Dibrës: fshatrat Shupenzë, Gjuricë, Gollobordë, Fushë Alie, Maqellarë, Kastriot, Sllovë, Ostren, Tuçek, Trebishtë, etj., por edhe nëpër ndërmarrje apo institucione të rrethit. Ishin vitet e fundit te vitit 1950 dhe imagjinohet se si bëhej udhëtimi: hypur nëpër kuaj, e vende – vende edhe në këmbë, gjë e cila përbën histori me vete të mbushur me vuajtje të mëdha. Si 15 vjeçare filloi të punojë edukatore kopshti, për të krijuar që atëherë te bashkëvendasit imazhin e një vajze të kompletuar me dije. Pas një viti, u punësua në Estradën e qytetit, e cila në maj të vitit 1959 u bë profesioniste, meqenëse artistët që e përbënin, tashmë ishin të njohur për publikun e gjërë. Si fillimi këngëtarë qenë: Melita Shehu e Skëndër Cala, pak më vonë edhe Hazis Ndreu, përgjegjës muzike Tonin Rrota, instrumentistë: Xhemal Lushi me çifteli, Lahim Kola në fizarmonikë, e në xhez vetë Melita. Bashkë me Estradën, performuan para publikut të Tiranës, Shkodrës, Durrësit, Elbasanit, Sarandës, Vlorës, Fierit, Lushnjës, Beratit, Kukësit, Tropojës, etj. Siecila dalje skenike e Melitës, u bë sukses i padiskutueshëm, e repertori i saj u pasurua me këngë që edhe sot këndohen si atëherë. Janë këngët "Jepma mollën", "Ma ke gishtin për unazë" me tekst të Tef Krroqit dhe muzikë të Tonin Rrotës, pastaj varg vijnë këngët "Moj e mira", "Çom nishanin djalo", "Shkoi djali tërmale", "Kënga e kurbetit", pastaj "Seç e mora rrugën", Vet më ke thënë se un' të du", "Furfullon thëllaza", "Bonëm Zot, bilbil n'kajsi" etj. Mori pjesë në shumëturne artistikë jashtë vendit.Nëshkurt të vitit 1964, bashkë me Ansamblin e Këngëve dhe Valleve, udhëtoi për në Egjipt, ku qëndruan një javë në Kajro e një javë në Aleksandri. Në turne merrnin pjesë 50 anëtarë të ansamblit, mes tyre artistët e mëdhenj Meliha Doda, Naile Hoxha, Luçie Miloti, Avni Mula, Fitnete Rexha, Ibrahim Tukiçi, Qemal Kërtusha, etj. Çdo këngëtar kishte për të interpretuar dy këngë, e Melita përzgjodhi këngën "Ma ke gishtin për unazë", duet me Qemal Kërtushën, kurse kënga tjetër qe një potpuri dibrane. Pjesmarrësit e koncerteve ishin nga gjithë Ballkani, por edhe nga Japonia. Vlerësuesit qenë intelektualët më në nivel të kohës, të cilët Ansamblin e shtetit shqiptar e vlerësuan me çmime e vende nderi.Në vitin 1970 bashkë me Ansamblin "Dibra" vazhduan turneun dyjavor në Dibër të Madhe, Strugë, Ohër, Tetovë... Me këtë ansambël bashkëpunoi prej vitit 1958, e deri në vitin 1971. Që nga ky vit u shpërngul në qytetin e Durrësit, ku u njoh dhe u martua me aktorin e teatrit "Aleksandër Moisiu" Agim Liçon. Në vitin 1975 në Tiranë organizohet "Festivali i këngës popullore" ku Melita me këngën "Zani n'bjeshkë", me tekst e muzikë të kompozitorit Vangjel Petushi, fiton vendin e parë.Me këngë të Avni Mulës "Natë feste" fiton vendin e dytë në Festivalin e dytë të muzikës së lehtë, pastaj në Festivalin e tretë me këngë të Tasim Oshafit "Urim për ditëlindjen" zë vendin e tretë. Karrierën e vazhdoi në Estradën e Durrësit, ku gjeti artistë cilësorë, si: Ajshe Stari, Lume Dashi, Vera Urumi, Nikolin e Meropi Xhoja, etj. Këta intelektualë e pritën ngrohtë artisten dibrane, meqenëse ajo tashmë kishte krijuar emrin meritor artistik."Unë, ti dhe kitara" titullohej kënga e punuar nga Skënder Myshketa, që pati shumë sukses me këtë grup, ku Melita edhe këndonte edhe i binte kitarës.Gjatë prezantimit të kësaj kënge, publiku ngazëlleu disa minuta e kërkonte qëpër së dyti Melita t'i rikthehet skenës. Kjo i ndodhte shpeshë Melitës.

Sukseset për të dukeshin se nuk do kishin fund edhe disa dekada me radhë, por ndodhi ajo që s'pritej! Melita veç se këndonte, ajo filloi të jepte shfaqje teatrale në teatrin "Aleksandër Moisiu", ku ekipi i vlerësimeve gjatë çdo shfaqjeje, ruante një nga tre vendet e nderit për të.Në vitin 1981 gjatë një shfaqjeje, Melita sëmuret, e bronshiti e detyroi të shkëputej një periudhë nga skena.Shumëkush kishte mësuar se çka i ishte kurdisur pabesisht nga pushteti artistes dibrane, por asnjëri nuk kishte kurajon t'ia rrëfente paraprakisht, deri kur ndodhi vërtetë persekutimi i saj.Teksa u kthye sërish në punë, Melita mësoi se ishte mbledhur organizata e partisë së teatrit dhe kishte vendosur që disa artistë të kalonin në sektorin e prodhimit, vendim të cilin e justifikuan se klasa punëtore duhej "ndihmuar". Lista e të persekutuarve përbëhej nga emri i Melitës dhe dy aktorë: Vasilika Ndini dhe Milto Profi. Ky ndëshkim i pamerituar, e demotivizoi artisten dibrane, meqenëse një vendim i këtillë ia rrëzoi poshtë meritat e saj, gjithë ato duartrokitje e respekt brenda dhe jashtë Shqipërisë, por edhe vlerat që ia ngriti kombit të saj me anë të artit që e promovoi me dekada. Melita iu përvesh punës për më shumë se një vit, la mënjanë skenën dhe gjithçka tjetër, për të kërkuar më pas daljen në pension, meqenëse vitet e punës i kishte të kompletuara. Ftesat për bashkëpunim në skenë, qenë të mëdha, por artistja dibrane e kishte marrë një vendim- edhe po të rifillonte, ishte e sigurtë që do e ndiqte një ndëshkim edhe më i madh nga ata që kufizonin gjithçka në shoqërinë e intelektualëve shqiptar.

Por sot?! Shumë nga mosha rinore, ndoshta s'kanë dëgjuar për një artiste me gjithë këtë talent, për një artiste që i dha emër artit edhe kulturës jo vetëm dibrane, por mbarëshqiptare, në një periudhë të errët të popullit tonë. Obligim kanë të gjithë ata intelektualë që e njohën nga afër të madhen Melita Shehu, ta performojnë dhe t'ia përkujtojnë brezit të ri se kjo artiste ka merita të mëdha dhe është ndër të parat që i thurri kurorën artit të vërtetë shqiptar.

Libri i ri


Naim Berisha

KALEIDOSKOP

Tregime, poezi, proza poetike, fabula, hajke, vjersha për fëmijë, shkurtima, përkthime dhe fragmente nga romanet e botuara.

Botimet M&B
ISBN: ISBN 978-9928-4397-7-2
136 faqe, 14x20.5 cm.
Çmimi: 500 lekë

Naim Berisha vjen me një botim të ri, një përmbledhje nga krijimtaria e tij artistike në fushën e tregimeve, poezisë, prozës poetike, fabulës, hajkeve, vjershave për fëmijë, fragmente nga romanet e botuara dhe përkthimet e sjella në gjuhën shqipe. Nuk është një libër për një person, është një botim për të gjithë familjen, ku Naim Berisha vjen me gjithë botën e tij artisitike, përmes ngyrave, harmonisë, ritmit dhe bukurisë që të përcjell vetëm letërsia.



Naim Berisha shkruan pastër dhe pa estetizime e letrarizma të panevojshme. Deri tani e ka përballuar me sukses maratonën e pamëshirshme në hapësirën e poezisë, këtë vrapim të madh që është krejtësisht i pakorruptueshëm. Naimi premton shumë për të ardhmen.

– Dritëro Agolli (1996)

reportazh

Udhëve të shpërlara të fshatit tim



Nga Dr. **SELMAN MEZIU**

Një bretkocë ngjyrë kafe e ndezur papritmas doli nga ujët e kthjellët të vijës qindravjeçare. Sytë e saj të ndritshëm të fryra si dy rruaza, hijeshonin turirin e saj të dalun. Sa më pa kërceu e u fut në barin e jeshiluem. Sipër vijës, vegjetonte thana me gjethet paksa të zverdhura ku dukesh kuqëlimi i frutave të thanave që shkëlqenin nga një rreze dielli. Me tej një lis shtatëlart, kulumbria, murrizi vegjetonin bujshëm, fal rrënjëve të tyre që thithnin me kënaqësi ujin e vijës.

Duke u ngjitur kodrës me kamët që linin gjurmët në shtresën e pluhurit kurse anash gjithëçka e zhuritur që të dhimbsej. Diku kokrrat e ferrmanave të rrudhosura ngjyrë të zezë e kafe. E në zabel të dhimbnin sytë kur shikoje pilirak qarri dy tre metra me degë e gjethe të rrudhosura e të thara. Thatsira e pamëshirshme kishte lanun shijen e hidhur peisazhit të fshatit tim.

Sakaq në një kodër ku kundroje të kaltrën e lumit të shoqëruar nga shelgje, verri, marinë etj. por aty ku merrte kthesën shtrati i bardhë me të kaltrën përmes, mbyllej, nga kurorat e larta të plepave kanadez. Një shtëpi që ndriste nga bardhësia e mureve. Dritaret e dyert modele të kohës që shkëlqenin, një çati me tjegulla të kuqe flakë. Avllia e saj ngjante me muret e një kalaje. Në oborrin e shtëpisë dykateshe jeshilonte bari ku lulëzonin disa lloje lulesh natyrale të stinës. Dëgjova lehjen e një qeni të vetmin banor të saj. Në një tel i lidhur në lartësinë e njeriut, shikoheshin kapset e rrobave, ngjyra, ngjyra tërheqëse me një pal tuta të varura që kishin filluar të zveniteshin. Dera e madhe prej hekuri ngjyrë e gjelbërt në të çelur e mbyllur me drynin që sapo kishte filluar ndryshkja. Lexova ngjitur në kollonë numurin gjashtë.

Më shumë se gjysëm shekulli këtu ishte një furrë që piqeshin tjegulla. Më pas një bashkëfshatar, priste me kallëp prej dërrasa plita ku thaheshin nën rrezet e diellit. Tregëtoheshin për të ndërtuar shtëpi. Më trazonte shpirtin pyetja: Ku të jene vallë djaloshi me gruan e tijë dhe dy femijët? Plaga e kohës rridhte lotë, mall, braktisje, tradhëti vetëvetja, zbrazje...!!!

Hidhja hapat me përtesë. Koka më rëndonte nga hamendjet. Edhe pse vështroja aty këtu qese plasmasi të varura lisave, kulumbriave, vidhave, krekëzave, shkozave nuk më banin përshtypje. Në skrapatën e kësaj rruge maqinash, ndërtuar afërsisht tetëdhjetë e dy vjet më parë, disa dushqe si shkurre ose dy a tre metra të larta kishin rranjët që zvarriteshin skrapatës, një apo dy metroshe. Por çuditërisht ato jetonin. Ashtu me rrënjët në një krahë të ngulura në tokën e kuqëluar. Po ajo familje vallë përse i ka braktisur trojen e veta? Pyesja veten!

Ndoqa rrugën auto ku syri me kapi një qen çalaman, me kurrizin të pluhurosur e aty këtu pa qime. Ai kishte nxjerrë gjuhën e merrte frymë thellë. Vapa e madhe ndoshta dhe uria e kishin tharë e katandisur kështu këtë krijesë të gjallë. Edhe ai vuanta sa s'ka. Mua më therte në shpirt.

Kalova urën me parmak me një kam të thyer nga vërshimet e furishme të lumit Murra që prej pesëdhjetë vjetësh. Pasiguria të ngjallte frikë, ndërsa në shtratin e lumit mbeturinat plasitke të neverisnin, të pshtirosnin. Tanima kjo asht edukata e njerëzve që kanë pranë lumenj e përrenj. Hedhja në lum një mënyrë për t'i hequr qafe. Një kulturë e imponuar, një veprim i diktuar ose me fjet me ato në shtrat. Vaj halli për shtetin që kanë! Ndërkaq dëgjova të kolliturat dhe pshterëtimat e një mesoburri që me kaloi aty pranë.

Sa kaq një zhurm e një skode. Po, ishte nga ajo marka që vinin nga çekia, pothuajse një shekull më parë. E ngarkuar me trupa ahu, perimetër njëzetë centimetëra dhe gjatësi një metër e gjysëm. Ishin të njome sepse iu driste lëkura dhe pjesa e sharruar. Çuditërish ishin vendosur si fishekët në vesme. Normale, fshatarët pregatiten për dimrin që do të vijë. Malet po rjepeshin nga zjarret e prerjet, i shikova dhe dëgjova nga bisedat e zhvilluara. Nuk pash askënd me rroben e gjelbërt me stemën e gjethes së dushkut e çantën prej lëkure të varur kraha qafë. Ato qeveria i ka zhdukur që kontrabandistët të presin e djegin pyjet pa frikën e ligjeve e mbrojtësve të pyjeve.

Vazhdova të ecja një rruge me asfalt ku kalonin më shumë të rinj. Të veshur mirë, sipas modës por edhe të qethur kare. Pak njerëz nga mosha ime më zuri syri. Shkollat këtu në qendër të krahinë së Muhurrit ishin rrethuar me mure nga ai guri të kuq , minierës së Mermerit në luginën e Muhurrit dhe kanxhella. Brenda oborrrit shkretëtirë, përveçse një shelgu vajtues që jeshilonte. Në fakt ky nuk qante por mjedisi përreth të pshtiroste e të shkaktonte lotime duke të dhuruar një shije kulture të keqe. Thuhesh se ka pak nxanës ato po paksohen çdo vit. Po përse valle kjo dukuri e kundërt të dyzetë vjetëve më pare?

Takova mësues pensionista, llogaritar, inxhinier e gjithkush e tirrte muhabetin sipas oreksit. Helbete demokraci! Prandaj unë i jepja drejtim punës qe duhet me bamun ne specialistët dhe intelektualët. Por morali ishte baltosur, thermuar, shqyer. Emruesi i përbashkët ishte se politkanët shqiptar janë kthyer në shushunja që po i mbarojnë gjakun e këtij populli. Por, edhe po tmerrojn të rinjt që nuk gjejn punë pra nuk shohin të ardhme. Zgjidhja vetëm ikin e ikin pa u ndalur duke lanun vendin e tyre Muhurin, Dibrën, shqipërinë të mbuluar në mjerim. Edhe ato që martohen progamojn të bejnë një ose dy fëmijë. Pjellë e natyrshme e varfërisë, papunsisë, rënjes morale, pesimizim të plazmuar në shpirtërat dhe zemrat e banorëve të këtyre anëve.

Vazhdova udhën drejt kodrës së Shëne Diellit për të bamun disa fotografi. Sytë me dhimbnin kur nga lagjia hoxhe e prençe shikoja shtëpi prej guri të shembura, apo gërmadha të disave që po mbuloheshin nga barërat dhe kixhlat, thanat, ferrmanat etj. Peisazhin e trishtuar drithërues që më hidhëroi shpirtin ishte shtëpia e Sale Miklit në kodër të Rame, me gjysëm çatinë të ramun brenda në katin e dytë me muret aty këtu të shembura e të çara. Unë e mbaj mend atë njeri me vëllezërit e tijë me opinga të grisura, me fytyrë të nxirë nga dielli ku djersët iu kullonin rrëke duke lanun gjurmët në pluhuri faqeve të rreshkura nga dielli e vuajtjet. Nuk kisha se si të mos ndihesha i zhgënjyer nga koha. Nuk kisha se si të mos ndjeja dhimbje për këto bukuri natyrore e të krijuara nga njeriu që ju kishte ramun hija e një shkretimi lufte. Veçse kjo ishte vdekja e ngadalshme e një populli e gjallesave përreth. E atëhere si të mos pushtoi trishtimi!!

Kalova në oborret e shtëpive të fisit me histori të madhe të shekullit të Kastriotëve berishëve dhe të atij të vokeve, me drurëfrutorët që ishin kthyer në një pyll të braktisur, të egër, të zvenitur me oborret e mbushura plotë ferrmana e gjithëfarë pisëlliqesh. Këto troje lotonin, shprehnin revoltën me egërsimin e tyre si në forma, në ngjyrime, por, edhe në substancë ishin kthyer kundra të zotërve që i kishin braktisur. Po nejriu ishte kthyer me veprime kundër vetevetes dhe natyrës. Po, po trojeve që e mekuan me gllënkën e parë të qumështit të nënave dhe darrdhat e zbutura që thermohesh me lugë dhe e hante në fëmininë e vetë vogëlushi muhurrak. Ah sot ai nuk dihet se ku e ka thyer qafën. Po, përse vallë kjo mynxyrë njerëzore e mjedisore? Toka dhe veshja e saj bimore, kanë ushqyer qindra e qindra breza familjesh, të varfëra por të ndershme, fisnikësh me histori të madhe. Ato përballuan pushtues të shumtë si romak, gotë, turq, serbë, italianë e gjermanë por sigurisht ato nuk e barktisën këto male, kodrina, fusha lugina lumenj të bekuar. Po tani çfarë i ndodhi vallë, përse iku nga sytë kamët?? Në një hark kohor jo më shumë se njëzetë e shtatë vjetësh, jo më shumë.

Udhët do të heshtin se këto të rinj që levizin sot do të ikin. Pak nxanës ne klasa do të çuçurisin. Ndonjë lopë do të kaloj në udhët e pluhurosura e asfaltin me gropa e bajgën do ta hedhin, natyrisht. Pikat e shiut ose dhe rrëketë e tijë do ta shpërndajnë duke përhapur, langun e zi por të trash, krejtësisht të padobishëm. Po, edhe mua më duket vetja i tillë. Se nuk munda të bëja azgjë. Veç u zhgënjeva e mendimet e mia mu përçmuan dhunisht. Sa keq! Dhe unë ika! Lashë prapa mallin e pashuar që lidhte lindjen e rritjen në këto troje të bekuara e tokat bujqësore, pyjore e livadhore të plleshme. Përse të ndodh kështu vallë??



Rruga e Arbërit nr. 136

Në Lurë gjeta një plak të moshuar i cili edhe pse e kishte kaluar shekullin, kishte një memorje të kënaqëshme, ishte një filozof pa shkollë por që emri i tij ishte përhapur jo vetëm në Lurë por edhe jashtë sinorit të saj. Ai quhej Musa Osmani, një arkitekt i fjalës së mençur ku në raste hasmërish, gjakmarrjes, ngatërresash ishte i kudo ndodhur e fjala e tij kishte forcën e kanunit

Musa Osmani, mendimtari dhe filozofi popullor

NGA **PRENÇ PRENÇI**

Lura, kjo mrekulli e natyrës shqiptare, kjo perlë e rrallë që do ta kishin zili edhe mjaft vende europiane ka parë figura të njohura të shkencës, politikës, artit, kulturës, albanologjisë nga mjaft vende të ndryshme të botës. Kaluan këtej dhe u mahnitën me këtë bukuri të natyrës shqiptare që perëndia ua kishte bërë dhuratë shqiptarëve.

Në Lurë ka kaluar Baroni Franc Nopça, Edit Durham, Zef Valentini, Hugo Adolf Bernatzik ,Antonello Biagini etj. E sot po të shfletosh materiale në dorëshkrim, libra të botuar që flasin për Lurën, gjejmë dhe ato fjalë të bukura e plot ndjenjë njerëzore që lanë këto studiues e albanolog të njohur.

Në Lurë erdhën figura të njohura edhe nga Shqipëria. Edhe Gjergj Fishta erdhi në Lurë, i pa nga afër këto mrekulli, bujti në kullat e Lurës. Thonë se ka ardhur rreth vitit 1922 . E pyetën poetin e madh Gjergj Fishtën kur u largua se çfarë i kishte bërë më shumë përshtypje në Lurë, ai u përgjigj: " Në Lurë pashë e gjeta tre mrekulli të cilat nuk i kam gjetur në asnjë vend të Europës. Mrekullia e parë janë liqenet e bukura të Lurës .Mrekullia e dytë është se kam gjetur në këto kulla të moçme të dyja besimet fetare. Dy vëllezër jetojnë bashkë e në harmoni të plotë, njeri katolik e tjetri musliman. Në Lurë gjeta një plak të moshuar i cili edhe pse e kishte kaluar shekullin, kishte një memorje të kënaqëshme, ishte një filozof pa shkollë por që emri i tij ishte përhapur jo vetëm në Lurë por edhe jashtë sinorit të saj. Ai quhej Musa Osmani, një arkitekt i fjalës së mençur ku në raste hasmërish, gjakmarrjes, ngatërresash ishte i kudo ndodhur e fjala e tij kishte forcën e kanunit".

Të shkruash sot për Musa Osmanin e Lurës nuk do të mjaftonin këto radhë, duhej më shumë punë e kohë por kjo le të mbetet një temë e hapur për të ardhmen, por mjafton edhe me kaq duke shkruar e vlerësuar figurën e këtij njeriu të matur në fjalë dhe gjykim, bujarë dhe fisni , pastrohet sado pak ai pluhur që ka rënë nga vitet e haresës, vendoset deri diku dinjiteti i tij aty ku duhej të ishte vendosur vite ma parë. Për Lurën bëri aq sa mundi.Lura për të ende nuk ka bërë asgjë.Musa Osmani është një emër sa i njohur, aq edhe i venitur. Ka lindur në fshatin Arrmallë të Lurës, një fshat ky i vogël por mjaft i bukur, piktoresk dhe i veshur me shumë pemë të ndryshme , në fisin Vlade ,në mëhallën që sot quhet Osmane rreth vitit 1812 dhe vdiq në vitin 1926 duke jetuar plot 114 vjeç, një rast unikal ky. U fut i vogël në odat e burrave, dëgjonte e mbante vesh e kurrë nuk i dilte para fjalës që shprehnin të tjetër.Dëgjonte gjithmonë se çfarë flitej e për çfarë ngjarjesh e ndodhish flisnin më të moshuarit. Musai i vogël veshët pipëz, por më të moshuarit shpesh e kuptonin se ky djalë që po rritej do të bëhej një zë i forte i kanunit jo vetëm në Lurë por dhe jashtë saj. Filloi kështu në moshë të re duke e ndjekur odën e duke shkuar aty ku bëhej muhabeti i burrave ku debatet ishin nga më të ndryshmet por çdo gjë vendosej në bazë të kanunit. Lura në ato vite kishte 12 pleq ku ,dy nga këto ishin nga fisi i njohur Vladi. Qysh në moshën 15 vjeçare Musa Osmani u caktua si plak i Lurës, pra u fut në të dymbëdhjetëshen e njohur të Lurës të cilët me votat e tyre ndanin pleqëri nga më të ndryshme por gjithmonë në mënyrë të drejtë e të pa anëshme. Megjithëse ishte një rast i veçantë ku një djalë pesëmbëdhjet vjeçarë bëhej pjesë e pleqve të Lurës, vota e tij ka qenë gjithmonë nga e drejta. Edhe më të moshuarit filluan ta vlerësojnë për gjykimin që bënte në raste të vështira dhe komplekse. Filluan jo vetëm Lura por dhe nga zona të tjera ta marrin Musën me nda pleqëri pasi ishte i drejtë,i saktë dhe gjykonte në mënyrë të përkryer.

Në shtëpinë e tij filluan të vijnë edhe patriotë e atdhetarë të njohur. Nikollë Kaçorri ishte nip tek Vladet dhe vinte shpesh e për çdo gjë konsultohej me Musa Osmanin, merrte mendime por kur ishte nevoja kërkonte dhe ndihma duke marrë djem të rinj e trima që ndoshta një ditë do të duheshin të luftonin edhe me armë në dorë në mbrojtje të fateve të vendit.

Musa ishte një njohës i mirë i kanunit dhe njeri tepër i drejtë,i saktë në vendime dhe i pa anshëm. Kur kishte raste të rralla mosmarrëveshjes dhe nuk i ishin ulur gjykimit popullor të Musa Osmanit, ishin të detyruar të shkonin për pleqëri tek shtëpia e Kapedanit të Oroshit. Këtu shkonin jo vetëm zona e Lurës dhe e Mirditës por edhe mjaft fshatra të Matit. Kapidani i pyeste në fillim se a kishin qenë më parë tek Musa Osmani në Lurë dhe kur bindej plotësisht si e kishte ndarë Musai i Lurës, edhe ai po ashtu e vendoste.

Mësuesi i parë i shkollës shqipe në Lurë, Musa Kuçi do të shprehej:" Edhe në moshën 123 vjeçare, Musa Osmani ishte një plak i zgjuar ku kujtesën e kishte të freskët e llogjika e tij ishte po ajo e moshës së dikurshme"

Ende sot e përdorin shprehjen Lura se Musa Osmani e ndante pleqërinë majë kalit. Inteligjenca e tij popullore dhe shprehjet filozofike që përdorte në raste kritike e bënë këtë figurë një ndër arkitektët më të njohur të gjetjes së fjalës dhe shprehjes filozofike popullore dibrane. Dibra kishte mjaft njerëz të tillë, të zgjuar dhe filozof popullor si Dine Hoxha, Selim Sula, Mane Kacani,Bajram Skura, Tafë Kola, por duhet theksuar se Murat Osmani i Lurës bënte përjashtim nga të gjithë. Ai nuk ishte vetëm një mendimtar, një filozof popullor por ishte më së shumti plaku i kanunit dhe i zbatimit të tij. Shprehja e fjalës dhe forca e çekiçit të tij kishin forcën dhe ligjin e kanunit. Nuk fliste shumë, nuk fliste shpesh por kur fliste Musa Osmani të tjerët dëgjonin dhe askush nuk i dilte para fjalës së tij. Mbante lidhje me dyert e para e të njohura si në Lurë, Dibër, Mat por edhe te Markagjonët e Oroshit të Mirditës.

Hasmëritë, gjakmarrjet, grindjet dhe ngatërresat e çastit në Lurë , në ato vite po thuaj ishin minimizuar. Musa Osmani i Lurës fliste në emër të kanunit, në emër të së drejtës popullore dhe njerëzit ishin të bindur kur drejtoheshin për diçka tek ky filozof popullor se e drejta do të anonte andej nga do të peshonte fjala e Musa Osmanit. Është shkruar e folur shumë, janë mbledhur vargje e fjalë të tij filozofi popullor por që të gjitha deri tani kanë mbetur në arkivin e familjes, ndaj për ta përjetuar më mirë, më bukur, më saktë portretin e tij si njohës i kanunit, filozof popullor, arkitekt i fjalës së mençur dibrane janë vargjet e më poshtëme, në formë bejtesh por që në fakt në biseda të shpeshta me kapedanin e Oroshit i bënte në sarajet e tij.

Dikur ka patur burra zamani,
Që e ndanin gjyqin n'kalë,
Ky na ish Musa Osmani,
Lind e rrit në Arrmallë.

Sa i zgjuar ish Mus Osmani,
E merr vesh dhe kapedani,
Kur e thirri për ta pyetur,
Ngeli krejt i çuditur.

"Kam dëgjuar se ke dije,
Për ta ndarë gjyqin në kalë,
O mo burrë sa të paska hije,
Kështu zani të ka dalë.

Si i ndanë ty kur zihen dy të zgjuar?,
Të rinjtë apo të vjetrit.
Këto i ndaj pa u menduar,
Se i ikin njeri tjetrit.

Po një i zgjuar e një budallë,
Si i ndanë Musa t'i ?,
Po u zunë në mes t'mëhallës
Unë i ndaj për bukuri,
se i zgjuari i ik budallës.

Po kur zihen dy budalla?
Kur zihen dy budalla,
Bëhet luftë e bëhet nam,
Aty unë ndoshta nuk jam
Po ma mirë ndodhsh ty kapidan.

Musë Osmani njeri i zotit,
Shumë i ditur e filozof,
Rrënjët kish në zemër t' popullit,
Brez pas brezi u kujtoftë.

BOTIME

Profilet e inxhinierëve që ndërtuan Shqipërinë

Nga Dr.ing. **ORHAN AKIL SAKIQI**

Njeriu në jetën e tij njeh mjaft njerëz të tjerë. Këta janë patjetër familjarët, shokët e fëmijërisë, të shkollës, rinisë etj. Një vend të rëndësishëm zënë patjetër shokët dhe kolegët e punës. Në këtë libër kam përshkruar jetën dhe punën e 50 kolegëve të mi ndër vite. Në fakt, në libër janë 51, sepse njërin, z.Izet Dibra, për vetë kohën, është i vetmi që nuk e kam e kam njohur. Me ata kam ndarë gëzimet e hidhërimet e punës dhe të jetës. Puna është pjesë e pandarë e jetës e unë mendova të përshkruaj në disa radhë për secilin se çfarë kanë bërë ata në jetën profesionale. Kërkova prej secilit prej tyre një jetëshkrim të shkurtër dhe pastaj unë i plotësova ato me njohjet që kam pasur ndër vite. Kështu, krijova një profil për secilin, duke shpresuar t'i jem afruar së vërtetës.

Po t'i përmbledhësh të gjitha objektet që kanë ndërtuar dhe projektuar kolegët e mi inxhinierë ndërtimi, nuk do të mjaftonin qindra fletë. Janë dhjetëra fabrika, hidrocentrale, porte, banesa, objekte sociale, rrugë automobilistike, ura, hekurudha, kanale ujitës, bonifikime etj. Përveç këtyre janë teste mësimore, tekste teknike me autorë ata, janë qindra kuadro të lartë dhe të mesëm, të edukuar e të mësuar nga ata. Këto ditë, gjatë përgatitjes së librit, jam takuar me disa nga "heronjtë e mi". Më ka vlejtur takimi, së paku për t'u çmallur. Ata janë treguar tepër modestë. Të gjithë kanë qenë në merak se mos po mburren me jetëshkrimin e tyre profesional, duke më dhënë CV e tyre. I kam bindur se ato do të shkruhen dhe do të plotësohen me njohjet nga unë dhe për këtë të jenë të qetë. Megjithatë, mendoj se ata kanë shkruar pak për vete dhe unë kam treguar pak për ta.

Këtyre 50 kolegëve u shtohen edhe kolegë të tjerë për të cilët kam shkruar më parë në librin "Homazhe dhe Mesazhe", botuar në vitin 2011. Ata janë: Sali Angoni, Faik Kërçiku, Hajri Mezini, Petraq Kolevica, Tarabosh Çarcani, Genc Balla, Dhimitër Kosta, Xhavit Sallaku, Sopot Haci, Koço Miho, Feri Dishnica, Enver Faja e Lek Dizdari.

Me përjashtim të Kolevicës, kolegët e tjerë nuk jetojnë më, bile që në botimin e librit në vitin 2011.

Një vepër më shumë mund të quhet ajo që është në natyrë, që shihet e preket nga të gjithë në dhjetëra e më shumë vite. Kur viziton një qytet të ri thonë: Shkojmë e vizitojmë së pari rrugën e ndërtesat, ku do s'do, je i detyruar të kalosh, pastaj muzetë. Këto vepra i kanë projektuar dhe ndërtuar kolegët e mi.

Ali Podrimja ka thënë diku: "Bir, njerëzit nuk i ndan vdekja, por harresa". E unë në libër jam munduar të zhduk pluhurin e harresës, sidomos për kolegët që nuk jetojnë më. Dhe ata janë jo pak, por 16 ndër 50. Me familjarët e tyre ka qenë shumë emocionues takimi për të dhënat e tyre. Shpresoj të kem arritur diçka që të vlejë sadopak, për të nxjerrë në dritë punën e madhe të tyre.

Mendoj se për shumë kolegë për së gjalli e jo më tani kur nuk janë në jetë, të kenë shkruar një rresht për ta. Mbase këta janë rreshtat e parë dhe unë krenohem për këtë. Krenohem, sepse e di se në çfarë konditash materiale dhe shoqërore ata kanë projektuar e punuar.

Kolevica në shkrimet Zëri im shkruan: "Kur (në shekullin e XVIII) princi japonez Tashihito e pyeti arkitektin Enshu Kobori se ç'kërkon për t'i ndërtuar pallatin, ky i vuri tre kondita: Të mos caktohet afati i ndërtimit, të mos kufizohet financimi, të mos shihet vepra gjatë ndërtimit". Kondita ideale për projektuesin, por që kurrë nuk i kanë pasur në asnjë kohë. Aq më shumë tek ne.

Në shumicën e veprave të tyre ata kanë projektuar me parullën: shpejt, mirë dhe lirë. Afati i dorëzimit ishte që përkonte me ndonjë festë ku nuk mund të lëvizje, financimi shikohej me mikroskop dhe mbyllja as që mund të mendohej.

Megjithatë "heronjtë" e mi kanë nxjerrë vepra që i qëndrojnë kohës sot e kësaj dite. Ata i janë përmbajtur parimit të arkitektit Wright që: 'Form follows function' (Forma ndjek funksionin).


Qëllimi i librit nuk është analiza profesionale e krijimtarisë së tyre për secilin, sepse kjo do të kërkonte kohë dhe grup autorësh për larminë e fushës së ndërtimit. Qëllimi është t'i përmend objektet kryesore ku ata kanë projektuar ose e zbatuar. Këtë e kam pleksur edhe me njohjen personale, kryesisht gjatë punës.

Madje, ky ka qenë dhe si parim paraprak; shkrimet do të jenë për inxhinierë, arkitektë, gjeodetë të fushës së ndërtimit, të cilët i kam njohur dhe bashkëpunuar. Kjo më duket do ta bëjë librin më njerëzor dhe do t'i shpëtonte standardit historik. Në libër është shkruar për 50 personazhe, por janë përmendur së paku edhe 100 kolegë të tjerë, që janë pjesë e pashkëputur e jetës dhe veprimtarisë së tyre.

Veprimtaria e tyre më e madhe është kryer para vitit 1992, por ka prej tyre që arritën të projektojnë dhe ndërtojnë edhe në kohë të demokracisë, duke bërë edhe kompani private. Ata arritën t'i shohin "hajrin' profesionit.

Kur më kanë dhënë jetëshkrimet kolegët, dhe për ata që nuk jetojnë, familjarët më kanë thënë se mund të shtoj dhe të heq çfarë të dua. Jam munduar të përshkruaj më të mirën e tyre. Nuk e di nëse ia kam arritur qëllimit, por besoj që të mos i zhgënjej. Më së paku tani kanë në dorë diçka sado të vogël për të dashurit e tyre. Së fundi, këta janë kolegë, që janë sot në orbitën më të afërt, në kuptimin që kam mundur t'i kontaktoj për arsye afërsie.

Me siguri kam edhe kolegë të tjerë, të cilët, megjithëse i kam njohur, nuk përmblidhen në këto faqe. I siguroj se gjithçka është e paqëllimtë. Nuk i dihet, nëse Zoti më jep jetë, do të shkruaj edhe për kolegë të tjerë.



ngjarje

Hajri Hoxha në kujtimet për Brigadën e XVIII Sulmuese


HAJRI HOXHA

I ka kaluar të nëntëdhjetat. Varka e jetës së tij mbushur me një jetë përkushtimi atdhetar udhëton drejt shekullit.

Qetë, qetë, me diellin në zenit.

Ka një kujtesë që e lakmoj. Jam i sigurt se kur të lexoni emër për emër shokët e tij në betejat për çlirimin e Shqipërisë nga pushtuesit nazi-fashistë, pjesëmarrës aktiv në Luftën e Madhe Antifashiste Shqiptare, do ta lakmoni e ndëroni më shumë se unë.

Shënimet e mëposhtme, ende në dorëshkrim, janë vetëm një fragment i vogël i një libri të tërë kujtimesh fëmijërie, rinie, lufte e pune të palodhur kudo që koha e vendosi të jetë në krye të aksioneve në një kohë të artë për një brez njerëzish që e deshën vendin me shpirt dhe punuan e dhanë sa mundën...

Ky është HAJRI HOXHA...

Me lejen e tij po shkëpus nga arkivi im një fragment që lidhet me krijimin e një prej formacioneve me emër në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, Brigadës së XVIII Sulmuese.

ABDURAHIM ASHIKU
Athinë, 23 gusht 2017

Brigada e 18-të Sulmuese është krijuar më 18 Gusht 1944 në Sllatinë të Sllovës. Kështu u bë realitet porosia e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë NÇ e personalisht të Komandantit të Përgjithshëm, shokut Enver Hoxha drejtuar shokut Haxhi Lleshi nga fundi i vitit 1943 që "në një të ardhme të afërt në Dibër të punohet për formimin e një formacioni: Brigadë partizane". Pas fjalës përshëndetëse bërë nga shoku Haxhi, ishin zgjedhur kuadrot drejtuese të Brigadës: shoku Esat Ndreu –Komandant dhe shoku Miço Kallamata –Komisar të cilët ishin ndër kuadrot më të vjetër në Dibër dhe Korçë.

Të dy me Haziz Asllanin të ardhur nga spitali i Maqedonisë më 28 Gusht, u inkuadruam në Batalionin e parë të Brigadës me komandant trimin dhe kuadrin me përvojë ushtarake shokun Gafur Korça ndërsa komisar po një ndër kuadrot dhe partizan i vjetër shokun Hilmi Çausholli. Hazizi u caktua komisar i Kompanisë së dytë të këtij batalioni kurse unë Përgjegjës Rinie i Kompanisë së Parë.

Në Brigadë pothuajse gjeta shokët partizanë që u bashkuam në Gramë të Korabit apo të ish Batalionit të Dibrës: Prokop Mura, Rexhep Doda, Beshir Laçi, Emin Agolli, Adli Dibra, Ismete Baholli, Veli Zogu, Montaz Kodra, Ramiz Agolli, Mehmet Hajrullaj, Pal Cavapuli, Sali Hoxha, Sefer Musa, Qatip Cala, Miftar Koltraka, Maliq Noka, Sami Spahiu, Xheladin Krifsa, Shuaip Baruti, Demir Leka, Kalosh Daci, Ferit Muha, Mojsi Kukeli, Ajet Simitxhiu, Uke Cani, Ferit Muha, Abaz Vargu, Ismet Sula, Hysni Deda, Selim Pira, Asllan Keta, Beqir Brata, Isuf Sula, Hasan Laçi, Destan Meta, Ferit Alimani, Man Jella, dhe ish pjesëtari i çetën territoriale të qendrës Peshkopi Nexhmedin Shehu. Pothuajse të gjithë shokët e shoqet e mësipërm ishin emëruar në postet drejtuese të kompanive të Batalioneve: komandantë, komisarë e zëvendës si dhe përgjegjës rinie. Po ashtu në Brigadë kishin ardhur edhe të rinj pjesëmarrës në LANÇ, por tani të radhitur në Brigadë si: Shemsi Hoxha, Adil Shehu, Tahir Haxhiymeri, Sinan Osmani, Ahmet Kullaverja, Faik Ashiku, Destan Laçi, Ahmet Shehu, Ahmet Stojku, Hilmi Kuska, Sami Shehu, Nexhmi Melani, Skënder Shehu, Hysen Mata, Izet Vraniçi, Myslym Vraniçi e të tjerë. Veçanërisht kujtoj takimin përsëri motër e vëlla, Eshref dhe Hibe Palikuqi që me ta kishim një aktivitet të përbashkët me Grupin e të Rinjve në Dibër të Madhe, vajtjen dhe ardhjen si korrier Dibër-Tiranë e kthim dhe tani Hibja në ditën e inaugurimit të Brigadës ishte emëruar z/komisare kompanie në Batalionin IV të Brigadës.

Brigada që në fillim, sipas detyrave që kishte marrë nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë NÇ, nën drejtimin e komandës sonë veproi së bashku me Brigadat e I, IV, e të V Sulmuese për asgjësimin e sulmeve që ndërmerrnin forcat gjermane e bashkëpunëtorët e tyre, si ajo e mësymjes së tyre nga Hilmia, por u shpartalluan dhe më 23 Gusht 1944 u çlirua Peshkopia dhe gjithë Dibra dhe kjo ditë u shpall dita e çlirimit të Dibrës.

Pas 30 Gushtit Brigada veproi në luftimet kundra gjermanëve e bashkëpunëtorëve të tyre në Lumë, Kukës e Prizren...

Kukësi u çlirua më 18 Nëntor 1944 dhe së bashku me forcat e Brigadës V-të Sulmuese u çlirua Prizreni më 17 Nëntor 1944. Pas kësaj Brigadës iu caktua detyra për asgjësimin e mbeturinave të mercenarëve dhe bashkëpunëtorëve me okupatorët nazifashistë në zonën Mirditë-Pukë.

Për të gjitha këto luftime e aksione të Brigadës është botuar Historiku i Brigadës së 18-të Sulmuese (të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare), 18 Gusht -25 Prill 1945, në vitin 2008.

Megjithatë ruaj me nostalgji:

E para:

Pothuajse çdo natë Batalionet e Brigadës zinin pusi në istikamet e improvizuara rreth rrugës Prizren – Kukës, poshtë fshatit Bardhoc e të tjerë deri në afërsi të Kukësit që prisnim autokolonën gjermane të tërhiqeshin nga Prizren-Kukës-Pukë-Shkodër. Po ashtu kishte javë që në ditë të caktuara për afro dy muaj batalionet me radhë ndërmerrnin aksione kundra forcave gjermane në qytetin e Kukësit. Këto jepnin rezultate në dëmtimet që u bënim si në njerëz e materiale autokolonave gjermane apo atyre të vendosura në qytet. Dhe ne të gjithë partizanët në këtë rast ruajmë pritjen që si para apo pas aksionit të fshatrave të Kukësit që nga Bicaj e Morina ndanin bukën e tyre me ne e çfarë kishin në shtëpi si groshën, dhallë e sidomos turshitë dimërore, sepse po të mos ishte kjo nga do t'i merrnim ne bukën etj. mos kishim magazinat me miell apo të tjerat? Jo, "magazinë" ishte zemra bujare e fshatarësisë si kudo në gjithë popullin shqiptar e sidomos të fshatarësisë edhe në të Dibrës-Krumës-Kukësit-Pukës e Prizrenit.

E Dyta:

Ruaj trimërinë e njërit prej partizanëve të Kompanisë sonë të Batalionit të I të Brigadës, atë të Elez Simo Mema prej fshatit Zogjaj të Dibrës.

Kishim zënë pusinë dy tre gurë më poshtë fshatit Bardhoc mbi një cep të rrugës automobilistike. Shikojmë autokolonën gjermane, dy-tre qerre, dy automobila e motoçikleta që u paraprinin 2-3 tankeve. Fillojmë të qëllojmë me zjarr të dendur, nga një pozicion mbi ne me mitralozin "Breda" dhe ne me mitralozin dhe automatikët e breshërive të markës angleze e hedhim granata mbi xhade. Gjermanët çorientohen. Disa prej tyre zbresin me shpejtësi nga automjetet e disa hidhen në ujërat e Drinit të Bardhë. Por pak nga ata e marrin veten e të prirë nga një tank i tyre që po vjen drejt pozicionit tonë duke shtënë pa ndërprerje. Në këtë rast shikojmë Elezin me mitralozin ndër duar duke zbritur në xhade drejt tankut gjerman. Vendos dy gurë i shtrirë në xhade dhe duke bërtitur me zërin e fuqishëm "para partizanë" hedh granatat drejt zinxhirit të tankut dhe duke i ndjekur disa gjermanë të tjerë i mbarohej fishekët e mitralozit. E shikojmë që atë e kap breshëria e fishekëve të armëve që pak më larg tij ishin ata. Kështu na u vra Elez trimi për të na shpëtuar neve. Dhe trimëria e gjithë partizanëve e veçanërisht e Elezit, sipas komunikatës së Shtabit, gjermanët e paguan shumë shtrenjtë: me 45 gjermanë të vrarë, 15 të tjerë u zunë rob dhe shkatërrim automjetesh, motoçikleta si dhe një tank. Ndërsa për trimin, Elezin, sot e kësaj dite këndohet:

"U hyn dridhma gjithë gjermanëve,
Me mitraloz në dorë
Shoku Elez bie dëshmor."

Kështu luftuan trimërisht ish komandanti i Batalionit IV, trimi Gafur Mehmeti nga Lushnja si dhe partizanët Hysni Krusa, Rahman Doda, Idriz Kaba e të tjerë. Dhe ndër ta kujtoj Heroinën e Popullit, vajzën 17-vjeçare e z/Komisaren Hibe Palikuqi.

Batalioni i IV mori detyrën për të shkuar në ndihmë të forcave partizane shqiptare-maqedonase për çlirimin e mbrojtjen e Kërçovës, por marrim informacion se në një përleshje me mercenarët bashkëpunëtorë me gjermanët, duke luftuar trimërisht ishte vrarë Hibja. Njiheshim porsa kishim ardhur nga Gushti 1943 nga Tetova. Bënim jetën në Organizatën e Rinisë të qytetit të Dibrës së Madhe e veçanërisht kujtoja e kujtoj ditën kur ajo u takua me Haki Stërmillin kur u formua Batalioni i Rinisë "Nazmi Rushiti".

Ajo u bë dhe ishte frymëzim për të rinjtë sidomos të rejat e Dibrës. Me të kishin luftuar trimërisht edhe partizanët: Vera Myrtezai, Xhemal Zuna nga Pesjaka, Zenel Sadik Puci nga Cereni, Haki Bajram Xhika nga Mustafaj, Haxhi Agush Xhediku nga Sollodolli. Dhe për të nderuar Hiben Presidiumi i Kuvendit Popullor i Republikës Socialiste të Shqipërisë i ka dhënë titullin "Heroinë e Popullit" e gjithashtu edhe Republika e Maqedonisë i ka dhënë të njëjtin titull "Heroinë e Popullit".

Për trimëri në luftimet që ka bërë Brigada jonë dhe janë plagosur, janë shquar z/Komandanti i Batalionit Mehmet Hajrullaj, Haziz Asllani –i plagosur dy herë në 1943 dhe 1944 në Dibër të Madhe, Mustafa Bunguri –i cili vdiq pas disa ditëve në spital, Hysni Krusa, Fejzulla Doda e të tjerë.

E treta:

Me çlirimin e Kukësit dhe Prizrenit u bënë ndryshime në udhëheqjen e Shtabit të Brigadës. Esat Ndreu u caktua me forcat e ndjekjes në Shkodër dhe Komandant erdhi shoku Petrit Dume, ndërsa Komisar Hilmi Çausholli, sepse Miçua u caktua Komisar në një brigadë shqiptare në Maqedoni.

Në Kompaninë e Shtabit të Brigadës u emërova Komisar i kësaj Kompanie. Në këto ditë çlirimi të Kukësit kujtoj ardhjen në Brigadën tonë të 112 shokëve e shoqeve që kishin shpëtuar nga kampi nazist gjerman i Prishtinës, ku disa prej tyre u rreshtuan në Brigadën tonë si i paharruari Kin Dushi që arriti të emërohet edhe Komandant Batalioni.

Ai ka shkruar dhe botuar në libër vuajtjet dhe pushkatimet e 105 të rinjve shqiptarë në këtë kamp më 23 Tetor 1944. Po ashtu Kini na tregoi trimërinë e gjithë shokëve që ishin pushkatuar e në mes tyre na tregoi për ish partizanët e Batalionit tonë të Dibrës: për Spiro Velkon, Musa Agollin e të rinjve të tjerë dibranë si: Bilal Konxhollin, Tasim Shehun, Hamza Shehun.

E katërta:

Në këto ditë në Kukës u sëmura, mu ënjtën të dy këmbët dhe pjesa e pulpave mu nxi. Më pa shoku im Sotiri dhe lajmëroi Komandantin e Brigadës, Petritin. Ai erdhi, më pa dhe i thotë Sotirit: niseni për në spitalin e Prizrenit. Me kalin e komandantit më shoqëroi z/komandanti i Kompanisë sonë, Hilmi Kuska. Mbërritëm në spital pas 3-4 orëve. Mbaj mend dhe kujtoj kujdesin e një doktori italian dhe infermieres që shërbenin aty. Për tre javë rresht më mjekuan me ilaçe dhe më bënin gjilpëra. Aty njoha edhe 6-8 partizanë të plagosur të Brigadës V shqiptare e ndër ta ishte i plagosur rëndë Kadri Azbiu. Nuk mund të harroj edhe vizitat herë pas here të qytetarëve të Prizrenit që na jepnin kurajë e veçanërisht ata na sillnin edhe byrek në tepsi të bërë nga nënat dhe motrat bujare të Prizrenit.

Me çlirimin e Atdheut më 29 Nëntor 1944 Brigada jonë sipas Urdhrit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë NÇ, veproi deri në Mars 1945 për asgjësimin e disa bandave mercenare të mbetura në zonat e Krumës, Mirditës dhe Pukës. Kemi ndenjur për disa kohë në Fushë-Arrëz. Pas kësaj në udhëtimet Lumë, Dibër, Gollobordë, Librazhd, Gramsh, Përmet, po sipas Urdhrit të Shtabit të Ushtrisë NÇ mbërritëm në Gjirokastër ku më 23 Prill 1945 Brigada jonë u bashkua dhe u rreshtua në një Brigadë me brigadën e 20-të Sulmuese.

Riorganizimi në Brigadën e 20-të Sulmuese më la mbresa. U njoha me një nga partizanët e vjetër të kësaj krahine e kuadër me përvojë nga Libohova, Komisarin e Brigadës Luto Haxhiun që kur na njohu me radhë neve kuadrove na thotë: "Hajri ishe Anëtar i Partisë Komuniste që në Gusht të 1944-trës". "Po, -i them, -shoku Komisar."

E njohëm qytetin mikpritës me tradita patriotike si përpara edhe tani në LANÇ, ku bijtë e saj Heroinat e Popullit Bule Naipi e Persefoni Kokëdhima ranë heroikisht. Dhe për këtë demonstratë të ish gjimnazistëve të Gjirokastrës, i njohuri, ish oficer në Brigadën e Dibrës pas çlirimit Lame Çekani më ka treguar edhe me një shkrim për ish bashkënxënësin e tij nga Dibra, për Riza Dodën që në këtë demonstratë kur pa dy trimëreshat që valëvitnin flamurin kombëtar dhe dy italianët u lëshohen atyre duke i kapur edhe në gjoks, atëherë Rizai me atë trup gjigand malësori i kap për zverku ata milicë fashistë me ato duart e tij i lëshon në shesh duke bërtitur me atë zë të fortë "shporruni, shporruni".

Kujtoj takimin në Qershor të vitit 1945 në Gjirokastër me Komisarin e Divizionit të I-rë, shokun Bajram Sionoimerin, që pasi na përshëndeti e foli për detyrat, na komunikoi gradat "Mua Nëntoger" dhe rrogat që do të merrnim. Por të gjithë sa ishim bërtitëm me një zë "Pse për rroga paskemi luftuar?" Përsëri Komisari e mori fjalën: "Po, po nuk kemi luftuar për rroga, por tani detyra të reja na presin si në ushtri e në terren, në drejtimin e punës në organet drejtuese të shtetit. Tani jemi në pushtet dhe secili që punon apo drejton do të marrë rrogën mujore me atë takat që kemi tani në fillim." U shpërndamë dhe mua më caktuan Komisar në Postën Kufitare të Peshkëpisë të kufirit me Greqinë dhe qëndrova aty deri në Gusht të vitit 1945. Përsëri më thërret Komisari i Divizionit së bashku me shokët e mi të Brigadës, Adli Dibrën dhe Rahman Hankun. Na sqaron dhe komunikon largimin nga Brigada sepse ka nevojë puna në terren që këtë kërkesë e kanë bërë edhe shokët që drejtojnë dhe kështu "Ti Adli do të shkosh Sekretar i Rinisë së Qarkut Kukës, ti Hajri Sekretar i Rinisë të Rrethit të Dibrës, ndërsa ju Rahman me që keni kërkuar të vazhdoni shkollën do të shkoni me studime në Shkollën Teknike të Ndërtimit në Korçë që e latë përgjysmë kur dolët partizan."

Dhe sipas këtyre detyrave e lamë Gjirokastrën mikpritëse, këtë qytet antik dhe shkuam e filluam punët në detyrat e mësipërme. Kështu, si i gjithë populli shqiptar e veçanërisht rinia e tij edhe ajo dibrane kryen me nder dhe me sakrifica të mëdha shporrjen e okupatorëve fashisto-nazistë dhe bashkëpunëtorëve të tyre duke e çliruar Atdheun më 29 Nëntor 1944.

Rruga e Arbërit nr. 136

Kujtesë në 92-vjetorin e lindjes së Xhaxhait tim, Rasim Teodori

kujtesë

RASIM TEODORI, një emër në

Nga **HALIL TEODORI**

Eshkuara është rruga nëpër të cilën ka rendur fati ynë, është ajo e shkuar, ato vështirësi, ato përpjekje vetëmohuese, ai angazhim dhe ajo ndjenjë e lartë patriotizmi, e cila detyron sot mirënjohje dhe vlerësim prej secilit. Është kjo epope, kjo faqe e historisë së popullit shqiptar, që meriton vëmendje dhe rivlerësim, trajtim dhe konsideratë. Sepse çdo moment sakrifice dhe lavdie është skalitur me shkronja zjarri dhe gjaku. Të larta janë ngritur përmendoret, por më e lartëështë e ngritur brenda nesh shtatorja e kujtesës dhe mirënjohjes, më i fuqishme është admirimi ynë për këto vullnete të jashtëzakonshme, i cili na lejon sot të krenohemi dhe legjitim do të jetë për brezat e ardhshëm që të mburren me këtë vepër, me këtë frymë të lartë patriotizmi.

Kur flasim për luftën, ajo që përbën kryefjalën për këtë memuar dhe vlerësim është kujtesa për personazhet që janë pjesë e kësaj epopeje të lavdishme. Një prej atyre që e shkruan me gjak emrin në Historinë e Shqipërisë, është edhe Rasim Teodori.

***

Xha Rasimi!

Kështu e thërrisnin të gjithë në Dibër.

Lufta nacional çlirimtare, megjithse kishte marrë pjesë në moshë të re e kishte burrëruar para kohe. Xhaxhai im, Rasim Teodori u lind ne vitin 1925 në Smollik të Zerqanit,rrethi Dibër.

Po në fshatin e lindjesai mbaroi vitet e para të shkollësdhe si rezultat iLuftës së Dytë Botërore, ku vendi rënkonte nën pushtimin nazist, e la shkollën pa mbaruar dhe ai i'u bashkua batalioneve partizanë në moshën 18 vjeçare, për të luftuar kundra fashizmit që kishte pushtuar vendin tone.

Fillimisht u inkuadrua në batalionin e Çermenikës dhe më vonë duke ardhur dhe duke u rritur numrii partizanëve të batalioneve në Dibër, më23 gusht 1944 u krijua brigade e 18 Sulmuese, ku xhaxhai ka pasur një rol të konsiderueshëm me pjesëmarrjen e tij në formimin e kësaj brigade si një formacion i rëndësishëm luftarak.

Brigada e 18-tëSulmuese njihet për heroizmin e saj luftarak, mbasi përpjekjeve për çlirimin e vendit nga pushtuesit nazist dhe shërbëtorëttë tyre, dhe më pas e shtriu aktivitetin e saj në mbështetje të vëllezërve kosovar ku dha një kontibut të rëndësishëm, jo vetëm brenda vendi por dhe jashtë kufijve të 1913, duke mos u pajtuar me e Fuqive të Mëdha.Krismat e pushkëve për liri u dëgjuan në tërë trojet shqiptare.

Mbas çlirimit të vendit, Rasim Teodori u gradua deri në detyrën, nënkolonel, detyrë të cilën e kreu me përkushtim dhe përgjegjësi deri në vitin 1960, vit kur si rezultat i mospasjes me arsimin përkatës, u detyrua ta lirojë vendin e punës dhe të kthehet në fshat e tijpër t'iu kushuar familjes.

Punoi në zonën kufitare tëKonispolit, Gjirokastër, Përmet e deri në Kolonjë, duke dhënë kështu një kontribut të çmuar për mbrojtjen e kufirit.

Në kujtimet e tij, Rasim Teodoridëshmon për njëimazh pozitiv në popull, gjithashtu edhe në vlerësimin sesi dibranët e kanë kontribuar nëLuftën Nacional Çlirimtare, dhe sesi populli po priste me padurim çlirimin e vendit nga pushtuesit e huaj.

Rasim Teodori, vdiq në vitin 2005. Trupi



Rasim Teodori. Foto nga arkivi i familjes

i tij prehet paqësisht në varrezat e Qytetit të Lezhës.

Më poshtë, në këtë përvjetor e kam si obligim të jap disa imazhe të kujtimeve të tij të pabotuara, të cilat do të japin një panoramë të qartë dhe korrekte të asaj që në vlërësimin e tij, Rasim Teodori, kishte për atë kohë.

Pyetje:

- Xhaxha a mundesh me më tregua diçka për luftën Nacional Çlirimtare, pasi edhe ju vetë keni qenë pjesë e kësaj epopeje të luftës për liri?.

Merr frymë thellë dhe para se të fillojnë ndez një cigare duhan.

Luftë thotë luftë, dhe kur themi luftë nuk është shaka fëmijësh.Në luftë jeton më ndjenjën e hakmarrjes.Fillimisht partizanët pushtoheshin nga ndjenja e frikës, por sapo kriste pushka frika nuk ishte më pjesë e asaj përballje, e cila na kishte shtyrë në sakrificat për liri. Në vëmendjen e secilit, kjo ishte njëhakmarrje. Vendi ishte i pushtuar, fëmijë, gra, pleq, dhe populli i pafajshëm, vriteshin çdo ditë nga pushtuesit dhe mercenarët e tyre. Kjo kishte bërë që jo vetëm tek partizanët, por te i gjithë populli ekzistonte një ndjenjë e fuqishme kryengritjes, e dalëzotjes së vetes dhe vatanit. Kishte ardhur momenti që atdheu, liria, flamuri, nderi, toka dhe amaneti i të parave, të kërkonin sakrifica sublime.

Në luftë nuk është problem kur vritesh vetë se çdo gjë merr fund por problem është kur të vritet shoku.Është ky moment që sheh se si brenda vetes zien një zjarr i fuqishëm, një energji e papërballueshme të shtyn në caqet e të pamundurës. Në atë moment është vetja dhe armiku.

- Si e përshkruani atmosferën në popull në atë periudh zjarri lufte?

Me dështimin që pësoi okupatori nazist në dy operacionet e mëdha që ndërmori kundër Lëvizjes e Nacional Çlirimtare, në dhjetor 1943 dhe janar 1944, Ushtria Nacional Çlirimtare Shqiptare, me mbështetjen e fortë të popullit, filloi kryengritjen e përgjithshme për çlirimin e gjithë krahinave e qyteteve te atdheut. Beteja të shumta të suksesshme afronin ditën e madhe e të gëzuar të lirisë, çlirimin e gjithë Shqipërisë.

Situata ndërkombëtare ishte inkurajuese me fitoret e vazhdueshme të ushtrisë sovjetike në të gjitha frontet e Lindjes dhe me zbarkimin anglo-amerikan në Itali.

Fitoret vendimtare të aleatëve anglo-sovjeto-amerikanë dhe lufta çlirimtare e pandërprerë e popujve të shtypur kundër nazifashizmit, ku dallohej dhe lufta e

Për akte trimerie është dekoruar nga Presidumi i Kuvendit Popullor te Shqipërisë, me vendim Nr. 25871 datë 4 Qershor1948 me medaljen e çlirimit me këtë motivacion:

"Ka marrë pjesë në rrjeshtat e Ushtris Nacionalçlirimtare Shqiptare dhe me armë në dorë ka luftuar kundër okupatorit dhe tradhëtarve deri në çlirimin eplotë të atdheut dhe të popullit Shqiptar".

Sekretari (Sami Baholli)

Presidenti (Dr. Omer Nishani)

shqiptarëve, shpartalluan Gjermaninë hitleriane. Të njëjtin fund pati dhe Japonia militariste në Lindjen e Largët. Fitorja e madhe botërore kundër forcave agresive e shkatërrimtare fashisto-militariste, bëri që njerëzimi të merrte frymë lirisht dhe të gëzonte paqen e sigurisë aq shumë të dëshiruar, të fituar me shumë gjak e sakrifica.

Dibranët si gjithmonë e kishin filluar luftën partizane me çeta. Në krye të çetës së Dibrës ishte Haxhi Lleshi.

Me pjesëmarrje gjithnjë e më shumë të popullsisë së krahinave e qyteteve në frontin Antifashist Nacional Çlirimtare dhe me aksione të guximshme të njësive luftarake që shtoheshin e zmadhoheshin, u ngushtua shumë sundimi i okupatorit dhe me kapitullimin e Italisë fashiste në Shtator 1943, shqiptarët çdo ditë e më shumë po ndjenin se dita e fitores po afronte.

Okupacioni italian që pasoi atë gjerman, me gjithë prepotencën e ashpërsinë e luftës që bënte në të gjitha frontet, si edhe në gjithë Shqipërinë, mundi të shtrinte okupimin në mjaft krahina te Dibrës dhe në Zerqan, Diber e madhe, Peshkopi,Okshtun, Ternovë, Smollik, Lejçan, Lubalesh, Kojovec, etj.

I shtrënguar nga lufta në rritje me vendosmëri të madhe që bënte Ushtria Nacional Çlirimtare, mbështetur fuqimisht nga populli, okupatori i egër nazist e kufizoi sundimin e tij në zonat më të domosdoshme për qëllimet e tij strategjike, si rrugët dhe komunikacioni në Dibër të Madhe dhe në akset kryesore që lidhnin Dibrën me Ohrin, Shkupin e Tiranën.

Në atë prag çlirimi, qytetet si Dibra, Bulqiza dhe Peshkopia kishin mbetur të shkëputura edhe nga fshatrat më të afërta, kur këto zona filluan të punonin nën drejtimin e pushtetit te ri të këshillave nacionalçlirimtare.

Ishte fakt, popullsia jetonte e izoluar nën një regjim të egër dhe terrorist që kishte vendosur okupatori në bashkëpunim me kolaboracionistët e tradhtarët shqiptarë, që ishin strukur nënë mbrojtjen e topave e tankeve gjermane, duke e kthyer jetën e banorëve që kishin mbetur në gjendje të paduruar. Ishin boshatisur qytetet nga djemtë dhe vajzat, që kishin dalë në mal për të luftuar, familje të tëra të varfra e të pasuara, intelektuale e profesionistë, bujq e tregtarë, që nuk ishin larguar në asnjë kohë nga qyteti i tyre, të tmerruar e të terrorizuar nga rreziku, apo të shpëtonin prej tij, kishin braktisur shtëpi e pasuri, nga që netët e ditët nuk duroheshin nga egërsia naziste dhe jeta bëhej e padurueshme nga urrejtja bastarde dhe kriminale e padëshirueshme e mercenarëve që me bajonetat gjermane mbanin pushtetin dhe bënin ligjin.

***

Forcat pushtuese gjermane, ishin të çakorduara dhe të shqetësuara, lëviznin të pasigurta në rrugët e komunikacionit që u kishin mbetur dhe kalonin ditë e netët në alarm të vazhdueshëm në qytetet akoma të okupuara. Ata ndjenin dhe vuanin armiqësinë e një populli të bashkuar për të fituar lirinë, që nga zonat e çliruara, entuziast e plot guxim, me armë në dorë, sulmonte bashkë me partizanët e batalioneve dhe brigadave për të zhdukur nga toka shqiptare edhe okupatorin e fundit dhe bashkë çdo shqiptar, që kishte tradhtuar atdheun dhe kauzën e shtrenjtë të lirisë. Kishin sakrifikuar e vuajtur shumë shqiptarët, por ndjeheshin të gëzuar dhe ishin krenarë, se po e fitonin lirinë me dinjitet e trimëri, me luftën që po bënin.

Sulmi vendimtarë i Ushtrisë Sovjetike, që përparonte me shpejtësi në front të gjerë, duke asgjësuar hordhitë e rraskapitura e të dëshpëruara gjermane, të cilat synonte fitoren e padiskutueshme ndaj Gjermanisë fashiste.

Armata e Rajhut duke parë zhvillimet e betejave, që bënin të pasuksesshëm çdo rezistencë hitleriane në qendër dhe në jug të Evropës Lindore, u vunë në tërheqje të menjëhershme, për të shpëtuar nga rreziku i rrethimit e asgjësimit, forcat që ndodheshin në Gadishullin Ballkanik.

Në një situatë të pafavorshme u gjendën dhe forcat gjermane që kishin pushtuar vendin tonë. Forcat partizane, në këtë periudhë të luftimeve vendimtare ishin shtuar dhe vazhdonin të rriteshin radhët, të cilat me entuziazëm, vendosmëri e guxim ua ngushtuan fushën e veprimtarisë luftarake gjermanëve dhe gjithë atyre që bashkëpunonin me pushtuesin.

Pushka partizane në Dibër, Peshkopi, Gollobordë, Zerqan, Bulqizë e gjithë zonat përreth nuk e ndali vërshimin e vet në çdo qendër të fortifikuar që mbahej nga pushtuesi.

Humbje e armikut ishin të mëdha dhe populli priste me entuziazëm çlirimin e Dibrës nga pushtuesit.

Më 25 majë 1943 ishte krijua çeta antifashiste nacionalçlirimtare e Gollobordës me komandant,dëshmorin Ahmet Cami dhe komisarë dëshmorin, Spiro Velko.

Dy vite më parë, në prill të vitit 1941 pikërisht në vendin e quajtur, "Fusha e Thatë" në vendin ku Mustafa Shehu i Zerqanit bëri një nga luftimet më të lavdishme në historinë e Dibrës, mbas atij kur legjendari Gjergj Kastrioti -Skënderbeut shkatërroi Hajredin Pashën me gjithë taborët, po aty Ejup Cami dhe Sefer Cami hapën zjarr dhe rrëzuan një aeroplan italian në Fushë të Gjoricës.

Kryengritja e datës 7 prill 1941 zgjati deri me 9 prill 1941 ku mbetën të vrarë rreth 50 ushtarë italian dhe mësuesi, ish-studenti i normales Fasli Cami.

Në Miresh është ngritur një lapidarë

kujtesë

Shqipëria do të bëhej më e mirë, e begatë dhe e përparuar e humane, kur shpresat e besimi me të cilat u mundën armiqtë dhe do fitohej lufta, do të ktheheshin në realitet që do të plotësonte angazhimet e premtimet që ishin dhe dëshirat e aspiratat e popullit shqiptar

përmendoren e kujtesës së atdhedashurisë

në përkujtim të dëshmorëve të rënë në këtë fushëbetejë. Fillimisht çeta u zbeh si rezultat i dënimeve dhe pushkatimeve që ndërmorën pushtuesit, por më 25 maji të vitit 1943 u riorganizua nën drejtimin e komandës së përgjithshme të ushtrisë nacionalçlirimtare.

Në Sofraçan është bërë një betejëtjetër e madhe, ku kanë marrë pjesë çeta e Grykës së Madhe, çeta e Grykës së Vogël dhe çeta e Gollobordës. U zhvilluan luftime te përgjakshme nga ku mbetën të vrarë, Kamber Xhafa dhe Mexhit Tola.

Si i gjithë vendi, Dibra ka përjetuar ditë, orë e çaste të vështira. Me frikën e madhe të shkatërrimit, nga sulmet e kundrasulmet që linin të vrarë e të plagosur.

Të tmerruar gjermanët dhe bashkëpunëtorët e tyreluftonin dhe pasi ndeshnin në rezistencën e forcave partizane tërhiqeshin drejt Dibrës së Madhe për t'u mbrojtur nga ku mbroheshin nga topat e mitralozat që nuk pushonin as ditë e as natë së vjelluri zjarr.

***

Dibra prej shekujsh ka qenë kryeqendër historike e lidhur organikisht me interesa politike, ekonomike, sociale e kulturore në gjithë krahinat e qytetet e tjera të vendit.

Brigada e Tetëmbëdhjetë, u organizua menjëherë mbas dështimit të operacioneve gjermane, duke përfshirë në radhët e tyre partizanë të vjetër e të rinj, që ishin të organizuara në çetat e batalionet e Dibrës.

Çetat ishin këto organizime të vogla në fillim, por që më vonë morën përmasa të batalioneve, deri sa më në fund u krijua brigada e 18 sulmuese në Sllatinë të Sllovës me 20 Gusht 1944.

Ata u vunë në ballë të luftës të gatshëm të sakrifikonin edhe jetën për lirinë e atdheut e të popullit duke bërë shumë sakrifica, pranuar shumë, vuajtje të shumta dhe po kështu dhe viktimat ishin jo të vogla. Liria fitohet me sakrifica e gjak, ky është mësimi që u kishte dhënë historia dibranëve dhe fitorja ishte e atyre që s'i kursyen ato, ishte e çlirimtarëve, që e detyruan armikun e egër të largohet më së fundi edhe nga Peshkopia, ditën e 23 gushtit 1944. Gjermanët dhe bashkëpunëtorët e tyre u larguan nga Dibra në panik, të tmerruar e të shpartalluar. Ata dhe bashibozuku i tyre nuk kishin më vend në Dibër. Ata bashkëpunëtorët e fashizmit që kishin qenë armiq të lirisë,kishin luftuar kundër popullit shqiptar dhe kishin bërë masakra nga më ç'njerëzoret ishin në prag të disfatës së madhe..

***

Çlirimi i Shqipërisë përbënte fitoren e madhe historike së popullit shqiptar në Luftën e Dytë Botërore. Ishte fitore e merituar, e arritur me forcat e veta, pa ndërhyrje nga jashtë, që nxori Shqipërinë në dritë, të vlerësuar e nderuar për pjesëmarrje aktive e të shquar në Frontin e Madh Antifashist Botëror në krye të të cilit qenë Aleatët e mëdhenj, Britani e Madhe, Bashkimi Sovjetik e Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Sakrificat e mëdha dhe gjaku i derdhur bënë që atdheu dhe shqiptarët të gjenin në idealet e qëllimet e larta të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare dëshirat dhe aspiratat e një populli të bashkuar pa dallim feje e ideje, krahine e kombësie, për një jetë të re, më të mirë e të begatë, në liri e drejtësi të përparuar e humane, që me pushtetin e ri demokratik e popullor të ndjeheshin të qetë e të sigurt dhe të barabartë para ligjeve. Këto kishin qenë në shekuj dëshira e aspirate, për të cilat shqiptarët kishin luftuar e sakrifikuar, por nuk kishin mundur ti realizonin. Populli shqiptar si rezultat i pushtimit shumë shekullorë otoman, kishte mbetur i paditur e i prapambetur, plot varfëri e sëmundje, që për historinë e cilësitë e tij nuk i meritonte.

***

Më të ndërgjegjësuar e të vendosur, si asnjë herë tjetër, shqiptarët bënë që lufta për çlirim të shpërthente me madhështinë e një revolucioni popullor, ku të rinj e të moshuar, meshkuj e femra ta ndjenin veten veprimtarë e luftëtarë të kauzës së madhe të përbashkët, Shqipërisë së lirë, demokratike e popullore. Të gjithë dhanë mundësitë e energjitë, bënë sakrifica dhe shpresuan e besuan në të ardhmen, ku jeta nuk mund të shkonte pa liri dhe liria nuk kishte kuptim e vlerë pa dinjitet dhe pa qëndrime e veprime morale e njerëzore. E ardhmja e Shqipërisë të ishte me një shoqëri të drejtë humane, me një pushtet që përfaqësonte e mbronte interesat e popullit, ku çdo shqiptar të ndjehej njeri i vërtetë, zot i vetvetes dhe i atdheut. Këto ishin idealet. Për një të ardhme të tillë shpresonin e besonin shqiptarët, që ishin të vendosur si antifashistë për lirinë kombëtare, dhe për një jetë të denjë njerëzore në një shoqëri të begatë e të përparuar.

Për të arritur, këto qëllime, gjatë luftës janë mbajtur qëndrime mjaft të rëndësishme dhe është bërë veprimtari e gjerë e suksesshme nga Fronti Antifashist Nacional Çlirimtar. Këshillat Nacional Çlirimtare, që nga fshatrat e lagjet e deri ne qark kanë ushtruar autoritetin e veprimtarinë politike e pushtetare për të arritur sa më shpejt fitoren. Si rezultat i luftërave të gjata populli ishte varfëruа shumë dhe po përballej me probleme ekonomike dhe të tjera vështirësi që diktoheshin po nga lufta.

***

Në udhëheqje të gjithë kësaj veprimtarie ishin këshillat nacionalçlirimtare me organizatat e tyre që funksiononin në të gjithë zonat e lira e të okupuara, në fshat e qytet. Në Okshtun të madh ka funksionuar këshilli i fshatit me Hamit Hoxhën.

Në Prodan ka funksionuar këshilli nacionalçlirimtarë i Prodanit me Limon Briçin e Zyber Koçin. Në Muglicë ka funksionur këshilli me Sadik Cakën. Në Ternovë ka funksionuar këshilli nacionalçlirimtarë i fshatit me drejtues, veprimtarin e flaktë, Asllan Zenelin. Në Smollik ka funksionuar me Selman Qylhanin. Në Lubalesh ka drejtuar sipas Haki Stermillit, Hoxh Murgu, etj.

***

Roli i këshilltarëve ishte parësor, nga vendosmëria e vetëmohimi që tregonin në luftë, nga aktiviteti i palodhur midis masave popullore, me të gjitha shtresat e shoqërisë, për organizim e drejtim dhe nga shembulli personal, të parët në sakrifica dhe të fundit në pretendime. Ata ishin të ndërgjegjshëm se fitorja në luftë shtronte para tyre detyra e përgjegjësi po aq të mëdha e të vështira në paqe pas çlirimit, kur angazhimet e pretendimet duhet të bëheshin realitet.

Kur partizanët rrezikonin akoma jetën, priste që gjermanët dhe bashkëpunëtorët e tyre të kapitullonin dhe të iknin të shpartalluar. Çdo familje brenda rrethimit barbar gjerman dhe të humburve të pashpresë, jetonte çaste të paharruara tragjike, kur dëshirën e madhe për të gëzuar lirinë e mbyste frika e veprimeve terroriste që ishin të papritura. Kur liria çan midis pasigurisë e frikës është e madhërishme për fitimtarët dhe e tmerrshme për të mundurit. Ato ditë lufte, populli i Dibrës i priste partizanët fitimtarë si çlirimtarë që e kthyen Dibrën në traditë.

Fitorja e Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare nuk ishte fundi i asaj që ishte kthyer në një epokë të patriotizmit shqiptar. Populli shqiptar, mbas largimit të okupatorëve e bashkëpunëtorëve të tyre, do ta gëzonte lirinë, por liria bëhej realitet, kur bashkë me paqen do të sigurohej një jetë e re të cilën shqiptarët do të përballonin e ndërtonin bashkërisht, duke vënë në vend të parë interesat e popullit e të atdheut. Shqipëria do të bëhej më e mirë, e begatë dhe e përparuar e humane, kur shpresat e besimi me të cilat u mundën armiqtë dhe do fitohej lufta, do të ktheheshin në realitet që do të plotësonte angazhimet e premtimet që ishin dhe dëshirat e aspiratat e popullit shqiptar.

***

Ky ishte ideali e qëllimi i fitimtarëve, që i organizuan e i udhëhoqën në luftën patriotike për çlirimin e Dibrës dhe të Shqipërisë dhe, që si fitimtarë, mbanin përgjegjësinë e madhe për ndërtimin e një jete të re. Suksesi i madh në luftë, duhet të siguronte një sukses të madh në paqen mbas çlirimit. Fitimtarët e Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare duhet t'i dilnin krye bashkimit të gjithë shqiptarëve në një jetë të qetë e të sigurt, me përpjekje e sakrifica të përbashkëta të rindërtonin e ndërtonin vendin e prapambetur dhe të shkatërruar nga lufta, të ndërtonin jetën e re, në liri e drejtësi dhe me ligje të barabartë për të gjithë, ku çdo shqiptar të gjente vetveten denjësisht dhe të gjithë bashkë të gëzonin. Pushteti i ri, demokratik e popullor të siguronte një Shqipëri të re të pavarur dhe me dinjitet midis fqinjëve dhe me mbarë botën, të ndërtonte një shoqëri të re, të lirë e të drejtë, ku do të kishte suksese e përparime në të gjitha fushat e jetës dhe mirëqenie e lumturi për shqiptarët. Synohej progresi, që nuk mund të mbetej pre e divergjencave e ndarjeve, e armiqësive e hakmarrjeve të së kaluarës dhe që nuk do të rrezikohej nga keqkuptimet, paramendimet e prapamendimet. E ardhmja duhej të ishte vepër e përbashkët e të gjithëve. Mendimi e veprimi do të mbështeteshin në ndershmërinë e sinqeritetin, interesi i secilit nuk do të qe kundra dhe as do të ndahej nga interesi i përgjithshëm i atdheut e shoqërisë. Të bashkuar të gjithë për një dhe një për të gjithë, do të përballoheshin detyrat e mëdha për të shpëtuar nga prapambetja dhe çdo shfaqje negative e së kaluarës dhe do të grumbulloheshin e bashkërendoheshin në një vullnet, qëllim e veprim të përbashkët të gjitha fuqitë mendore, shpirtërore e fizike të popullit shqiptar.

***


Në kohën e paqes dhe të lirisë, ditët dhe jeta e trishtuar dhe të dhimbshme do ti përkiste luftës, kurse me vendosjen e marrëdhënieve vëllazërore do të krijohej një vullnet e forcë e re, më e fuqishme se pushka dhe më e mprehtë se shpata, me anë të mendimit e veprimit të lirë, me kushtetutë e ligje të drejta, shprehje të dëshirave e interesave të përgjithshme, të cilat do të ishin edhe shprehje e ndershme dhe qytetëruar e kulturës të qytetarëve e fshatarëve shqiptarë. E drejta e fitimtarëve që siguroi lirinë, i ngarkonte ata me detyra e përgjegjësi, që tregonin po ato cilësi e aftësi edhe për të realizuar e siguruar një tranzicion nga e kaluara e lufta në paqe e liri me mençuri e aftësi të dalluara dhe qetësi e siguri shembullore, që do të ishte kënaqësi e nder për të gjithë. Do të krijonin prestigj e garanci për shtetin e ri shqiptar që të mbështetej e bashkëjetonte me miq të sigurt në botë mbi baza mirëkuptimi, respekti e interesi reciprok. Drejtuesit e rinj që mendohej se do zgjidheshin drejtpërsëdrejti nga populli, do të kishin rol të madh e të përgjegjshëm derisa do të organizonin dhe do të udhëhiqnin këtë tranzicion reformator. Duhet të tregonin aftësi e mençuri, zgjuarsi e vendosmëri dhe ndjenjë të madhe përgjegjësie që të realizohej drejt e denjësisht, me shkallë të lartë kulture e humanizmi, të ishte konsekuent në idetë patriotike e antifashiste, çlirimtare e përparimtare të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare dhe të perspektivave të Demokracisë Populloreqë do të bashkonte gjithë shqiptarët me pushtetin e ri, për realizimin e objektivave madhështore të rindërtimit e ndërtimit të Shqipërisë së re, që do ta bënin pjesë të botës së qytetëruar.

Referencat:

- Lufta nacionalçlirimtareshqiptare
- Haki Stermilli
-Gazeta "Dibra"
-Gazeta "Rruga e Arbrit"
- P. Kagjini mbi luftën nacional çlirimtare.
-Gazeta "Veterani"
-Gazeta "Bulqiza"

Botim i ri

Halil Teodori: **SABRI CAKA, KRAHU I SHQIPES NË FLAMUR**
Botimet M&B / ISBN: 978-9928-172-93-8
"Historia duhet të jetë e shkruar dhe duhet t'u përcillet brezave ashtu siç është, ku ata të shohin veten në të kaluarën. Jo vetëm për periudhën post-komuniste, por edhe ato të mëhershmet pak është shkruar për historikun e vendlindjes sonë. Zona jonë ka nxjerrë heronj dhe figura të shquara, personalitete të rëndësishme të kulturës dhe dijes, guximit dhe vendosmërisë, traditës dhe atdhetarisë. Kjo kolanë e gjatë dishepujsh të vlerave dhe krenarisëi ka shërbyer vendit, por ata kanë ngelur pa u bërë të njohur, përfaqësuar dhe vlerësuar. Sepse është detyrim i gjeneratave që në emër të mirënjohjes, në emrin e thirrjes së gjakut, në emër të më të shtrenjtës që na ndjek nga pas kudo që të shkojmë, në emër të plisit, t'i njohim, t'i promovojmë dhe ta çmojmë kontributin e tyre. Sepse është kjo përpjekje, është ky angazhim, është kjo detyrësi, ajo që na nxit të jemi ne ata që do të shkruajmë ato faqe të historisë që trualli na i ka besuar ne, sepse vetëm ne mund ta matim dhimbjen e kësaj toke, ta dëgjojmë kushtrimin e këtyre maleve, t'u bindemi këshillave të etërve flokëbardhë, ta lehtësojmë dhimbjen e kësaj plage".





www.rrugaearberit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: **info@rrugaearberit.com**

Informacioni për versionin e printuar: **rrugaearberit@gmail.com**

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Website është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

BËJ NJË ABONIM ONLINE OSE NË PRINT...


Kushton vetëm 600 lekë në vit... / email: rrugaearberit@gmail.com

LIBRA


Të gjithë këto tituj te libraria M&B në Tiranë i gjeni me 10% zbritje nga 1 korriku deri më 30 shtator 2017

...dhe mbi 100 tituj të tjerë të autorëve dibranë...









Të gjitha këto botime i gjeni pranë rrjetit të librarive **Adrion** në Tiranë,
librarisë M&B në Tiranë (pranë kryqëzimit te Selvia në Rrugën e Dibrës ose në librari **"Fleta XXI"** në Peshkopi.
Email: **mbbotime@gmail.com** Tel: **+355 69 20 68 603** (Viber) **+355 68 65 08 441** (Whats App):

